# TË BËHENI UDHËHEQËS BIBLIK

*Varianti për Gra*

LIBËR PUNE PËR ZHVILLIMIN
E UDHËHEQËSVE NË KISHË

XL MINISTRIES
EXCELLENCE IN LEADERSHIP

# TË BËHENI UDHËHEQËS BIBLIK

*Varianti për Gra*

LIBËR PUNE PËR ZHVILLIMIN
E UDHËHEQËSVE NË KISHË

XL MINISTRIES
EXCELLENCE IN LEADERSHIP

**Falënderime për Pam Wyatt, Christy Anderson, Sheila Pennington, Rebecca Burris, Alisa Riser, Rachel O'Dell, Cathy Mason dhe Billie Ruth Bingham për komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre të vlefshme gjatë përgatitjes së këtij botimi të rishikuar për gratë.**




© 2023 nga XL Ministries, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Kuptimi i Udhëheqjes Biblike të Kishës dhe Kultivimi i Karakterit për Udhëheqjen Biblike të Kishës: Shkruar dhe © 2022 nga Jonathan Anderson. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose përdoret në asnjë mënyrë pa lejen paraprake me shkrim të mbajtësit të të drejtës së autorit, përveç përdorimit të citateve të shkurtra në një përmbledhje. Për të kërkuar leje, kontaktoni publications@xlministries.org.

Përveç nëse tregohet ndryshe, citate nga Shkrimet e Shenjta të marra nga Bibla e Re Standarde Amerikane.® Të drejtat e autorit © 1960, 1971, 1977, 1995 nga Fondacioni Lockman. Përdoret me leje. Të gjitha të drejtat e rezervuara. www.lockman.org.

Dizajni dhe shtypja e kopertinës nga MOOSE77.com Botuar për herë të parë në qershor 2022 nga:

XL Ministries, Inc.
www.xlministries.org

Ky botim është printuar në Shqipëri, nga botimi origjinal " BECOMING A BIBLICAL LEADER WOMEN'S EDITION" nga XL Ministries.

Ky botim është përkthyer nga Petrika Dhimo, dhe edituar nga Jonada Sehati.

Shtypur në Shqipëri, 2026.
Versioni: 2.1 A4

# Përmbajtja

**HYRJE** *7*

**KAPITULLI 1**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Çfarë është kisha? *12*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Zanafilla – Numrat* *16*
  - Teologji sistematike: *Bibliologji* *22*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Gra që Dishepullojnë Gra* *25*
  - Disiplinë shiprtërore: *Leximi i Biblës* *27*

**KAPITULLI 2**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Kreu i Kishës *30*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Ligji i përtërirë – 2 Samuelit* *35*
  - Teologji sistematike: *Teologji e drejtë* *43*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *I paqortueshëm, me reputacion të mire* *45*
  - Disiplinë shpirtërore: *Miqësi* *48*

**KAPITULLI 3**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Qëllimi i Kishës *50*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *1 Mbretërve – Esteri* *55*
  - Teologji sistematike: *Kristologji* *64*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *E dashuron burrin e saj, e respekton, i nënshtrohet* *67*
  - Disiplinë shpirtërore: *Ungjillizim* *69*

**KAPITULLI 4**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Udhëheqja 101 *72*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Jobi – Kënga e këngëve* *78*
  - Teologji sistematike: *Pneumatologji* *85*
- KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *I do fëmijët e saj e kujdeset për ta dhe shtëpinë* *87*
  - Disiplinë shpirtërore: *Lutje* *89*

**KAPITULLI 5**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Ofiqet e Kishës: pleqtë dhe dhjakët *92*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Isaia – Danieli* *97*
  - Teologji sistematike: *Ekleziologji* *104*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Jo kryelartë* *107*
  - Disiplinë shpirtërore: *Studimi i Biblës* *109*

**KAPITULLI 6**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Udhëheqje shërbëtore *112*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Hosea – Malakia* *117*
  - Teologji sistematike: *Antropologji dhe Hamartiologji* *131*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Jo gjaknxehtë apo i ashpër, por i butë dhe paqësor* *134*
  - Disiplinë shpirtërore: *Shërbimi* *136*

**KAPITULLI 7**

- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Udhëheqje e shkëlqyer *140*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Mateu – Gjoni* *146*
  - Teologji sistematike: *Soteriologji (pjesa 1)* *152*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Jo i dhënë pas përfitimeve të pandershme apo parasë* *155*
  - Disiplinë shpirtërore: *Mësimi përmendësh i pjesëve nga Bibla* *157*

**KAPITULLI 8**


- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Shërbimi ndaj të tjerëve: T'i ndihmojmë njerëzit të ndryshojnë ..... *160*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: Veprat e Apostujve – Efesianëve ..... *167*
  - Teologji sistematike: Soteriologji (pjesa 2) ..... *175*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Jo i dhënë pas verës, i arsyeshëm, me vetëkontroll* ..... *183*
  - Disiplinë shpirtërore: *Meditim nga Bibla* ..... *185*


**KAPITULLI 9**


- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Shërbimi ndaj të tjerëve: Të kujdesemi për ata që vuajnë ..... *188*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Filipianëve – Filemonit* ..... *196*
  - Teologji sistematike: *Eskatologji* ..... *206*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Mikpritës* ..... *209*
  - Disiplinë shpirtërore: *Përsëritje* ..... *211*


**KAPITULLI 10**


- TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Shërbimi ndaj të tjerëve: Të lutemi për të tjerët ..... *214*
- TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE
  - Shqyrtim biblik: *Hebrenjve – Zbulesa* ..... *221*
  - Teologji sistematike: *Veçoritë dalluese doktrinale të kishës suaj* ..... *232*
- TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE
  - Pjekuri shpirtërore: *Të dëshironi të mirën, të drejtë, të devotshëm* ..... *234*
  - Disiplinë shpirtërore: *Përsëritje* ..... *237*

# HYRJE
# TË BËHENI UDHËHEQËS BIBLIK: VARIANTI PËR GRA
# LIBËR PUNE PËR ZHVILLIMIN E UDHËHEQËSVE NË KISHË

Kisha është shumë e rëndësishme. Ashtu sikurse shkruan edhe Robert Saucy, "Përgjatë rrjedhës së historisë, Perëndia ka punuar në botë në shumë mënyra, përmes individëve, kombeve dhe popujve. Fokusi i punës së Tij të tanishme është kisha. Është ajo e cila i pati fillimet e saj në Shkrimet, ndërkohë që burra e gra u thirrën për të njohur e pranuar Sundimin e Krishtit, e vazhdon sot si plotësim i premtimit të Krishtit për ndërtimin e kishës së Tij. Krishti jo vetëm që po e ndërton kishën e Tij, por po e përdor atë si instrumentin kryesor përmes së cilës Ai shërben në botë."[1]

Udhëheqja e kishës ka shumë rëndësi. Udhëheqësit në kishë luajnë një rol të rëndësishëm për shëndetin dhe pjekurinë e bashkësisë. Për këtë arsye, Dhiata e Re na jep mësime të qarta në lidhje me caktimin e udhëheqjes në kishë, si edhe kalon një kohë të vlefshme duke u siguruar udhëzime udhëheqësve të kishës. Udhëheqja e kishës sipas Biblës duket shumë ndryshe nga udhëheqja e botës, prandaj ajo duhet kultivuar qëllimisht përmes studimit dhe zbatimit të fjalës së Perëndisë. Ky është edhe qëllimi i librit "Të bëheni udhëheqës biblik."

Libri "Të bëheni udhëheqës biblik: Varianti për Gra" është një variant i modifikuar i librit "Të bëheni udhëheqës biblik" dhe përqendrohet te pajisja e grave. Edhe pse shumë gjëra që thuhen në Bibël janë të përshtatshme si për burrat ashtu edhe për gratë, Perëndia ka themeluar role dhe përparësi unike për gratë brenda kishës, ndërkohë që ato i përdorin dhuntitë e tyre për të ndërtuar trupin e Krishtit.

> **Titit 2:3-5**
> Po ashtu, edhe të moshuarat të kenë një sjellje prej besimtareje, të mos jenë shpifëse e të mos bëhen skllave të verës së tepërt. Ato t'u mësojnë të rejave të mirën, duke i këshilluar me urti që të duan burrat dhe fëmijët e tyre, të jenë të urta, të dëlira, të zellshme në punët e shtëpisë, të mira, të nënshtruara ndaj burrave të tyre, që të mos shahet fjala e Perëndisë.

Shpesh, theksi vendoset në ato gjëra që gratë nuk mund t'i bëjnë – të shërbejnë në rolin e pastorëve apo pleqve – dhe jo në rolin jetësor që luajnë ato në jetën e trupit.

> **Aleksandër Strauç**
> Parimi i kryesisë mashkullore nuk e zvogëlon aspak rëndësinë dhe domosdoshmërinë e përfshirjes aktive të grave në punën e Zotit. Gratë janë të jashtëzakonshme si ungjilltare, luftëtare në lutje, ndërtuese brezash, shërbyese të mëshirës, kujdestare, të pajisura me urtësi dhe adhuruese plot dashuri ndaj Zotit.[2]

---

[1] Robert Saucy, *The Church in God's Program* (Chicago, IL: Moody Press, 1972), 7.
[2] Alexander Strauch, *Men and Women, Equal Yet Different* (Littleton, CO: Lewis and Roth Publishers, 1999), 98.

Ky libër synon të ndihmojë në zhvillimin e grave besnike, të cilat janë të dalluara e të njohura prej udhëheqjes së kishës për role të tilla në shërbesën e udhëheqjes brenda kishës. Kjo kërkohet të arrihet duke siguruar një pamje të përgjithshme të botëkuptimit, të njohurisë dhe të karakterit të nevojshëm për udhëheqje biblike përmes studimit individual dhe ndërveprimit me një mentor. Ky studim shërben kryesisht për të pajisur ato që shërbejnë aktualisht si udhëheqëse, apo që mund të jenë udhëheqëse potenciale për shërbesat e grave, të fëmijëve, të të rinjve, apo të kujdesit. Megjithatë ai është i përshtatshëm për çdo grua, pasi karakteri dhe njohuria që kërkohet për udhëheqje duhet të dëshirohet fort, të ndiqet e të shfaqet në jetën e përditshme të çdo të krishteri.

Gratë që do të kalojnë përmes këtij studimi do të jenë të faza të ndryshme të jetës.

- Gratë e martuara duhet të përqafojnë me zell udhëheqjen e burrave të tyre, ndërkohë që shqyrtojnë mundësitë për të shërbyer dhe udhëhequr brenda kishës.
- Po ashtu, edhe gratë që kanë burra që nuk besojnë duhet të funksionojnë nën autoritetin e tyre sipas udhëzimeve të Biblës. Mund të ketë raste kur, nën udhëzimin dhe këshillën e pleqve të kishës, një bashkëshorte duhet t'i bindet me përulësi dhe plot hir më shumë Perëndisë sesa burrit.
- Gratë e pamartuara kanë mundësi të pashoqe për t'u përkushtuar ndaj Zotit dhe kishës. Ato duhet të përqafojnë me zell këshillat e grave të tjera të perëndishme brenda kishës, sikurse edhe ato të pleqve dhe udhëheqësve të shërbesave, duke kërkuar që t'i përdorin me besnikëri dhuntitë e tyre në kishën lokale ku ato bëjnë pjesë.

Sicili nga kapitujt e këtij libri përmban tre seksione me përgatitje individuale dhe pyetje për diskutim mentoral. Seksionet janë të veçuara dhe nuk është e nevojshme që ato të plotësohen me një të lexuar e as sipas radhës. Rekomandohet që puna të shpërndahet në disa javë mes takimeve me mentorin tuaj, për të kaluar kohë të mjaftueshme për të thithur përmbajtjen e çdo seksioni.

### 1. TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

Ky seksion siguron një kornizë biblike për të kuptuar kishën dhe udhëheqjen biblike. Aty përfshihen udhëzime biblike në lidhje me:

- **Natyrën dhe qëllimet e kishës (kapitulli 1-3),** pasi të kuptuarit e duhur të kishës është jetësore për dikë që udhëheq brenda kishës. Udhëheqësit biblikë duhet të kenë kujdes për faktin se për ku po i drejtojnë të tjerët.

- **Karakteristikat e udhëheqjes biblike (kapitulli 4-7),** pasi mënyra se si udhëheq dikush ka rëndësi vendimtare. Udhëheqësit biblikë duhet të kenë kujdes për faktin se si dhe pse po i drejtojnë të tjerët.

- **Shërbesën ndaj të tjerëve (kapitulli 8-10),** sepse udhëheqësit biblikë në kishë nuk përqendrohen thjesht në faktin që njerëzit t'i ndjekin ata, por edhe në baritimin e mirë ndaj tyre.

### 2. TË THELLOJMË NJOHURITË PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Ky seksion është projektuar për të ushqyer rritjen në të kuptuarit biblik dhe teologjik, çka është thelbësore për udhëheqësit në kishë. Ai përfshin:

- **Shqyrtim biblik** të bazuar në lexime të drejtuara dhe në mësime sugjeruara përmendësh për të përftuar një botëkuptim të gjerë për secilin nga librat e Biblës, sie edhe për temat dhe kapitujt kyçë të tyre. Rekomandohet që temat e librave të mësohen përmendësh fjalë për fjalë. Për përmbledhjen e kapitujve kyçë mund të mos jetë e nevojshme mësimi fjalë për fjalë, më tepër se kuptimi dhe kujtimi i

informacionit rreth tyre. Për shembull, të thuash që Ligji i Përtërirë 5 është "përsëritja e 10 rregullave" do të ishte e përsosur. Por të thuash që Ligji i Përtërirë 5 është "dhënia e dytë e 10 urdhërimeve" tregon që përmbajtja është kuptuar dhe kujtohet mjaftueshëm.

- **Teologji sistematike** për të kuptuar doktrinën e shëndoshë duke studiuar shpalljen doktrinale të kishës suaj, si edhe të jeni të përgatitur për të mbrojtur doktrinën e shëndoshë duke punuar për përcaktimin dhe mbrojtjen e ideve kyçe teologjike.

- Sipas dëshirës, mund të bëni edhe disa detyra shtesë për "t'u thelluar më shumë".

### 3. TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Ky seksion përqendrohet në zhvillimin e karakterit në ngjasim me Krishtin, i cili kërkohet për udhëheqësit biblikë në kishë dhe duhet të ndiqet nga çdo besimtar, duke theksuar:

- **Pjekurinë shpirtërore,** duke marrë parasysh kualifikimet biblike për udhëheqjen, të cilat sigurojnë një standart të karakterit të perëndishëm për çdo besimtar.

- **Disiplina shpirtërore** për të shfrytëzuar mjetet që ka dhënë Perëndia për të ushqyer rritjen në jetën e besimtarëve.

Një komponent kyç në librin "Të bëheni udhëheqës biblik: Varianti për Gra" janë edhe takimet e rregullta me një mentor – ndoshta dikush që është udhëheqës në kishën tuaj. Përgatitja individuale për atë kapitull duhet bërë përpara çdo sesioni. Për takimin mentoral duhet planifikuar rreth një orë e gjysmë, për të diskutuar çdo kapitull, duke i kushtuar rreth 30 minuta secilit prej tre seksioneve.[3]

[3] Informacioni kyç rreth secilit libër është përshtatur nga burimet e përgatitjes për shugurim të Master's Seminary dhe XL Ministries.

# Kapitulli 1

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **ÇFARË ËSHTË KISHA?**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Zanafilla:** Fillesat
  - **Eksodi:** Shpengimi
  - **Levitiku:** Shenjtëria
  - **Numrat:** Ecejaket në shkretëtirë

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Bibliologji**: Studimi i Doktrinës së Fjalës së Perëndisë
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Gra që Dishepullojnë Gra

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Leximi i Biblës

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## ÇFARË ËSHTË KISHA?

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Të qenët një udhëheqës besnik dhe i frytshëm në kishë përfshin shumë gjëra. Shkrimi thekson hirin e Perëndisë në zgjedhjen dhe aftësimin e udhëheqësve, pa të cilin ata nuk mund të bëjnë dot asgjë. Po ashtu, Shkrimi na udhëzon për sa i përket karakterit të nevojshëm dhe dhuntive për udhëheqje të perëndishme.

Por çfarë është udhëheqja, në thelb? Xhon MekArthër shkruan: "E thënë thjesht, udhëheqja është *ndikim*."[4] Të jesh udhëheqës është më shumë se një titull apo të zësh një karrige. Ajo nënkupton që njerëzit të të ndjekin.

Megjithatë, të jesh udhëheqës biblik nuk do të thotë thjesht të sigurohesh që njerëzit të të ndjekin, por edhe *si* dhe *pse* i motivon të tjerët, duke bërë që të të ndjekin. Ndryshe nga udhëheqësit e botës, udhëheqësit biblikë nuk tregohen superiorë për përfitime vetjake, por përkundrazi, shërbejnë dhe udhëheqin me anë të shembullit të tyre për lavdinë e Krishtit. Ata nuk i manipulojnë të tjerët me fjalë të ndritura, përkundrazi, flasin qartë të vërtetën e Perëndisë, që njerëzit ta kuptojnë, t'i binden dhe ta lavdërojnë Atë.

Përveç kujdesit që duhet të kenë për faktin se *si* dhe *pse* udhëheqin, udhëheqësit biblikë duhet të jenë edhe të qëllimshëm për faktin se *për ku* po i drejtojnë njerëzit. Për këtë, ata duhet të kenë një drejtim të qartë biblik. Prandaj edhe Pali i shkroi Timoteut, udhëheqës i ri i kishës, te 1 Timoteut 3:15, "por nëse vonohem, të dish se si duhet të sillet njeriu në shtëpinë e Perëndisë, që është kisha e Perëndisë së gjallë, shtylla dhe themeli i së vërtetës". Për të udhëhequr kishën, Timoteu duhej ta kuptonte dhe ta vlerësonte kishën. E njëjta gjë vlen edhe për çdo udhëheqës kishe.

### PËRKUFIZIMI I KISHËS

Në anglisht, fjala *kishë* vjen nga një fjalë që ka kuptimin "*i përket*", apo "*është e Zotit*". Kisha është e Zotit. Ajo është kisha e Tij dhe përbëhet nga ata që i përkasin Atij. Fjala greke është *ekklesia*, që ka kuptimin *asamble*.

Dhiata e Re i referohet kishës në dy mënyra kryesore:

1. **Kisha Universale** – Kisha *e dukshme* universale përbëhet nga të gjithë *besimtarët që kanë shpallur besimin e tyre*. Kisha *e padukshme* janë të gjithë ata që janë *vërtet të shpenguar*.
2. **Kisha Lokale** – Besimtarët që shpallin besimin e që mblidhen bashkërisht në një bashkësi lokale përbëjnë kishën lokale. Në të shumtën e rasteve në Dhiatën e Re, fjala *kishë* i referohet këtyre besimtarëve, kishave lokale.

Kisha nuk është ndonjë ndërtesë apo denominacion. Përkundrazi, kisha janë të gjithë të shpenguarit e Perëndisë, të cilët mblidhen në bashkësi lokale. Jezui premtoi se do të ndërtonte kishën e Tij (Mateu 16:13-19), të cilën e nisi në ditën e Pentakostit (Veprat e Apostujve 2), dhe vazhdon edhe sot të ndërtojë kishën universale dhe kishat lokale.

[4] John MacArthur, *Called to Lead* (Nashville, TN: Thomas Nelson, 2004), vi.

## IMAZHI I KISHËS

Dhiata e Re përdor metafora të ndryshme për të na dhënë një tablo të gjallë të kishës. Secila prej tyre na kujton fuqishëm marrëdhënien e kishës me Krishtin, si edhe marrëdhënien e secilit prej anëtarëve të kishës me njëri-tjetrin.

1. **Trupi i Krishtit**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e trupit të Krishtit në vargjet e mëposhtme?
     - Efesianëve 1:22-23
     - Efesianëve 4:11-16
     - 1 Korintasve 12:12-27
   - Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e "trupit të Krishtit"?

2. **Tempulli i Perëndisë**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e ndërtesës, apo e tempullit, në vargjet e mëposhtme?
     - 1 Korintasve 3:9-17
     - Efesianëve 2:20-22
     - 1 Pjetrit 2:4-5

- Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e “tempullit të Perëndisë”?

3. **Shtëpia, apo Familja e Perëndisë**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e shtëpisë, apo e familjes, në vargjet e mëposhtme?
     - Efesianëve 2:19, 3:14-15, 4:6
     - 2 Korintasve 6:18
   - Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e “familjes së Perëndisë”?

4. **Nusja e Krishtit**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e nuses së Krishtit, në vargjet e mëposhtme?
     - 2 Korintasve 11:1-2
     - Efesianëve 5:22-33
     - Zbulesa 19:7, 21:9
   - Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e “nuses së Krishtit”?

5. **Shtylla dhe Mbështetja e së Vërtetës**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e shtyllës, apo e themelit, në vargun e mëposhtëm?
     - 1 Timoteut 3:15

   - Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e "shtyllës dhe themelit mbështetës të së vërtetës"?

6. **Grigja e Perëndisë**
   - Çfarë mësoni në lidhje me kishën nga metafora e grigjës, në vargjet e mëposhtme?
     - Gjoni 10:16

     - Veprat e Apostujve 20:28-29

     - 1 Pjetrit 5:1-4

   - Si duhet të jetoni me besnikëri si pjesë e "grigjës së Perëndisë"?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si ju ka ndihmuar ky studim për të qartësuar kuptimin tuaj mbi kishën?
3. Cilat janë disa nga mënyrat e zakonshme me të cilat keqkuptohet kisha, sot?
4. Përse duhet që kisha të ketë përparësi në jetën e çdo besimtari?
5. Përse është e rëndësishme që udhëheqësit e shërbesave të kenë një pikëpamje të saktë për kishën?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Të bëheni udhëheqës biblik kërkon më shumë se të mbushni kokën me njohuri, edhe pse kjo nuk përjashtohet. Një udhëheqës besnik e i perëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella rreth Biblës dhe doktrinave kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Ezra 7:10**
> Ezra ishte dhënë me gjithë zemër pas shqyrtimit të ligjit të Zotit , për ta zbatuar e për t'u mësuar izraelitëve rregullat dhe vendimet e tij.

## SHQYRTIM BIBLIK

**PËRGATITJE INDIVIDUALE:**

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për “thellim të mëtejshëm”.

## ZANAFILLA

Zanafilla është libri i fillesave; ai na jep një përshkrim dramatik të origjinës së njerëzimit dhe universit të tij, hyrjen e mëkatit në botë, pasojat katastrofike të mallkimit të tij mbi njerëzimin, dhe fillesat e planit të Perëndisë për të bekuar kombet përmes farës së Tij.[5]

### SKICIMI:

I. Historia e Hershme – Katër Ngjarje (1-11)

| | |
|---|---|
| A. Krijimi | (1-2) |
| B. Rënia në mëkat | (3-5) |
| C. Përmbytja | (6-9) |
| D. Kombet | (10-11) |

II. Historia Patriarkale – Katër Njerëz (12-50)

| | |
|---|---|
| A. Abrahami | (12-24) |
| B. Isaku | (25-26) |
| C. Jakobi | (27-36) |
| D. Jozefi | (37-50) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Fillesat

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 1 | Krijimi (këndvështrim i gjerë), Perëndia si Krijues |
| 2 | Krijimi (përqendrim te njeriu; besëlidhja me Adamin) |
| 3 | Tundimi; rënia në mëkat; mallkimet |
| 4 | Kaini dhe Abeli; linja e Kainit – qytetërimi |
| 6-8 | Përmbytja: shpëtimi brenda arkës |
| 9 | Besëlidhja e përjetshme; mallkimi i Kanaanit |
| 11 | Babeli: shpërndarja e kombeve |
| 12 | Thirrja e Abramit |
| 18-19 | Sodoma dhe Gomorra |
| 37 | Jozefi shitet nga vëllezërit e vet |

- Përse “fillesat” është tema e duhur për librin e Zanafillës?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Zanafillës.
- Lexoni gjithë librin e Zanafillës

[5] J. F. Walvoord, R. B. Zuck and Dallas Theological Seminary, *The Bible Knowledge Commentary: An Exposition of the Scriptures* (Wheaton, IL: Victor, 1983–c1985), 1:15.

## EKSODI

Eksodi rrëfen çlirimin e Izraelit nga robëria e tyre në Egjipt dhe migrimin e kombit të ri të Perëndisë drejt shkretëtirës së Sinait... Kapitujt 1-18 lidhen me eksodin e Izraelit nga skllavëria në Egjipt, ndërsa kapitujt 19-40 regjistrojnë udhëzimet e dhëna nga Perëndia në malin Sinai për të drejtuar jetën dhe adhurimin e kombit.[6]

### SKICIMI:

I. Izraeli në Egjipt (1-13
II. Izraeli në Egjipt (14-18)
III. Izraeli në Sinai (19-40)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Shpengimi

### KAPITUJT KYÇË:

3-4 Thirrja e Moisiut
7-11 Dhjetë Ndëshkimet
12 Mbikalimi
20 Dhjetë Urdhërimet
32 Viçi i artë

- Përse "shpengimi" është tema e duhur për librin e Eksodit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Eksodit.
- Lexoni gjithë librin e Eksodit.

[6] Bruce Wilkinson and Kenneth Boa, *Talk Thru the Bible* (Nashville, TN: Thomas Nelson, 1983), 12.

## LEVITIKU

Te Levitiku mësojmë se duhet të merremi me mëkatin dhe se Perëndia kërkon jetesë të shenjtë... Levitiku na tregon se si mund t'i afrohen Perëndisë së shenjtë njerëzit mëkatarë dhe si mund të bëjnë një jetë të shenjtë.[7]

**SKICIMI:**

I. Udha për te Perëndia (1-17)
II. Ecja me Perëndinë (18-27)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Shenjtëria

**KAPITUJT KYÇË:**

10 Nadabi dhe Abihu
16 Dita e shlyerjes

- Përse "shenjtëria" është tema e duhur për librin e Eksodit?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Levitikut.
- Lexoni gjithë librin e Levitikut.

[7] Herbert Wolf, *An Introduction to the Old Testament Pentateuch* (Chicago, IL: Moody, 1991), 160.

## NUMRAT

Libri i Numrave ka marrë këtë emër pasi regjistron numërimin e fëmijëve të Izraelit, organizimin e tyre, si edhe detyrat e përcaktuara sipas fiseve. Si vazhdim i Eksodit, ai lidhet me ecejaket e izraelitëve në shkretëtirë pas dështimit të tyre prej mosbesimit për të hyrë në tokën e premtuar.[8]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Sinai | (1-10) |
| II. | Shkretëtira | (11-25) |
| III. | Fushat e Moabit | (26-36) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Ecejaket në Shkretëtirë

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 13 | Udhëtimi drejt Kanaanit dhe kthimi i 12 vëzhguesve |
| 22-24 | Balaami, Balaku dhe gomari që flet |

- Përse “ecejaket në shkretëtirë” është tema e duhur për librin e Eksodit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Numrave.
- Lexoni gjithë librin e Numrave.

[8] Gerard Chrispin, *The Bible Panorama* (Canada: Day One, 2005), 78.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Zanafillës?
    - Çfarë ka te Zanafilla 3?
    - Cila është tema e Eksodit?

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve përkatëse.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË

> **Isaia 40:8**
> Thahet bari, vyshket lulja, por fjala e Perëndisë tonë mbetet në amshim.

**Bibliologjia** është studimi i doktrinës së fjalës së Perëndisë.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në bibliologji janë:

- Zbulesa
- Karakteristikat e Shkrimit
  - Frymëzimi
  - Pagabueshmëria
  - Mjaftueshmëria
- Kanuni i Shkrimit

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e fjalës së Perëndisë.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth Bibliologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### SI E PËRKUFIZONI PAGABUESHMËRINË E SHKRIMIT?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - 2 Timoteut 3:16-17
  - 2 Pjetrit 1:20-21

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Mejhju në *Doktrina Biblike***
> Fjalë për fjalë, pagabueshmëri do të thotë "pa gabime". Kur flasim për Shkrimin, kjo do të thotë që Bibla është pa gabime në kopjet e saj origjinale. Prandaj, kur interpretohet si duhet, ajo nuk pajtohet me asgjë që është e pavërtetë apo kundër faktit...
>
> Thënia e drejtpërdrejtë e Palit për Shkrimin është se ai është i frymëzuar nga Perëndia (2 Tim. 3:16). Ai është produkt i punës së vetë Perëndisë përmes autorëve njerëzorë me anë të Frymës së Tij (2 Pje. 1:20-21). Meqë këto fjalë të shkruara janë fjalët e Perëndisë së të vërtetës, atëherë ato duhet të jenë pa gabime. Frymëzimi ka të bëjë me mënyrat e hartimit të tekstit, por nënkupton gjithashtu që kjo është puna e Perëndisë. Si e tillë, pra, produkti përfundimtar i atribuohet Atij. Pavarësisht përfshirjes së veprimtarisë njerëzore në procesin e hartimit, është integriteti i autorit hyjnor ai që ruan vlerën në doktrinën e pagabueshmërisë.[9]

- Përkufizoni me fjalët tuaja pagabueshmërinë e Shkrimit:

[9] John MacArthur and Richard Mayhue, eds., *Biblical Doctrine: A Systematic Summary of Bible Truth* (Wheaton, IL: Crossway, 2017), 109.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për fjalën e Perëndisë si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme:
    - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE TË KISHËS

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Nensi DeMoss Ulgemuth**
> Modeli biblik i grave më të moshuara që e jetojnë ungjillin dhe i mësojnë më të rejat që të veprojnë në të njëjtën mënyrë, ndërkohë që më të rejat e njohin vlerën që kanë gratë më të moshuara në jetën e tyre – gra që jepen bashkërisht pas ungjillit – ky model pra është jetësor për të gjithë ne, në rritjen tonë.[10]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak.

- **Gra që dishepullojnë gra**

  **Titit 2:3-5** Po ashtu, edhe të moshuarat të kenë një sjellje prej besimtareje, të mos jenë shpifëse e të mos bëhen skllave të verës së tepërt. Ato t'u mësojnë të rejave të mirën, duke i këshilluar me urti që të duan burrat dhe fëmijët e tyre, të jenë të urta, të dëlira, të zellshme në punët e shtëpisë, të mira, të nënshtruara ndaj burrave të tyre, që të mos shahet Fjala e Perëndisë.

  - Si synon që t'i përdorë Perëndia gratë e moshuara për të ndihmuar më të rejat që të rriten në pjekurinë shpirtërore?

  - Cilat janë disa nga format e ndryshme se si mund të ndodhin inkurajimi dhe mësimdhania në kontekstin e kishës?

[10] Nancy DeMoss Wolgemuth, *Adorned* (Chicago, IL: Moody Publishers, 2017), 20.

- Cilat janë ato qëndrime apo sjellje mes grave më të moshuara që mund të bëhen pengesë për këtë dishepullim? Po ato mes grave më të reja?

- Si duhet të jenë shembull gratë e moshuara për ato më të rejat?

- Cili është qëllimi që përmendet në fund të këtij pasazhi në lidhje me udhëzimin dhe inkurajimin e të moshuarave ndaj më të rejave? Si i jep formë ky qëllim udhëzimit dhe inkurajimit të dhënë?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Në ç'mënyrë keni përfituar nga ndikimi i grave më të moshuara e të perëndishme?
3. Si po kërkoni të tregoheni besnike si për të mësuar, ashtu edhe për të investuar te të tjerët?
4. Cilat janë disa nga justifikimet e zakonshme që jepen për të mos i dëgjuar e mos i pranuar udhëzimet e më të moshuarave?
5. Cilat janë disa nga sfidat praktike në lidhje me dishepullimin e më të rejave nga më të moshuarat? Si mund të tejkalohen këto sfida?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## LEXIMI I BIBLËS

> **Psalmi 119:97-100**
> Sa shumë e dua ligjin tënd! Gjithë ditën e përsiat! Urdhërimi yt më bën më të urtë se armiqtë, se është përherë me mua. Jam më i ditur se të gjithë mësuesit e mi, sepse dëshmitë e tua janë përsiatja ime. Jam më i mençur edhe se pleqtë, sepse mbaj porositë e tua.

> **Xherri Brixhis**
> Leximi i Biblës na mundëson... të shijojmë komunikimin me Perëndinë, ndërkohë që Ai na flet nga fjala e Tij, na inkurajon, na udhëzon dhe na shfaq veten e Tij.[11]

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të leximit të Biblës.

- Përse është i rëndësishëm leximi i Biblës, për rritje në pjekurinë shpirtërore?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Ndani me njëri-tjetrin ato që keni mësuar kohët e fundit nga leximi i Biblës?

[11] Jerry Bridges, *The Practice of Godliness* (Colorado Springs, CO: NavPress, 1996), 39.

# Kapitulli 2

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **KREU I KISHËS**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Ligji i përtërirë:** Ligji i dytë/Besëlidhje e rinovuar
  - **Jozuehu:** Pushtim dhe Ndarje
  - **Gjyqtarët:** Mosbindje dhe Disfatë
  - **Ruta:** Shpenguesi Farefisnor
  - **1 Samuelit:** Tranzicioni nga Gjyqtarët te Monarkia
  - **2 Samuelit:** Sundimi i Davidit si Mbret

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Teologji e Drejtë:** Studimi i Doktrinës së Perëndisë
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Si do ta përshkruanit Trininë?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - I paqortueshëm
  - Të keni reputacion të mirë ndër të jashtmëve

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Miqësi

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## KREU I KISHËS

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Të qenët udhëheqës do të thotë që të ndikosh te të tjerët. Të qenët udhëheqës biblik do të thotë që të tregosh kujdes për faktin se *si* dhe *pse* ndikon dikush te të tjerët, madje edhe se *ku* po i çon të tjerët ky ndikim. Udhëheqësit botërorë mbizotërojnë ndaj ndjekësve të tyre, duke përdorur autoritetin e tyre për përparimin dhe përfitimin e tyre personal.

Nga ana tjetër, udhëheqësit besnikë në kishë e kuptojnë se nuk po i udhëheqin të tjerët thjesht për t'u ardhur nga pas, por për të shkuar pas Krishtit. Sikurse tha Pali te 1 Korintasve 11:1, "Më shkërbeni mua, sikurse unë shkërbej Krishtin". Udhëheqësit biblikë e kuptojnë vendin e tyre në lidhje me Krishtin. Ai është shembulli i përsosur që ata e ndjekin. Synimi është lavdia e Tij, jo e tyre. Autoriteti i Tij është përfundimtar, pasi Krishti është kreu i kishës.

> **Efesianëve 1:22-23**
> Perëndia e nënshtroi gjithçka nën këmbët e Krishtit dhe e bëri atë kreun e kishës, përmbi çdo gjë. Kisha është trupi i Krishtit, është plotësia e atij që me praninë e tij bën gjithçka të plotë.

> **Kolosianëve 1:18**
> Ai është kreu i trupit, domethënë i kishës, fillimi i jetës së re, i pari që u ngjall prej të vdekurve, që të jetë i pari në gjithçka.

- Lexoni Zbulesën 1:12-20.
  - Çfarë janë shandanët?

  - Çfarë tregon ecja e Krishtit përmes shandanëve në lidhje me marrëdhënien e tij me kishën?

Dhiata e Re tregon shumë përsa i përket realitetit dhe ndikimit të Krishtit si kreu i kishës.

## KRISHTI, SHPËTIMTARI

Krishti është në mënyrë unike kreu i kishës sepse vetëm ai është shpëtimtari i saj.

> **Efesianëve 5:23-25**
> ... Krishti është kreu i kishës dhe është shpëtimtar i trupit, domethënë i kishës... Krishti e deshi kishën dhe e dha veten për të.

> **Zbulesa 5:9**
> Ata këndonin një këngë të re e thoshin: "I denjë je për të marrë librin dhe për të thyer vulat e tij, sepse u there e me gjakun tënd ke blerë për Perëndinë njerëz nga çdo fis, gjuhë, popull e komb."

- Si e shpëtoi Krishti kishën?

- Si duhet të na motivojë dashuria e Krishtit për kishën që edhe ne ta duam kishën?

- Si duhet të ndikojë fakti që Krishti është shpëtimtari i kishës ndaj reagimit që kisha duhet të ketë për Të?

## KRISHTI, SOVRANI

Si kreu i kishës, Krishti ka autoritet mbi kishën. Ai është Zoti Sovran.

> **Efesianëve 1:22-23**
> Perëndia e nënshtroi gjithçka nën këmbët e Krishtit dhe e bëri atë kreun e kishës, përmbi çdo gjë. Kisha është trupi i Krishtit, është plotësia e atij që me praninë e tij bën gjithçka të plotë.

> **Efesianëve 5:23-24**
> Krishti është kreu i kishës dhe... kisha i nënshtrohet Krishtit.

- Si e ushtron Krishti autoritetin e tij mbi kishën?

- Si duhet ta reflektojnë udhëheqësit e kishës autoritetin e Krishtit mbi kishën? Në ç'mënyrë ata nuk duhet ta reflektojnë?

- Si duhet të ndikojë fakti që Krishti është sovrani mbi kishën ndaj reagimit që kisha duhet të ketë për Të?

## KRISHTI, BURIMI

Krishti, kreu, nuk sundon mbi kishën si një mbret nga larg dhe i izoluar. Përkundrazi, Ai është kreu i cili është i lidhur me trupin dhe është Ai prej të cilit buron jeta dhe rritja.

> **Efesianëve 4:11-16**
> Disa ai i bëri apostuj, disa i bëri profetë, disa i bëri ungjilltarë, disa i bëri barinj e mësues, që të përgatisë të shenjtët për të kryer veprën e shërbimit ndaj të tjerëve, për rritjen në besim të trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë në njëshmërinë e besimit dhe në njohjen e Birit të Perëndisë. Kështu do të bëhemi njerëz të përsosur, sipas masës së përsosmërisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnja, të hedhur andej-këtej, që i vërtit era e çdo mësimi njerëzor dhe që e lënë veten të mashtrohen nga dinakëria e dredhia e njerëzve. Por, duke dëshmuar të vërtetën me dashuri, le të rritemi plotësisht drejt atij që është kreu, Krishtit. Ai bashkon e lidh gjithë trupin nëpërmjet nyjeve dhe çdo gjymtyrë, sipas detyrës së vet, ndihmon në rritjen e trupit dhe në forcimin e tij në dashuri.

> **Kolosianëve 2:18-19**
> Mos lejoni t'ju gjykojë ndonjëri që hiqet si më i lartë për shkak të vegimeve që ka parë apo që këmbëngul në përulësi të jashtme e në adhurime engjëjsh, sepse ky njeri krekoset më kot për shkak të mendjes së tij njerëzore. Ai njeri nuk ka lidhje me kreun e trupit, Krishtin, nga i cili ushqehet i gjithë trupi dhe mbahet i lidhur me anë të nyjave dhe të kyçeve, duke u rritur sipas vullnetit të Perëndisë.

- Si e bën Krishti rritjen e trupit? A bën Ai që trupi të rritet veçmas funksionimit të duhur të gjymtyrëve apo pjesëve të tjera të tij?

- Përse nuk mund të rritet dot trupi nëse veçohet prej Tij?

- Si duhet të ndikojë fakti që Krishti është burimi i jetës dhe i rritjes së kishës ndaj reagimit që kisha duhet të ketë për Të?

## KRISHTI, BARIU

Krishti është i përfshirë në mënyrë intime në kujdesin, sigurimin dhe drejtimin e grigjës së Tij. Edhe pse përdor pleq për të barituar grigjën e Vet, Ai është Kryebariu.

> **1 Pjetrit 5:1-4**
> U lutem pleqve tuaj, unë që jam plak bashkë me ta, si dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit e pjesëtar i lavdisë që do të shfaqet: ruajeni grigjën e Perëndisë që ju është besuar dhe mbikëqyreni jo me detyrim, por vullnetarisht sipas dëshirës së Perëndisë, as për përfitim, por me dëshirë. Mos u sillni si sundues mbi ata që ju janë besuar, por bëhuni shembull për grigjën dhe kur të shfaqet Kryebariu do të merrni kurorën e lavdisë që nuk vyshket.

> **Psalmi 23**
> Zoti është bariu im, asgjë s' më mungon. Në kullota të gjelbra më shtrin, drejt ujërave të qeta më prin, shpirtin ma përtërin. Më udhëheq shtigjeve të drejta, në saje të emrit të tij. Edhe në ecsha nëpër luginën e territ, s'tutem nga e keqja, se ti je me mua. Shkopi yt e kërraba jote, ato më ngushëllojnë. Para ma shtron tryezën, kundruall armiqve të mi; kokën ma lyen me vaj, kupa ime gufon. Po, mirësia e çiltërsia do të më ndjekin të gjitha ditët e jetës sime. E unë do të banoj përgjithmonë në shtëpinë e Zotit.

- Si kujdeset dhe në ç'mënyrë siguron Krishti për grigjën e Tij, kishën?

- Si duhet të ndikojë fakti që Krishti është Kryebariu i kishës ndaj reagimit që kisha duhet të ketë për Të?

Krishti është kreu i kishës. Udhëheqësit biblikë duhet ta njohin e ta pranojnë autoritetin e Tij dhe të varen tërësisht prej punës dhe shërbesës së Tij. Udhëheqësit besnikë të kishës nuk duhet të kërkojnë përfitimin e tyre personal. Përkundrazi, ata duhet të kërkojnë që të ndikojnë kishën për të ndjekur planin e Tij dhe t'i udhëheqin të tjerët me anë të fjalëve dhe shembullit të tyre për t'u bërë më të ngjashëm me Krishtin.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si ju ka ndihmuar ky studim për të thelluar kuptimin tuaj mbi Krishtin si kreun e kishës?
3. Përse është e rëndësishme që udhëheqësit e shërbesave ta njohin e ta pranojnë Krishtin si kreun e kishës?
4. Cilat mund të jenë disa nga pasojat e mundshme nëse e neglizhojmë apo e humbasim idenë e kryesimit të Krishtit?
5. Si mund të jetë burim e vërteta që Krishti është kreu i kishës, në mënyrë që:
    - udhëheqësit e shërbesave të gjejnë ngushëllim?
    - udhëheqësit e shërbesave të janë llogaridhënës?
    - udhëheqësit e shërbesave të kenë unitet mes njëri-tjetrit?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i përëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **2 Timoteut 2:15**
> Mundohu të dalësh i sprovuar para Perëndisë, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që e shpjegon drejt fjalën e së vërtetës.

## SHQYRTIM BIBLIK

**PËRGATITJE INDIVIDUALE:**

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## LIGJI I PËRTËRIRË

Ligji i Përtërirë... përmban një sërë mesazhesh lamtumire prej udhëheqësit 120-vjeçar (Moisiut) të Izraelit. Ai i drejtohet brezit të ri të paracaktuar për të zotëruar Tokën e Premtuar – ata që mbijetuan për vite gjatë ecejakeve në shkretëtirë. Ashtu sikurse Levitiku, edhe Ligji i Përtërirë përmban një sasi të madhe detajesh ligjore, por theksi i tij bie më shumë te njerëzit e thjeshtë sesa te priftërinjtë dhe sakrificat. Moisiu i kujton brezit të ri rëndësinë e bindjes, nëse dëshirojnë të mësojnë nga shembujt e hidhur të paraardhësve të tyre.[12]

### SKICIMI:

I. Të Vështrosh Pas (1-11)
II. Të Vështrosh Përpara (12-32)
III. Të Vështrosh Lart (33-34)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Ligji i Dytë/Besëlidhja e Rinovuar

### KAPITUJT KYÇË:

5 Ripërsëritja e Dhjetë Ligjeve
28 Bekimet dhe mallkimet
32 Kënga e Moisiut
34 Vdekja e Moisiut

- Përse “Ligji i dytë/besëlidhja e rinovuar” është tema e duhur për librin e Ligjit të Ripërtërirë?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Ligjit të Ripërtërirë.
- Lexoni gjithë librin e Ligjit të Ripërtërirë.

[12] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 36.

## JOZUEHU

Jozuehu regjistron besnikërinë e Perëndisë ndaj premtimeve të Tij për ta sjellë popullin e Tij në Tokën e Premtuar... Libri i Jozuehut tregon se Izraeli duhet t'i besojë dhe t'i bindet Perëndisë për të dalë fitimtar në betejë, si edhe nënvizon vlerën thelbësore të Fjalës së Perëndisë.[13]

### SKICIMI:

I. Pushtimi i Tokës (1-12)
II. Ndarja e Tokës (14-18)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Pushto dhe Ndaj

### KAPITUJT KYÇË:

2 Rahabi dhe vëzhguesit
6 Rënia e Jerikos
7 Mëkati i Akanit

- Përse "pushto dhe ndaj" është tema e duhur për librin e Jozuehut?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Jozuehut.
- Lexoni gjithë librin e Jozuehut.

[13] Chrispin, *The Bible Panorama*, 106.

## GJYQTARËT

Libri i Gjyqtarëve qëndron në një kontrast të errët me librin e Jozuehut. Te Jozuehu, një popull i bindur e pushtoi tokën përmes besimit në fuqinë e Perëndisë. Ndërsa te Gjyqtarët, një popull i pabindur e idhujtar mposhtet vazhdimisht për shkak të rebelimit që shfaqin ndaj Perëndisë. Në shtatë cikle të dukshme mëkati, Gjyqtarët tregon se si e ka lënë kombi mënjanë ligjin e Perëndisë dhe në vend të tij "secili vepronte si t'i dukej e drejtë" (21:25).[14]

### SKICIMI:

I. Mosbindja te Gjyqtarët (1-2)
II. Historia e Gjyqtarëve (3-16)
III. Heqja Dorë te Gjyqtarët (17-21)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

### TEMA: Mosbindje dhe Mposhtje

### KAPITUJT KYÇË:

6-8 Gideoni si Gjyqtar
13-16 Samsoni si Gjyqtar

- Përse "mosbindje dhe mposhtje" është tema e duhur për librin e Eksodit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Gjyqtarëve.
- Lexoni gjithë librin e Gjyqtarëve.

[14] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 58.

## RUTA

Ruta regjistron një histori dashurie gjatë paqëndrueshmërisë së Izraelit në kohën e gjyqtarëve... Ky libër nuk është vetëm një raportim historik për mënyrën se si i nderon Perëndia ata që e nderojnë Atë, duke i kthyer përmbys rrethanat e trishtueshme të Naomit dhe të Rutës, por ai është gjithashtu edhe një tablo e gjallë aktive e rolit të bekuar të shpengimtarit (Boazit).[15]

## SKICIMI:

I. Rikthimi i Rutës (1)
II. Të korrat e Rutës (2)
III. Kërkesa e Rutës (3)
IV. Shpengimi i Rutës (4)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Shpengimtari farefisnor

## KAPITUJT KYÇË:

4 Boazi e shpengon Rutën dhe martohet me të

- Përse "shpengimtari farefisnor" është tema e duhur për librin e Rutës?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Rutës.
- Lexoni gjithë librin e Rutës.

[15] Chrispin, *The Bible Panorama*, 123.

## 1 SAMUELIT

Libri i Parë i Samuelit përshkruan tranzicionin e udhëheqjes në Izrael nga gjyqtarët te mbretërit. Në libër spikatin tre personazhe: Samueli, gjyqtari i fundit dhe profeti i parë; Sauli, mbreti i parë i Izraelit; dhe Davidi, i zgjedhuri mbret, i vajosur, por akoma i papranuar si pasuesi i Saulit.[16]

### SKICIMI:

I. Përgatitja për Monarkun - Samueli (1-9)
II. Periudha e Monarkut - Sauli (10-31)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Tranzicioni nga Gjyqtarët drejt Monarkisë

### KAPITUJT KYÇË:

8-10 Izraeli zgjedh një mbret
15 Sauli nuk i shfaros amalekitët
16 Vajosja e Davidit

- Përse "tranzicioni nga gjyqtarët drejt monarkisë" është tema e duhur për librin e Parë të Samuelit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Samuelit.
- Lexoni gjithë librin e 1 Samuelit.

[16] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible,* 70.

## 2 SAMUELIT

Libri i Dytë i Samuelit regjistron pikat më kryesore të mbretërimit të Davidit, fillimisht mbi territorin e Judës, e në fund mbi tërë kombin e Izraelit. Libri ndjek ngritjen e Davidit në fron, mëkatet e tij kulmore të tradhtisë bashkëshortore dhe të vrasjes, si dhe pasojat shkatërrimtare të këtyre mëkateve ndaj familjes së tij dhe gjithë kombit.[17]

### SKICIMI:

I. Triumfet e Davidit (1-10)
II. Shkeljet e Davidit (11-12)
III. Telashet e Davidit (13-24)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Sundimi i Davidit si Mbret

### KAPITUJT KYÇË:

5 Davidi si mbret mbi gjithë Izraelin
11 Batsheba

- Përse "sundimi i Davidit si mbret" është tema e duhur për librin e Dytë të Samuelit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Samuelit.
- Lexoni gjithë librin e 2 Samuelit.

[17] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 78.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Jozuehut?
    - Cila është tema e Rutës?
    - Çfarë gjendet te 1 Samueli 16?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Numrat.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – TEOLOGJI E DUHUR

> **Romakëve 11:33**
> O thellësi e pasurisë, e urtisë dhe e njohjes së Perëndisë! Sa të padepërtueshme janë gjykimet e tij dhe sa të pagjurmueshme janë udhët e tij!

**Teologjia** e duhur është studimi i doktrinës së Perëndisë.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në Teologjinë e Duhur janë:

- Ekzistenca e Perëndisë
- Natyra e Perëndisë
- Emrat e Perëndisë
- Atributet e Perëndisë
- Dekreti apo vullneti i Perëndisë

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Perëndisë.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth Teologjisë së duhur në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### SI DO TA PËRKUFIZONIT TRININË?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Ligji i Përtërirë 6:4
  - Isaia 44:6; 46:9-10
  - Mateu 3:16-17
  - Mateu 28:19
  - 2 Korintasve 13:14

> **J. I. Pekër, në T*eologji e Përmbledhur***
> Pohimi bazë i kësaj doktrine thekson se uniteti i të vetmit Perëndi është i ndërlikuar. Tri "qeniet ekzistenciale personale të jetës" (sikurse quhen) janë qëndra të barabarta e të përjetshme të vetë-ndërgjegjësimit, secila duke qenë "unë" në raport me dy të tjerat që janë "ju", dhe secila prej tyre është pjesëmarrëse në esencën e plotë hyjnore së bashku me dy të tjerat ("përbërja" e hyjnores, nëse guxojmë ta quajmë kështu). Ato nuk janë tri role të ndryshme të luajtura nga një person (që është modalizëm), dhe as nuk janë tri perëndi në një bashkim (që është triteizëm, apo të qenët tri zot); i vetmi Perëndi (Ai) është apo ashtu edhe i barabartë me "Ata", dhe "Ata" qëndrojnë gjithmonë së bashku dhe në bashkëpunim të përjetshëm, duke qenë Ati iniciatori, Biri përmbushësi, dhe Fryma që zbaton vullnetin e të dyve, që është gjithashtu edhe vullneti i vet. Kjo është e vërteta rreth Perëndisë e cila u zbulua përmes fjalëve dhe veprave të Jezuit dhe që mbështet realitetin e shpëtimit të parashtruar nga Dhiata e Re.[18]

- Përkufizoni trininë me fjalët tuaja:

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Perëndisë si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme:
   - Si do ta përshkruanit trininë?
3. Rishikoni pyetjen e mëposhtme:
   - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?

[18] J. I. Packer, *Consise Theology: A guide to Historic Christian Beliefs* (Wheaton, IL: Tyndale House, 1993), 42.

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Xhon MekArthër**
> Shkrimi nuk e poshtëron kurrë intelektin e fermave, nuk minimizon talentet dhe aftësitë e grave dhe as nuk i kundërvihet përdorimit të drejtë të dhuntive të tyre shpirëtore. Madje sa herë që Bibla flet hapur për veçoritë e një gruaje të shkëlqyer, theksi bie gjithnjë te virtyti femëror. Gratë më domethënëse në Shkrim patën ndikim jo prej karrierës, por për shkak të karakterit të tyre.[19]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhmte biblike për një plak, duke kuptuar që ato duhen zotëruar nga çdo person që shërben në udhëheqje në kishë, si edhe duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **I paqortueshëm**

  **1 Timoteut 3:2** Peshkopi duhet të jetë i patëmetë…

  **Titit 1:5-6** …të caktosh pleq nëpër kisha në çdo qytet, ashtu siç të urdhërova. Plaku i kishës duhet të jetë i paqortueshëm…

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

[19] John MacArthur, *Twelve Extraordinary Women* (Nashville, TN: Thomas Nelson, 2005), xvii.

- A është e nevojshme kjo cilësi vetëm për udhëheqësit, apo duhet që çdo besimtar të bëjë përpjekje për të qenë i paqortueshëm? Pse?

- Në cilat fusha të jetës nuk jeni duke bërë një jetë të paqortueshme? Si mund të rriteni në këto fusha?

- **Të ketë një emër të mirë mes atyre që janë jashtë**

  **1 Timoteut 3:7** Ai duhet të gëzojë edhe respektin e atyre që janë jashtë kishës, që të mos përgojohet e të bjerë në kurthin e djallit.

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni 1 Pjetrit 2:11-12, 3:16. Përse duhet që çdo besimtar të jetë i kujdesshëm për reputacionin që lë mes të tjerëve? Nëse bëjmë një jetë të perëndishme, a kemi garanci që do të lëmë një emër të mirë mes të tjerëve?

  - Si do ta përshkruanit reputacionin tuaj mes jobesimtarëve që njihni?

  - Si mund të rriteni për të përmirësuar reputacionin tuaj?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Ku ndryshon të qenët i paqortueshëm apo reputacioni i mirë në krahasim me të qenët i përsosur?
3. Në përpjekjet për një reputacion të mirë, si mund të mbrohet një besimtar ndaj jetesës thjesht për t'iu pëlqyer të tjerëve më tepër sesa Zotit?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## BASHKËSI/MIQËSI

> **Hebrenjve 10:24-25**
> Le të kujdesemi për njëri-tjetrin, duke e nxitur për dashuri e për vepra të mira, pa hequr dorë nga të mbledhurit së bashku, siç e kanë bërë zakon disa. Përkundrazi, le të nxisim njëri-tjetrin më shumë tani që shihni se po afron Dita e Zotit.

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të bashkësisë e miqësisë brenda kishës.

- Përse është e rëndësishme bashkësia dhe miqësia e rregullt për rritje në pjekurinë shpirtërore?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Diskutoni mbi përfshirjen aktuale të familjes tuaj në kishën lokale?
3. Diskutoni se në ç'mënyrë i jepni përparësi bashkësisë dhe miqësisë me besimtarë të tjerë. Çfarë sfidash hasni në lidhje me këtë gjë?

# Kapitulli 3

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **QËLLIMI I KISHËS**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **1 Mbretërve:** Mbretëri e Bashkuar dhe e Ndarë
  - **2 Mbretërve:** Rënia e Izraelit dhe e Judës
  - **1 Kronikave:** Pikëpamja e Perëndisë për Davidin
  - **2 Kronikave:** Pikëpamja e Perëndisë për mbretërit e Judës
  - **Ezra:** Rindërtimi i Tempullit dhe i Njerëzve
  - **Nehemia:** Rindërtimi i Mureve
  - **Esteri:** Ruajtja përmes Përkujdesit Hyjnor

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Kristologji:** Studimi i Doktrinës së Krishtit
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - E dashuron burrin e saj
  - E respekton dhe i nënshtrohet burrit të vet
  - E dëlirë

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Ungjillizim

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## QËLLIMI I KISHËS

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Udhëheqësit biblikë të kishës duhet ta udhëheqin kishën që ajo të funksionojë sipas projektimit të Krishtit. Kjo kërkon shumë më tepër sesa thjesht një përkushtim për të kuptuar dhe për t'iu bindur urdhërimeve të detajuara të Dhiatës së Re. Fillon me të kuptuarit e synimit të Tij për kishën. Përse e ka themeluar Perëndia kishën? Përse i ka lënë të shpenguarit e Tij në tokë?

Udhëheqësit e kishës që nuk janë të qartë për këtë, apo që e humbasin nga fokusi i tyre qëllimin e kishës, mund të kenë qëllime të mira, por ka të ngjarë që në fund ta udhëheqin kishën në udhë që i lënë pas dore përparësitë e Krishtit.

### QËLLIMI I LARTË I KISHËS: ADHURIMI

Perëndia krijoi gjithçka për lavdinë e Tij. Sikurse thotë edhe një fjalë e njohur, "Arritja kryesore e njeriut është që të lavdërojë Perëndinë dhe të kënaqet me Të përjetë."[20] Çdo njeri ekziston për lavdinë e Perëndisë. Kisha ekziston për lavdinë e Perëndisë. Për këtë arsye, qëllimi parësor i kishës është lartësimi apo adhurimi i Perëndisë.

> **Robert Sousi**
> Adhurimi është pjesa qëndrore në ekzistencën e kishës. Fjalët e apostullit Pal, që Perëndia i ka zgjedhur bijtë e Tij të paracaktuar për t'i birësuar përmes Krishtit, "për përlëvdim të hirit të Tij të lavdishëm" (Ef. 1:4-6), tregojnë se qëllimi përfundimtar i kishës është adhurimi i Atij që e thirri atë në jetë.[21]

Sot, zakonisht të krishterët e barazojnë adhurimin me të kënduarit. Sigurisht që të kënduarit është një pjesë kyçe e adhurimit biblik, por ai nuk mund të përmbledhë kurrsesi gjithçka që përfshihet në idenë biblike të adhurimit. Xherri Brixhis e përkufizon adhurimin si "veprën e veçantë të përkushtimit ndaj Perëndisë të lavdisë, madhështisë, nderit e dinjitetit të cilat i përkasin Atij."[22] Gjithë adhurimi i vërtetë rrjedh nga të menduarit e drejtë për Perëndinë dhe ungjillin, çka e mbush zemrën tonë me dashuri dhe lavdërim për Të.

> **Sinkleir Ferguson**
> Themeli i adhurimit në zemër nuk është diçka emocionale ("Ndihem plot adhurim", apo "Atmosfera është tepër adhuruese"). Në fakt, themeli është teologjik. Adhurimi nuk është diçka që "e zhvillojmë ne", por diçka që "na vjen prej së larti", prej karakterit të Perëndisë.[23]

> **Autor i panjohur**
> Adhurimi sipëror lidhet drejtpërdrejt me thellësinë e të kuptuarit të së vërtetës hyjnore. Ata që e kuptojnë më në thellësi ungjillin e adhurojnë Perëndinë me hare dhe ngazëllim më të madh.[24]

[20] Westminster Assembly, *The Westminster Confession of Faith: Edinburgh Edition* (William S. Young, 1851), 387.
[21] Saucy, *The Church in God's Program*, 166.
[22] Bridges, *The Practice of Godliness*, 49–50.
[23] Sinclair Ferguson, *A Heart for God* (Carlisle, PA: Banner of Truth, 1987), 110.
[24] Author unknown, "The Power of Expository Preaching," *The Master's Mantle*, v. 13:2 (Fall/Winter 2006).

- Lexoni Romakëve 11:33-12:1.
  - Si nxitet adhurimi personal dhe ai kolektiv nga mendimi i duhur dhe i thellë për Perëndinë?

  - Si duhet ta ushqejë kisha adhurimin? Ku ndryshon kjo nga përqasja që kanë shumë kisha sot?

E gjithë jeta jonë individuale duhet të jetë një pasqyrim i adhurimit (Romakëve 12:1-2). Ndërsa si komunitet, kur kisha mblidhet në Ditën e Zotit (Veprat e Apostujve 20:7, Zbulesa 1:10), adhurimi duhet të shprehet në një larmi mënyrash, në përputhje me atë që jepet në Dhiatën e Re. Megjithëse Shkrimi nuk na tregon çdo detaj të një adhurimi të tillë, duke lënë që bashkësitë të duken shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, përsëri adhurimi i kishave besnike përqëndrohet si duhet rreth gjërave që urdhëron Perëndia.

- Në vargjet e mëposhtme, çfarë ka urdhëruar Krishti për kishat, kur ato mblidhen së bashku?
  - Kolosianëve 3:16

  - 1 Timoteut 2:1-2, 8

  - 1 Timoteut 4:13

  - 2 Timoteut 4:1-5

Kisha e mbledhur së bashku do ta adhurojë Perëndinë përmes leximit dhe predikimt të Shkrimit, këndimit të këngëve biblike, lutjes, praktikës së rregullt të pagëzimit dhe të Darkës së Zotit.

- Lexoni Veprat e Apostujve 2:42-47 dhe Veprat e Apostujve 20:7. Çfarë modelesh të adhurimit komunitar janë modeluar në kishën e hershme?

Në gjithë adhurimin e kishës, Perëndia është kundruesi kryesor. Ata që kanë dalë përpara kishës nuk po performojnë për njerëzit e tjerë që gjenden në sallë. Përkundrazi, çdo person në bashkësi duhet të jetë pjesëmarrës aktiv në adhurim, duke lartësuar dhe lavdëruar Perëndinë bashkërisht.

## QËLLIMI I BRENDSHËM I KISHËS: NDËRTIMI

Kisha ka jo vetëm një qëllim *të lartë*, të përqendruar te adhurimi dhe lartësimi i Perëndisë, por edhe një qëllim *të brendshëm*, për ndërtimin e trupit. Plani i Krishtit për kishën përfshin dhënien e udhëheqjes me dhunti... "që të përgatisë të shenjtët për të kryer veprën e shërbimit ndaj të tjerëve, për rritjen në besim të trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë në njëshmërinë e besimit dhe në njohjen e Birit të Perëndisë. Kështu do të bëhemi njerëz të përsosur, sipas masës së përsosmërisë së Krishtit," (Efesianëve 4:12-13). Pastorët dhe pleqtë e kishës janë thirrur për të pajisur shenjtorët në mënyrë që çdo anëtar t'i përdorë dhuntitë e tij për të ndërtuar trupin drejt ngjashmërisë së pjekur të Krishtit.

- Si pajisen shenjtorët për shërbesë në kishën lokale?

Shërbimi në kishën lokale mund të vijë nëpërmjet mundësive zyrtare të shërbesës, apo përmes ndërveprimit joformal me njëri-tjetrin. Ajo mund të jetë shërbesë duke u folur të tjerëve apo duke u shërbyer atyre (1 Pjetrit 4:10-11). Sidoqoftë, të gjithë anëtarët duhet t'i ushtrojnë dhuntitë e tyre për të mirën e përbashkët (1 Korintasve 12:4-27).

- Çfarë ndodh nëse shumë nga anëtarët e kishës nuk tregohen besnikë në përdorimin e dhuntive të tyre për të ndërtuar trupin?

Përveç përdorimit të dhuntive të tyre shpirtërore, të gjithë pjestarët e trupit duhet të plotësojnë "njëri-tjetrin", çka i jep formë mënyrës se si trupi i Krishtit ndërvepron me njëri-tjetrin.

- Çfarë udhëzimesh gjenden në vargjet e mëposhtme, në lidhje me marrëdhëniet me njëri- tjetrin brenda trupit?
  - Gjoni 13:34-35
  - Romakëve 12:10
  - Romakëve 12:16
  - Romakëve 14:13
  - Romakëve 15:7
  - Romakëve 15:14
  - Galatasve 5:13
  - Efesianëve 4:2

- Efesianëve 4:32
- Efesianëve 5:19
- Filipianëve 2:3
- Kolosianëve 3:16
- 1 Selanikasve 5:11
- Hebrenjve 10:24-25
- 1 Pjetrit 4:9
- 1 Pjetrit 5:5
- 1 Pjetrit 5:14

Kur kisha funksionon ashtu si duhet, Perëndia lartësohet dhe trupi i Krishtit ndërtohet ndërkohë që çdo anëtar pajiset dhe i shërben me besnikëri njëri-tjetrit.

## QËLLIMI I JASHTËM I KISHËS: UNGJILLIZIMI

Përveç qëllimit të lartë të adhurimit dhe atij të brendshëm të ndërtimit, Perëndia i ka dhënë kishës edhe një qëllim të jashtëm ndaj botës. Kisha duhet të... "të shpallë veprat e Tij madhështore... i cili ju thirri nga errësira në dritën e Tij të mrekullueshme" (1 Pjetrit 2:9). Kisha do të adhurojë më me besinkëri në qiell. Atëherë, nusja e Krishti do të jetë pa njolla e pa faj, pa patur më nevojë për t'u pjekur e për t'u pajisur. Nuk do të ekzistojë më mundësia unike për të ungjillizuar. Porosia përfundimtare e Krishtit ndaj ndjekësve të Tij e jep të përmbledhur këtë mision për kishën.

> **Mateu 28:18-20**
> Jezui iu afrua e u tha: "Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë, prandaj shkoni e mësojini të gjitha kombet dhe pagëzojini në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit të Shenjtë. Mësojini të zbatojnë gjithë sa ju kam urdhëruar. Dhe ja, Unë jam me ju të gjitha ditët, deri në mbarim të botës".

> **Veprat e Apostujve 1:8**
> ...por kur të zbresë mbi ju Shpirti i Shenjtë, do të merrni fuqi e do të jeni dëshmitarët e mi në Jerusalem, në mbarë Judenë, në Samari e deri në skajet e dheut.

Kisha është ngarkuar me detyrën për të qenë ambasadorja e Krishtit në tokë. Duhet të dëshmojmë për Të dhe për të vërtetën e ungjillit me qëllim që të bëjmë dishepuj, të cilët pajisen më pas në kishat lokale duke u bërë ambasadorë të radhës.

- Cili është mesazhi i ungjillit që shpallim ne?

Fokusi parësor i kishës së mbledhur bashkërisht është adhurimi dhe ndërtimi, ndërkohë që ungjilli duhet të shpallet rregullisht në takimet e përbashkëta dhe kisha bën mirë të organizojë ngjarje dhe shërbesa ungjillizuese të qëllimshme. Duket se për të përmbushur më së pari këtë mision të jashtëm ungjillizimi, kisha duhet të shpërndahet nëpër botë. Kjo përfshin si shpalljen e së vërtetës në lidhje me Krishtin (Romakëve 1:6, 2 Korintasve 5:18-21), ashtu edhe të jetuarit si Ai (1 Selanikasve 1:5, 1 Pjetrit 3:15-16).

> **Uill Metzger**
> Është e qartë që mënyra se si jetojmë është treguesi parësor i dëshmisë sonë. Megjithatë, jeta jonë duhet të shoqërohet me të treguarit e së vërtetës së Perëndisë. Duhet t'u themi njerëzve se kush e bën jetën tonë të ndryshme. Atëherë, jeta jonë do të ndriçojë të vërtetën që u shprehim jobesimtarëve.[25]

- Përse janë thelbësore për ungjillizim si fjalët ashtu edhe jeta jonë?

Çdo kishë bashkë me anëtarët e saj ka përgjegjësinë për të shpallur Krishtin në komunitetin përreth tyre dhe të marrin pjesë në përparimin e ungjillit deri në skajet e tokës, ku ai nuk njihet ende. Disa pjesëtarë të kishës duhet të dërgohen dhe të tjerët duhet të jenë dërgues.

- Lexoni Veprat e Apostujve 13:1-3, Filipianëve 1:3-5 dhe 3 Gjonit 5-8. Si mund të jetë pjesë e misionit të Perëndisë, për ta çuar ungjillin ndër kombe nga çdo anëtar i kishës?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si mund të shpërqëndrohet një kishë nga qëllimet parësore që ka Perëndia për të?
3. Në çfarë mënyrash po merrni pjesë ju dhe kisha juaj për përhapjen e ungjillit në komunitetin tuaj lokal? Po në botë?

[25] Will Metzger, *Tell the Truth* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2012), 52.

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i perëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **J. Osvald Sendërs**
> Udhëheqësit shpirtërorë të çdo brezi do të kenë një pasion të zjarrtë për ta njohur Fjalën e Perëndisë nëpërmjet studimit të zellshëm dhe ndriçimit të Frymës së Shenjtë.[26]

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

[26] J. Oswald Sanders, *Spiritual Leadership* (Chicago, IL: Moody, 1994), 102.

## 1 MBRETËRVE

Gjysma e parë e 1 Mbretërve ndjek jetën e Solomonit. Nën udhëheqjen e tij, Izraeli ngrihet në kulmin e lavdisë dhe madhështisë së vet... Megjithatë, në vitet e tij të fundit, zelli i Solomonit për Perëndinë venitet pasi gratë pagane ia largojnë zemrën nga adhurimi në tempullin e Perëndisë. Për pasojë, me një zemër të thyer, mbreti lë pas një mbretëri të copëtuar. Gjatë shekullit që pason, libri i 1 Mbretërve ndjek dy historitë e ngjashme të dy palë mbretërve dhe dy kombeve me njerëz të pabindur (Izraeli dhe Juda)...[27]

### SKICIMI:

I. Mbretëria e Bashkuar/Solomoni (1-11)
II. Mbretëria e Ndarë/Shumë Mbretër (12-22)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Mbretëri e Bashkuar dhe e Ndarë

### KAPITUJT KYÇË:

1 Solomoni caktohet mbret
3 Solomoni zgjedh urtësinë dhe gjykon me urtësi
8 Dedikohet tempulli i Solomonit
17 Elia parashikon thatësirë dhe ngre të vdekurin
18 Elia në malin Karmel
19 Largimi i Elias për në Horeb/zgjedhja e Eliseut

- Përse "Mbretëri e bashkuar dhe e ndarë" është tema e duhur për librin e Parë të Mbretërve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Mbretërve.
- Lexoni gjithë librin e Parë të Mbretërve.

[27] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 84.

## 2 MBRETËRVE

Libri i Dytë i Mbretërve vazhdon dramën e nisur te libri i Parë i Mbretërve – historinë tragjike të dy kombeve në një rrjedhë konfliktesh drejt robërisë. Autori ndjek sistematikisht monarkët sundues të Izraelit dhe të Judës... Nëntëmbëdhjetë mbretër të këqij sundojnë njëri pas tjetrit në Izrael, duke çuar nën robërinë asiriane. Tabloja është paksa më e shndritshme në Judë, ku herë pas here dalin mbretër të perëndishëm për të ndrequr të këqijat e paraardhësve të tyre. Megjithatë, në fund mëkati del mbi drejtësinë dhe Juda merr rrugën për në Babiloni.[28]

### SKICIMI:

I. Ndarja e Mbretërisë/Rënia e Izraelit (1-17)
II. Mbretëria që Mbijeton/Rënia e Judës (18-25)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

### TEMA:

Rënia e Izraelit dhe e Judës

### KAPITUJT KYÇË:

17 Rënia e Izraelit/robëria asiriane
24-25 Rënia e Judës në Babiloni

- Përse "rënia e Izraelit dhe e Judës" është tema e duhur për librin e Dytë të Mbretërve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Mbretërve.
- Lexoni gjithë librin e 2 Mbretërve.

[28] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 92.

## 1 KRONIKAVE

Librat e 1 dhe 2 Kronikave mbulojnë të njëjtën periudhë të historisë judease që përshkruhet nga 2 Samueli deri te 2 Mbretërve, por me një perspektivë të ndryshme. Këta libra nuk janë thjesht një përsëritje e të njëjtit material, por një përshkrim hyjnor i historisë së popullit të Perëndisë. Ndërkohë që 2 Samueli dhe librat e Mbretërve japin historinë politike të Izraelit dhe Judës, librat e Kronikave japin historinë fetare të dinastisë davidiane të Judës.[29]

### SKICIMI:

I. Linja Mbretërore e Davidit (1-9)
II. Sundimi i Drejtë i Davidit (10-29)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Pikëpamja e Perëndisë ndaj Davidit

- Përse "pikëpamja e Perëndisë ndaj Davidit" është tema e duhur për librin e Parë të Kronikave?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Kronikave.
- Lexoni gjithë librin e Parë të Kronikave.

[29] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 99.

## 2 KRONIKAVE

Libri i Dytë i Kronikave shkon paralel me 1 dhe 2 Mbretërve, por anashkalon tërësisht mbretërinë veriore të Izraelit... Libri i Dytë i Kronikave përqendrohet tek ata mbretër të cilët e modeluan jetën dhe sundimin e tyre sipas shembullit të mbretit të perëndishëm David. Ai e drejton vëmendjen ndaj reformuesve plot zell, të tillë si Asa, Joshafati, Joashi, Ezekia dhe Josia... Libri fillon me tempullin e lavdishëm të Solomonit dhe përfundon me dekretin e Kirit për rindërtimin e tempullit pas më shumë se 400 vitesh.[30]

**SKICIMI:**

I. Sundimi i Solomonit (1-9)
II. Sundimi i Mbretërve të Judës (10-36)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Pikëpamja e Perëndisë ndaj mbretërve të Judës

- Përse "pikëpamja e Perëndisë ndaj mbretërve të Judës" është tema e duhur për librin e Dytë të Kronikave?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Kronikave.
- Lexoni gjithë librin e Dytë të Kronikave.

[30] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 108.

## EZRA

Ezra vazhdon narrativën e Dhiatës së Vjetër të librit të Dytë të Kronikave duke treguar se si e plotësoi Perëndia premtimin e Tij për ta kthyer popullin e Vet në Tokën e Premtuar pas 70 vitesh mërgimi. "Eksodi i dytë" i Izraelit nga Babilonia është më pak mbresëlënës se robëria egjiptiane pasi vetëm një pjesë e mbetur zgjodhi që të largohej. Ezra tregon historinë e dy rikthimeve nga Babilonia, e para e udhëhequr nga Zorobabeli për të rindërtuar tempullin (kap. 1-6) dhe e dyta në udhëheqjen e Ezrës për të rindërtuar gjendjen shpirtërore të popullit (kap. 7- 10).[31]

### SKICIMI:

I. Kthimi dhe Rindërtimi nën Zorobabelin (1-6)
II. Kthimi dhe Reformimi nën Ezrën (7-10)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Rindërtimi i Tempullit dhe i Popullit

### KAPITUJT KYÇË:

1 Dekreti i Kirit që lejon rikthimin; reagimi i shumë izraelitëve
3 Përfundojnë themelet e tempullit me ceremoni të madhe
7-9 Rikthimi në Ezrën, duke përfshirë lutjen e tij (9)

- Përse "rindërtimi i tempullit dhe i popullit" është tema e duhur për librin e Ezrës?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Ezrës.
- Lexoni gjithë librin e Ezrës.

[31] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 116.

## NEHEMIA

Nehemia, bashkëkohës me Ezrën dhe kupëmbajtës i mbretit në pallatin pers, udhëheq rikthimin e tretë dhe të fundit për në Jeruzalem pas mërgimit babilonas... Pasi iu dha leja për t'u kthyer në atdheun e vet, Nehemia i sfidon bashkëatdhetarët e tij të ngrihen e të rindërtojnë muret e rëna të Jeruzalemit. Pavarësisht kundërshtimeve nga jashtë dhe abuzimeve nga brenda, detyra përfundon në vetëm 52 ditë... Ndryshe nga kjo, detyra e rigjallërimit dhe riformimit të popullit të Perëndisë brenda atyre mureve të rindërtuar kërkon vite të tëra nga udhëheqja dhe jeta e perëndishme e Nehemias.[32]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Rindërtimi i Mureve të Jeruzalemit nën drejtimin e Nehemias | (1-7) |
| II. | Rigjallërimi i Popullit nën drejtimin e Ezrës | (8-10) |
| III. | Riforcimi i Punës nën drejtimin e Nehemias | (11-13) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Rindërtimi i Mureve

### KAPITUJT KYÇË:

3-7 Puna për përfundimin e mureve; kundërshtime; censi;

- Përse "rindërtimi i mureve" është tema e duhur për librin e Nehemias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Nehemias.
- Lexoni gjithë librin e Nehemias.

[32] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 123.

## ESTERA

Historia e jetës së Esterit hyn mes kapitujve 6 dhe 7 të Ezrës, mes rikthimit të parë të udhëhequr nga Zorobabeli dhe rikthimit të dytë të udhëhequr nga Ezra... Dora mbrojtëse dhe siguruese e Perëndisë ndaj popullit të Tij është e dukshme përgjatë gjithë librit, edhe pse emri i Tij nuk përmendet asnjëherë. Komploti i Hamanit rrezikon për vdekje jetën e judenjve, por përballet me kurajon e Esterës bukuroshe dhe me këshillën e kushëririt të saj të mençur, Mordekai, duke përfunduar me një çlirim madhështor. Festa e Purimit bëhet një përkujtim i përvitshëm i besnikërisë së Perëndisë ndaj popullit të Tij.[33]

### SKICIMI:

I. Kërcënimi ndaj judenjve (1-4)
II. Triumfi i judenjve (5-10)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Ruajtje përmes Përkujdesit e Sigurimit Hyjnor

- Përse "ruajtje përmes përkujdesit e sigurimit hyjnor" është tema e duhur për librin e Esterit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Esterës.
- Lexoni gjithë librin e Estërës.

[33] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 131.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e 1 Mbretërve?
    - Cila është tema e Esterës?
    - Çfarë gjendet te Nehemia, kapitujt 3-7?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te 2 Samuelit.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve korresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – KRISTOLOGJI

> **Hebrenjve 1:3-4**
> Biri është shkëlqimi i lavdisë së Perëndisë, shprehja e plotë e qënies së Tij dhe Ai që mban gjithçka me fuqinë e Fjalës së Tij. Pasi na pastroi nga mëkatet, Ai u ul në qiell në të djathtë të Perëndisë së madhërishëm...

**Kristologjia** është studimi i doktrinës së Krishtit.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në Kristologji janë:

- Personi i Krishtit
- Hyjnia e Krishtit
- Krishti si Njeri
- Puna e Krishtit

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Krishtit.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth Kristologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### SI DO TA MBRONIT HYJNINË E KRISHTIT?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Gjoni 1:1-3, 14
  - Gjoni 8:58
  - Gjoni 10:30
  - Filipianëve 2:6-11
  - Kolosianëve 1:15-20; 2:9
  - Hebrenjve 1:1-3

> **Luis Berkhof në *Teologjinë Sistematike***
> Ky mohim (i hyjnisë së Krishtit) është i mundshëm vetëm për ata që i shpërfillin mësimet e Shkrimit, pasi Bibla përmban prova me bollëk në lidhje me hyjninë e Krishtit. Gjejmë se Shkrimi (1) pohon qartazi hyjninë e Birit në pasazhe të tilla si: Gjo. 1:1; 20:28; Rom. 9:5; Fil. 2:6; Tit. 2:13; 1 Gjo. 5:20; (2) e emërton Atë me emra hyjnorë, Isa. 9:6; 40:3; Jer. 23:5-6; Joe. 2:32 (krahaso Vap. 2:21); 1 Tim. 3:16; (3) e vesh me atribute hyjnore, si ekzistenca e përjetshme, Isa. 9:6; Gjo. 1:1-2; Zbu. 1:8; 22;13; i kudondodhur, Mt. 18:20; 28:20; Gjo. 3:13; i gjithëdijshëm, Gjo. 2:24-25; 21:17; Zbu. 2:23; i gjithëfuqishëm, Isa. 9:6; Fil. 3:21; Zbu. 1:8; i pandryshueshëm, Heb. 1:10-12; 13:8; në përgjithësi edhe çdo atribut që i përket Atit, Kol. 2:9; (4) i referohet duke kryer vepra hyjnore, si krijimi, Gjo. 1:3, 10; Kol. 1:16; Heb. 1:2, 10; providenca, Lu. 10:22; Gjo. 3:35; 17:2; Ef. 1:22; Kol. 1:17; Heb. 1:3; falja e mëkateve, Mt. 9:2-7; Mr. 2:7-10; Kol. 3:13; ringjallje dhe gjykim, Mt. 25:31-32; Gjo. 5:19-29; Vap. 10:42; 17:31; Fil. 3:21; 2 Tim. 4:1; shkatërrimin përfundimtar dhe ripërtëritjen e gjithçkaje, Heb. 1:10-12; Fil. 3:21; Zbu. 21:5; dhe (5) i atribuon nderim hyjnor, Gjo. 5:22-23; 14:1; 1 Kor. 15:19; 2 Kor. 13:13; Heb. 1:6; Mt. 28:19.[34]

- Përgjigjuni me fjalët tuaja pyetjes: "Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?".

[34] Louis Berkhof, *Systematic Theology* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1938), 94–95.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Krishtit si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme:
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
    - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?
    - Si do ta përkufizonit Trininë?

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Filipianëve 3:17**
> Vëllezër, më shërbeni mua dhe shikoni ata që ecin sipas shembullit tim.

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Një nga cilësitë biblike për pleqtë dhe dhjakët është besnikëria në martesë (1 Timoteut 3:2, 12 dhe Titit 1:6). Edhe pse kjo cilësi nuk thuhet drejpërdrejt përsa u përket grave në udhëheqjen e shërbesave, është e qartë që cilësitë e një bashkëshorteje të perëndishme janë të rëndësishme për gratë e martuara që shërbejnë si udhëheqëse dhe si shembull në kishë, pasi këto cilësi duhet të shërbejnë si qëllim për çdo bashkëshorte në rritjen drejt pjekurisë shpirtërore.

- **E dashuron burrin e saj**
- **E respekton dhe i nënshtrohet bashkëshortit të vet**
- **E dëlirë**

  **Titit 2:4-5** ...duke i këshilluar me urti që t'i duan burrat e tyre... të jenë të dëlira... të nënshtruara ndaj burrave të tyre...

  **Efesianëve 5:33** ...po ashtu edhe gruaja të nderojë burrin e saj

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këto cilësi.

  - Përse është e rëndësishme që gratë që udhëheqin shërbesa të jenë besnike në martesë dhe t'i japin përparësi asaj?

  - Lexoni nga Efesianëve 5:22-33 dhe Pjetrit 3:1-7. Cilat duhet të jenë disa nga karakteristikat e çdo martese të krishterë?

- Si po e plotësoni, apo përpiqeni ta plotësoni, rolin tuaj biblik ndaj bashkëshortit? Si mund të rriteni drejt besnikërisë në martesën tuaj?

- Lexoni Mateu 5:27-30 dhe Efesianëve 5:3-5. Cili është standarti i Perëndisë për pastërtinë seksuale? Si duhet që çdo i krishterë të rendë pas pastërtisë seksuale në mendje dhe në trup?

- Ku qëndron nevoja juaj për t'u forcuar në betejën për pastërti seksuale? Nëse jeni e martuar, si nevojitet të rriteni në dashurinë ndaj bashkëshortit tuaj dhe ta mbroni pastërtinë seksuale duke investuar në intimitetin e martesës?

- Si ju ndihmon nënshtrimi ndaj bashkëshortit tuaj për të ruajtur ekuilibrin mes jetës familjare dhe asaj të shërbesës

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si po sulmohet pastërtia seksuale dhe martesa nga kultura e sotme? Përse duhet që të krishterët të luftojnë për të ruajtur standartin e Perëndisë? Nëse jeni e martuar, si ndikon marrëdhënia që keni me bashkëshortin në rolin tuaj si udhëheqëse në kishë?
3. Cilat janë disa nga sfidat unike me të cilat përballen gratë që i kanë burrat jobesimtarë apo të pabindur ndaj Fjalës? Si trajtohen këto sfida në mënyrë biblike?
4. Diskutoni mbi sfida apo vështirësi të tjera që mund të dalin në martesë gjatë shërbimit në udhëheqjen e kishës (p.sh. çfarë të diskutoni me bashkëshortin, ekuilibri mes kërkesave të shërbesës dhe atyre familjare, etj.)
5. Përse është e rëndësishme që gratë e pamartuara t'i kuptojnë dhe të jenë në gjendje të ndërveprojnë mbi cilësitë e një gruaje dhe nëne të perëndishme? Si mund t'i shfaqin ato disa nga këto tipare, ndërsa janë ende të pamartuara?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## UNGJILLIZIM

> **Gjoni 17:18**
> Sikurse Ti më dërgove Mua në botë, ashtu edhe Unë i dërgova ata në botë.

> **Çarls Spërxhën**
> Nëse mëkatarët do të dënohen, të paktën le të kapërcejnë në ferr mbi trupat tanë. Dhe nëse do të humbasin, le të humbasin me duart tona mbi gjunjët e tyre, duke iu përgjëruar që të qëndrojnë. Nëse ferri duhet të mbushet plot, të paktën le të mbushet me dhëmbët e shtrënguara prej nesh dhe askush të mos shkojë atje pa marrë paralajmërimet dhe lutjet tona.[35]

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të ndarjes së ungjillit me të tjerët.

- Përse ungjillizimi është një aspekt i rëndësishëm në jetën e çdo besimtari?

- Si mund të rriteni për të qenë më të qëllimshëm dhe më të frytshëm në ungjillizim?

[35] Charles Haddon Spurgeon, "The Wailing of Risca," *Metropolitan Tabernacle Pulpit Volume 7*, Accessed May 31, 2024. https://www.spurgeon.org/resource-library/sermons/the-wailing-of-risca/#flipbook/.

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Diskutoni mbi mundësitë e fundit që keni pasur në ndarjen e ungjillit me jobesimtarë.
3. Diskutoni se si po ndërtoni marrëdhënie të qëllimshme me jobesimtarë me qëllim ungjillizimin.
4. Si mund të përqendroheni vazhdimisht te ungjilli në ndërveprimet që keni me brezin e ri, duke përfshirë edhe fëmijët tuaj, nipër e mbesa, si edhe të tjerë në sferën tuaj të ndikimit (nipër, mbesa, fqinjë, etj)?

# Kapitulli 4

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **UDHËHEQJA 101**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Jobi:** Vuajtje dhe Sovranitet
  - **Psalmet:** Strukturë e Adhurimit Personal
  - **Fjalët e Urta:** Urtësi për Detajet e Jetës
  - **Kuvendari:** Kotësia e Jetës në një Botë të Rënë
  - **Kënga e këngëve:** Gëzimi i Dashurisë Martesore

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Pneumatologji:** Studimi i Doktrinës së Frymës së Shenjtë
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - I do fëmijët e saj dhe kujdeset për ta
  - Kujdeset mirë për shtëpinë e vet

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Lutje

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## UDHËHEQJA 101

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Për të qenë udhëheqës biblik i kishës duhet të keni një botëkuptim të duhur për kishën. Po të njëjtën rëndësi ka edhe kuptimi i duhur i udhëheqjes.

- Çfarë mendoni se u vjen në mendje shumicës së njerëzve, kur ata mendojnë për udhëheqësin?

### ÇFARË ËSHTË UDHËHEQJA?

Shpesh, udhëheqja barazohet me një pozitë. Presidenti i një kompanie apo i një vendi është udhëheqës. Drejtori i një shkolle është udhëheqës. Shefi ekzekutiv apo administratori i një kompanie është udhëheqës. Edhe pse është e vërtetë që udhëheqja njihet shpesh si një rol apo titull zyrtar, ky lloj përcaktimi nuk përbën udhëheqjen. Udhëheqja nuk është një pozitë; ajo ka të bëjë me të pasurit ndikim.

> **Xherri Rag**
> Udhëheqja... është aftësia e dhënë nga Perëndia për të ndikuar te të tjerët nëpërmjet jetës së perëndishme dhe urtësisë së fituar në praktikën e së vërtetës.[36]

> **Xhon MekArthër**
> Për ta thënë thjesht, udhëheqja është ndikim. Udhëheqësi ideal është ai person, jeta dhe karakteri i të cilit i motivojnë njerëzit për ta ndjekur. Lloji më i mirë i udhëheqjes e merr autoritetin e vet fillimisht nga forca e një shembulli të drejtë dhe jo thjesht nga fuqia e prestigjit, personalitetit apo pozitës. Në të kundërt me këtë, shumica e "udhëheqjes" botërore nuk është gjë tjetër veçse një manipulim i njerëzve me anë të kërcënimeve dhe shpërblimeve. Kjo nuk është udhëheqje e vërtetë; është shfrytëzim. Udhëheqja e vërtetë kërkon t'i motivojë njerëzit së brendshmi, duke i bërë apel zemrës, jo nga presioni apo detyrimi i jashtëm.[37]

- Cilët janë disa nga personat që kanë pasur ndikimin më të rëndësishëm në jetën tuaj?

[36] Jerry Wragg, *Exemplary Spiritual Leadership* (UK: Day One, 2010), 144.
[37] MacArthur, *Called to Lead*, vi.

- Përse patën një ndikim kaq të fuqishëm?

Udhëheqësit botërorë e ushtrojnë ndikimin në mënyra të ndryshme. Ai ndikim mund të bazohet mbi personalitetin, karizmën, pamjen e jashtme, aftësitë financiare apo mbi famën dhe emrin e familjes. Ai mund të realizohet me anë të manipulimit, marketingut, premtimeve për shpërblime apo edhe kërcënimeve. Udhëheqja biblike ka një themel tërësisht të ndryshëm. Çfarë e bën një udhëheqës biblik? Si ndikon te të tjerët një udhëheqës kishe i perëndishëm e besnik?

## KARAKTERI I NJË UDHËHEQËSI BIBLIK

Kur Perëndia jep cilësitë për pleqtë e kishës (1 Timoteut 3 dhe Titit 1), shumica e tyre përqendrohen te karakteri. Kur Pali i shkruan Timoteut dhe Titit në lidhje me caktimin e pleqve, ai nuk i udhëzon ata që të caktojnë njerëzit më të suksesshëm, apo më të moshuarit, apo ata që pëlqehen më shumë nga të tjerët. Ai u bën thirrje atyre të caktojnë burra që janë "të paqortueshëm".

Kur vjen puna për zgjedhjen e udhëheqësve, karakteri është gjithnjë interesi parësor i Perëndisë. Kur apostujt po zgjidhnin burra për të udhëhequr në shërbim të të vejave, ata e udhëzuan bashkësinë të zgjidhnin "burra me emër të mirë, të mbushur me Shpirt e urti" (Veprat e Apostujve 6:3).

Karakteri është thelbësor për udhëheqësit biblikë sepse shembulli i tyre është një faktor parësor në ndikimin e udhëheqësve. Kur Pali i shkroi Timoteut për ta nxitur "vazhdo të qëndrosh në ato që mësove e për të cilat u binde plotësisht", një arsye bindëse për këtë ishte sepse "ti e di prej kujt i mësove" (2 Timoteut 3:14). Udhëzimi nga Fjala e Perëndisë është themelor për ndikimin biblik (2 Timoteut 3:15-17), por shembulli i Palit, Loidës, Eunikës dhe të tjerëve e përforcoi këtë të vërtetë që i kishin mësuar Timoteut.

> **Ç. H. Spërxhën**
> Jeta e një burri është më bindëse se fjalët e tij. Kur të tjerët analizojnë dikë, ata i vlerësojnë veprat e tij si dollarë dhe fjalët e tij si qindarka. Nëse jeta dhe mësimdhënia e tij nuk përputhen, turma vëzhguese pranon veprimet e tij, por hedh poshtë predikimet.[38]

Karakteri i një udhëheqësi nuk duhet të jetë thjesht i jashtëm. Nuk ka lidhje me të qenit personazh publik. Ajo ka të bëjë me realitetin që rrjedh nga zemra. Merrni parasysh përzgjedhjen që Perëndia bëri me Davidin.

> **1 Samuelit 13:14**
> "...por tani mbretëria jote nuk do të qëndrojë më. Zoti ka kërkuar një njeri tjetër sipas zemrës së Vet dhe e ka urdhëruar t'i prijë popullit të Tij, sepse ti nuk e zbatove urdhrin e Zotit".

> **1 Samuelit 16:7**
> Por Zoti i tha: "Mos i shih pamjen e shtatin, se nuk e kam pranuar. Perëndia nuk gjykon siç gjykon njeriu. Njeriu sheh pamjen, ndërsa Zoti sheh zemrën".

[38] Charles Haddon Spurgeon, *The Sword and the Trowel; A Record of Combat with Sin and of Labour for the Lord* (London: Passmore & Alabaster, Steam Printers, Paternoster Buildings, 1874), https://www.spurgeon.org/wp-content/uploads/2021/03/ST-1874-Edited.pdf.

- Mbi çfarë bazash e refuzoi Perëndia Saulin, duke zgjedhur Davidin?

- Çfarë do të thotë të jesh burrë sipas zemrës së Zotit?

Megjithëse nuk ishte i përsosur, Davidi shfaqi cilësi kyçe karakteri, të cilat janë të thelbësore për udhëheqësit biblikë. Perëndia e përmbledh mënyrën e udhëheqjes së Davidit, te Psalmi 78.

> **Psalmi 78:71-72**
> E mori prej deleve që mëndnin, për të kullotur Jakobin, popullin e Tij, dhe Izraelin, trashëgiminë e Tij. Me zemër të pastër i udhëhoqi, me duar të afta u priu.

Karakteri i Davidit u shfaq përpara caktimit të tij formal si udhëheqës. Ai kishte treguar besnikëri dhe përgjegjësi nën kujdesin e deleve dhe qengjave të porsalindur përpara se Zoti t'i jepte përgjegjësi për të barituar popullin e Tij. Porsi Davidi, udhëheqësit biblikë janë besnikë dhe të përgjegjshëm, edhe në detyrat më të vogla të cilat nuk i vë re thuajse askush.

> **1 Timoteut 3:11**
> Edhe bashkëshortet e tyre të kenë dinjitet, jo shpifarake, por të përmbajtura dhe besnike në gjithçka..

- Si mund të rriteni për t'u bërë më besnikë në gjëra të vogla?

Si mbret, Davidi e baritoi popullin e Perëndisë. Ai nuk ushtroi sundim mbi ta. Ai nuk dominoi mbi ta. Përkundrazi, ai u kujdes për ta. Ashtu si Davidi, edhe udhëheqësit biblikë nuk janë egoistë, por vendosin nevojat e të tjerëve përpara nevojave të tyre.

- Përse është e rëndësishme që udhëheqësit biblikë ta përdorin ndikimin e tyre për të mirën e të tjerëve dhe jo për përfitimin e tyre personal?

Davidi e baritoi popullin sipas integritetit të zemrës së vet. Davidi ishte një burrë sipas zemrës së Perëndisë. Dashuria që kishte ai për Perëndinë u shfaq në dashurinë e tij për Fjalën e Perëndisë dhe në zellin që kishte për ta zbatuar atë Fjalë dhe për të qenë një burrë i besës. Ashtu si Davidi, edhe udhëheqësit biblikë janë të besueshëm, jetojnë me integritet si në fjalë, ashtu edhe në sjellje dhe në veprimtarinë e tyre.

- Si duhet të shfaqet integriteti dhe besueshmëria në jetën e një udhëheqësi?

## AFTËSIA E UDHËHEQËSIT BIBLIK

Davidi dhe çdo udhëheqës tjetër biblik do të kenë së pari dhe mbi të gjitha një karakter të çiltër të perëndishëm që buron nga zemra. Megjithatë, edhe pse është thelbësor për ndikim, karakteri nuk është gjithçka që nevojitet për një udhëheqës biblik, pasi Davidi "i priu ata me duar të afta".

Udhëheqësit ndikojnë te të tjerët me anë të karakterit të tyre, por ata duhet t'i prijnë të tjerët me aftësi dhe urtësi. Burrat e zgjedhur për të shërbyer ndaj të vejave, te Veprat 6, nuk ishin vetëm burra me karakter, por ishin edhe plot "urtësi". Kjo nuk është mençuria e botës. Ajo nuk është aftësi në oratori apo në marketing. Përkundrazi, është urtësi biblike. Ajo ka të bëjë me aftësinë për të zbatuar të vërtetën biblike në aspekte të ndryshme të jetës, duke përfshirë edhe marrdhëniet me të tjerët.

Ndërkohë që të gjithë udhëheqësit duhet të rriten në urtësi, urtësia dhe aftësia për udhëheqje biblike duhet të shfaqen përpara se dikush të zgjidhet zyrtarisht si udhëheqës në kishë. Kjo është njëra nga arsyet se përse duhet të zgjidhen pleq ata që "e drejtojnë mirë shtëpinë e vet" (1 Timoteut 3:4).

- Çfarë "aftësish për të udhëhequr" lavdërohen zakonisht në shoqërinë e jobesimtarëve? Ku duhet të ngjasojnë apo të ndryshojnë ato te dikush që zotëron urtësi biblike?

## GUXIMI I UDHËHEQËSIT BIBLIK

Fakti që udhëheqësit prijnë nënkupton se ata mund të mbeten vetëm nëse askush nuk i ndjek. Udhëheqësit mund të tundohen të drejtojnë bazuar mbi gjërat që dëshirojnë të tjerët dhe jo mbi ato që janë të drejta. Edhe pse udhëheqësit biblikë duhet të tregohen të duruar për të tërhequr të tjerët nën ndikimin e tyre, përsëri ata duhet të kenë guximin për të ruajtur kursin apo për të ecur të vetëm. Kur Perëndia i dha Jozuehut orientime për të udhëhequr popullin e Tij drejt tokës së premtuar, përpara se të vepronte Ai i theksoi atij edhe nevojën që kishte për të pasur guxim.

> **Jozuehu 1:6**
> "Ji i fortë e ki guxim, sepse ti do t'ia japësh për trashëgim këtij populli këtë tokë, për të cilën iu betova etërve të tyre se do t'ua jap".

Një guxim i tillë vjen nëse e njeh, i beson dhe i bindesh Fjalës së Perëndisë.

> **Jozuehu 1:7-8**
> "Ti veç ji i fortë e ki shumë guxim, që të mbash ligjin që të urdhëroi Moisiu, shërbëtori im, e të bësh gjithçka sipas tij. Mos iu shmang as djathtas e as majtas, që të kesh mbarësi kudo që të shkosh. Mos e hiq nga goja librin e këtij ligji. Përsiate ditë e natë, që ta mbash e të bësh gjithçka është shkruar në të. Vetëm atëherë do të kesh mbarësi e begati".

- Si lidhej guximi i Jozuehut me përkushtimin e tij ndaj Fjalës së Perëndisë?

Udhëheqësit biblikë tregojnë guxim që vjen nga bindjet biblike.

> **Albert Moler**
> Kur një udhëheqës hyn në dhomë, është më mirë që bashkë me të të hyjë edhe pasioni për të vërtetën. Udhëheqja autentike nuk lind nga asgjëja. Udhëheqja që vlen më shumë është bindëse – thellësisht bindëse. Kjo cilësi e udhëheqjes buron nga ato besime themelore që i japin formë personit tonë dhe themelojnë besimet tona ndaj gjithçkaje tjetër. Bindjet nuk janë thjesht besime; janë ato besime që na mbajnë të mbërthyer tërësisht. Pa këto besime themeltare nuk mund ta dimë as se kush jemi dhe as si të udhëheqim.[39]

Udhëheqësit duhet të zotërojnë dhe të veprojnë mbi bindje të patundura ndaj Shkrimit, por njëkohësisht duhet të kenë kujdes që të mos mbitheksojnë bindjet e tyre personale në zbatime të veçanta të parimeve biblike.

[39] Albert Mohler, *The Conviction to Lead* (Minneapolis, MN: Bethany House, 2012), 21.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Përse karakteri është një element i nevojshëm në udhëheqje? Cilat janë pasojat që mund të rrjedhin nëse udhëheqësit e kishës nuk kanë karakter të perëndishëm?
3. Cilat janë disa gra në Bibël, të cilat shfaqin cilësitë e përshkruara në këtë kapitull? Çfarë mësojmë nga shembulli i tyre?
4. Kur vjen puna për aftësi në udhëheqje, cilat janë pikat tuaja të forta dhe të dobëta? Si po punoni për t'u zhvilluar më tej si udhëheqës?
5. Cilat janë disa bindje biblike të domosdoshme për një udhëheqës? Kur mund të tundohen më shumë udhëheqësit për të kompromentuar bindjet e tyre?
6. Përse është e rëndësishme të dallosh ndryshimin mes bindjeve personale (p.sh. kur zgjidhni arsimin publik, privat, apo shtëpiak) dhe atyre biblike (p.sh. të edukosh fëmijët me disiplinën e udhëzimet e Zotit)? Cilat janë disa nga bindjet tuaja personale që tundoheni t'i theksoni së tepërmi në udhëheqjen tuaj?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i përëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Fjalët e Urta 1:7**
> Droja e Zotit është fillimi i njohjes, por të marrët e përçmojnë dijen e rregullin.

## SHQYRTIM BIBLIK

**PËRGATITJE INDIVIDUALE:**

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyç të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## JOBI

Libri i Jobit tregon historinë e një burri që humbet gjithçka – pasurinë, familjen, shëndetin e vet – dhe ndeshet me pyetjen "Përse?". Libri nis me një debat qiellor mes Perëndisë dhe Satanit, kalon nëpër tri cikle debatesh tokësore mes Jobit e miqve të tij dhe përfundon me një "diagnozë hyjnore" dramatike të problemeve të Jobit. Në përfundim, Jobi njeh sovranitetin e Perëndisë në jetën e tij dhe merr më shumë nga sa kishte pasur përpara sprovave të tij.[40]

### SKICIMI:

I. Fatkeqësitë e Jobit (1-2)
II. Dialogimet e Jobit (3-37)
III. Shpëtimi i Jobit (38-42)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Vuajtje dhe Sovranitet

### KAPITUJT KYÇË:

1-2 Akuzat e Satanit dhe vuajtjet e Jobit
38-41 Perëndia flet dhe Jobi hesht
42 Pendimi dhe restaurimi i Jobit

- Përse "vuajtje dhe sovranitet" është tema e duhur për librin e Jobit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Jobit.
- Lexoni gjithë librin e Jobit.

[40] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 144.

## PSALMET

Kjo përmbledhje e himneve të lashta përfaqëson një gamë të gjerë të përvojave të jetës... Kudo që ta gjejë veten dikush, në udhëtimin e besimit, Psalmet sigurojnë një vend për t'u çlodhur dhe një kohë për qetësi dhe reflektim, sikurse edhe një nxitje për ta çuar atë më përpara.[41]

### SKICIMI:

| LIBRI | PSALMET | AUTORËT |
|---|---|---|
| 1 | 1-41 | Davidi |
| 2 | 42-72 | Davidi dhe bijtë e Korahut |
| 3 | 73-89 | Kryesisht Asafi |
| 4 | 90-106 | Kryesisht të panjohur |
| 5 | 107-150 | Davidi dhe të panjohur |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Strukturë e Adhurimit Personal

### KAPITUJT KYÇË:

2 Mbretërimi i Mesias
19 Veprat dhe Fjala e Perëndisë
22 Vuajtjet e Mesias
23 Bariu i Madh
32 Bekimi i faljes
51 Rrëfimi i mëkatit
73 Përparimi i dukshëm i të ligut
90 Njeriu si kalimtar në këtë botë
119 Lartësimi i Fjalës së Perëndisë
139 Perëndia dhe Fryma e Shenjtë janë të gjithdijshëm dhe të kudondodhur

- Përse "strukturë e adhurimit personal" është tema e duhur për librin e Psalmeve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Psalmeve.
- Lexoni gjithë librin e Psalmeve.

[41] C. Hassell Bullock, *An Introduction to the Old Testament Poetic Books* (Chicago, IL: Moody, 1988), 111.

## FJALËT E URTA

Fjalët e urta është ndoshta libri më praktik në Dhiatën e Vjetër pasi jep mësime mbi urtësinë ("të jetuarit me aftësi") në aspekte të shumta të jetës së përditshme. Me thënie të shkurtra e të mençura, përmbledhje, maksima dhe histori, Solomoni dhe kontribues të tjerë parashtrojnë rreth 900 proverba – norma të frymëzuara që kanë të bëjnë me urtësinë dhe marrëzinë, krenarinë dhe përulësinë, drejtësinë dhe hakmarrjen, përtacinë dhe punën, varfërinë dhe pasurinë, miqësinë dhe fqinjësinë, dashurinë dhe epshin, inatin dhe grindjet, zotërinjtë dhe shërbëtorët, jetën dhe vdekjen. Këto përmbledhje nuk janë teorike, por praktike; ato mësohen lehtësisht përmendësh, të vërteta të pavdekshme që prekin çdo aspekt të marrëdhënieve njerëzore.[42]

### SKICIMI:

I. Fjalët e Urta të Solomonit (1-29)
II. Fjalët e Urta të Agurit (30)
III. Fjalët e Urta të Lamuelit (31)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

### TEMA: Urtësi për Detajet e Jetës

### KAPITUJT KYÇË:

3 Kërkimi i urtësisë dhe normat e saj
31 Gruaja e perëndishme

- Përse "urtësi për detajet e jetës" është tema e duhur për librin e Fjalëve të Urta?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Fjalëve të Urta.
- Lexoni gjithë librin e Fjalëve të Urta.

[42] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 161.

## KUVENDARI

Kuvendari është një libër i fortë, i cili regjistron një kërkim të thelluar të Predikuesit (tradicionalisht mendohet që të jetë Solomoni) për kuptimin dhe kënaqësitë e jetës – pavarësisht pabarazive, kundërshtive dhe absurditeteve të jetës në tokë. Fjala kyçe e Kuvendarit është "kotësi", zbrazëtia e pavlerë e përpjekjeve për t'i dhënë kuptim jetës pa Perëndinë. E parë "nën diell" (8:17), kërkimet e jetës të çojnë vetëm në shqetësime. Pushteti, prestigji, kënaqësitë – asgjë nuk mund ta mbushë boshllëkun në jetën e njeriut – përveçse vetë Perëndisë.[43]

### SKICIMI:

I. Problemi që "Gjithçka është Kotësi" (1:1-11)
II. Vërtetimi që "Gjithçka është Kotësi" (1:12-6)
III. Porosi për të Jetuarit me Kotësinë (7-12)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Kotësia e Jetës në një Botë të Rënë

- Përse "kotësia e jetës në një botë të rënë" është tema e duhur për librin e Kuvendarit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Kuvendarit.
- Lexoni gjithë librin e Kuvendarit.

[43] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 168.

## KËNGA E KËNGËVE

Në kontrast me dy ekstremet e deformuara të mos kënaqësisë seksuale dhe shthurjes epshore jashtë martesës, kënga e lashtë e dashurisë së Solomonit ngre lart pastërtinë e dashurisë dhe romancës martesore. Ajo përkrah dhe përforcon pjesë të tjera të Shkrimit të cilat portretizojnë planin e Perëndisë për martesën, duke përfshirë edhe bukurinë dhe shenjtërinë e intimitetit seksual mes dhëndrit dhe nuses.[44]

**SKICIMI:**

I. Miqësi Romantike (1-3)
II. Përmbushja (4-5)
III. Kremtimi (5-8)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Gëzimi i Dashurisë Martesore

- Përse "gëzimi i dashurisë martesore" është tema e duhur për librin Kënga e Këngëve?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Këngës së Këngëve.
- Lexoni gjithë librin Kënga e Këngëve.

[44] John MacArthur, Jr., ed., *The MacArthur Study Bible*, electronic ed. (Nashville, TN: Word, 1997), 940–41.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Jobit?
    - Përse flet Psalmi 51?
    - Çfarë gjendet te Fjalët e Urta 3?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Esteri.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – PNEUMATOLOGJI

> **2 Korintasve 13:13**
> Hiri i Zotit tonë Jezu Krisht, dashuria e Perëndisë dhe bashkësia me Shpirtin e Shenjtë qofshin me ju të gjithë.

**Pneumatologjia** është studimi i doktrinës së Frymës së Shenjtë.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në Pneumatologji janë:

- Personi i Frymës së Shenjtë
- Hyjnia e Frymës së Shenjtë
- Puna/Shërbesa e Frymës së Shenjtë
  - Në Dhiatën e Vjetër
  - Në Dhiatën e Re
  - Gjatë Jetës së Krishtit

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Frymës së Shenjtë.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth pneumatologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### SI DO TA MBRONIT HYJNINË E FRYMËS SË SHENJTË?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Psalmi 139:7
  - Veprat e Apostujve 5:3-5
  - 1 Korintasve 2:10-11
  - 2 Pjetrit 1:20-21

> **Luis Berkhof në *Teologjinë Sistematike***
> Hyjnia e Frymës së Shenjtë mund të themelohet e përforcohet nga një sërë provash shumë të ngjashme me ato që jepen në lidhje me Birin: (1) Fryma emërtohet me emra hyjnorë, Eks. 17:7 (krahaso Heb. 3:7-9); Vap 5:3; 1 Kor. 3:16; 2 Tim. 3:16 (krahaso 2 Pje. 1:21). (2) Frymës i atribuohen përsosmëri hyjnore, si i kudondodhur, Psa. 139:7-10, i gjithëdijshëm, Isa. 40:13-14, (krahaso Rom. 13:34); 1 Kor. 2:10-11, i gjithëfuqishëm, 1 Kor. 12:11; Rom. 15:19, dhe i përjetshëm, Heb 9:14. (3) prej Tij kryhen vepra hyjnore, si krijimi, Zan. 1:2; Job. 26:13; 33:4; pjesëmarrës në restaurim, Psa. 104:30, ripërtëritja, Gjo. 3:5-6; Tit. 3:5; si edhe ringjallja e të vdekurve, Rom 8:11. (4) Frymës i jepet nderim hyjnor, Mat. 28:19; Rom. 9:1; 2 Kor. 13:14.[45]

- Përgjigjuni me fjalët tuaja pyetjes: "Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?"

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Frymës së Shenjtë si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme:
   - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
   - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?
   - Si do ta përkufizonit Trininë?
   - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?

[45] Berkhof, *Systematic Theology*, 97–98.

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Xhon MekArthër**
> Për të mësuar me sukses bindjet shpirtërore të të tjerëve dhe për t'i ruajtur ato si të tuat, nevojitet që jo vetëm t'i dëgjoni të shprehura qartë prej tyre, por edhe t'i shihni vazhdimisht të vëna në jetë.[46]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Udhëheqja në kishë është e lidhur me udhëheqjen në shtëpi (1 Timoteut 3:4-5, Titit 1:6). Shqyrtoni cilësitë e mëposhtme të një bashkëshorteje dhe nëne të përndishme, duke kuptuar që ato duhet të jenë synimi për çdo grua në rritjen drejt pjekurisë shpirtërore.

- **I do fëmijët e saj dhe kujdeset për**
- **E qeveris mirë shtëpinë e vet**

  **Titit 2:4-5** ...duke i këshilluar me urti që të duan... fëmijët e tyre... të jenë... të zellshme në punët e shtëpisë.

  **Fjalët e Urta 31:27-28** Caqet e shtëpisë së vet vëzhgon e nuk ha bukën e përtacisë. Qëndrojnë lart bijtë e saj dhe e lavdërojnë...

- Përkufizojeni me fjalët tuaja këto cilësi.

- Përse është e nevojshme që gratë që shërbejnë në udhëheqje të jenë besnike në përparësitë që Zoti u ka dhënë atyre në shtëpi?

- Lexoni nga Ligji i Përtërirë 6:6-9 dhe Efesianëve 6:4. Çfarë kërkon Perëndia nga çdo prind i krishterë?

[46] John MacArthur, *2 Timothy* (Chicago, IL: Moody, 1995), 135.

- Lexoni fjalët e Urta 31:10-31. Cilat janë disa nga cilësitë e gruas që e qeveris mirë shtëpinë e vet?

- A mund ta garantojnë prindërit e krishterë shpëtimin e fëmijëve të tyre, duke treguar besnikëri? Si mund ta ekuilibrojnë këta prindër mbështetjen në sovranitetin e Perëndisë dhe marrjen e përgjegjësisë së tyre?

## DISKUTIM MENTORAL (-15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Diskutoni me njëri-tjetrin për fëmijët apo nipërit e mbesat tuaja, nëse keni.
3. Si po punoni për të përgatitur e udhëzuar fëmijët tuaj, nëse ata jetojnë ende bashkë me ju? Si po punoni për të ndikuar fëmijët dhe nipërit e mbesat tuaja, nëse ata jetojnë në shtëpi më vete?
4. Në ç'mënyrë po kujdeseni mirë për shtëpinë tuaj? Diskutoni se si dëshironi të rriteni më shumë si një punëtore në shtëpi.

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## LUTJE

> **Kolosianëve 4:2**
> Këmbëngulni e rrini zgjuar në lutje, duke falenderuar Perëndinë.

> **Martin Luter**
> Të jesh i krishterë pa u lutur është po aq e mundur sa të rrosh pa marrë frymë.[47]

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të lutjes.

- Përse lutja është një aspekt i rëndësishëm në jetën e çdo besimtari?

[47] Martin Luther, Accessed May 31, 2024. https://gracequotes.org/author-quote/martin-luther/.

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Përse lutja është e rëndësishme për rritjen tuaj shpirtërore dhe njëkohësisht edhe demonstrim i kësaj pjekurie?
3. Diskutoni se si njoftohen nevojat për lutje në kishën tuaj.
4. Si mund të ruheni ndaj thashethemeve me pretekstin e kërkesave për lutje?
5. Si mund t'i udhëhiqni gratë e tjera që t'i ndajnë si duhet kërkesat për lutje në lidhje me vështirësitë që ato hasin në jetën e përditshme?

# Kapitulli 5

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **OFIQET (ROLET) NË UDHËHEQJEN E KISHËS: PLEQTË DHE DHJAKËT**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Isaia:** Shpëtimi
  - **Jeremia:** Paralajmërimi i Fundit nga Perëndia
  - **Vajtimet:** Vajtime mbi Jeruzalemin
  - **Ezekieli:** Dënim, Ngushëllim dhe Restaurim
  - **Danieli:** Sovraniteti i Perëndisë përmbi Historinë Njerëzore

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Ekleziologji:** Studimi i Doktrinës së Kishës
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Cilat janë qëllimet e kishës?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Jo kryelartë

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Studimi i Biblës

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## OFIQET (ROLET) NË UDHËHEQJEN E KISHËS: PLEQTË DHE DHJAKËT

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Në çdo kishë lokale dhe në shërbesat e saj ka një shumëllojshmëri rolesh në udhëheqje, formale dhe joformale, që besimtarët mund të luajnë. Megjithatë, Dhiata e Re identifikon posaçërisht dy role në udhëheqjen e kishës: pleqtë (apo mbikëqyrësit) dhe dhjakët.

> **Filipianëve 1:1**
> Pali e Timoteu, shërbëtorë të Krishtit Jezu, po ju shkruajmë të gjithë të shenjtëve, në Krishtin Jezu, peshkopëve e dhjakëve...

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Mejhju në *Doktrina Biblike***
> Roli i plakut është kryesisht si një nga mbikëqyrësit shpirtërorë që udhëheqin dhe ushqejnë grigjën. Roli i dhjakut është kryesisht një nga ndihmës-shërbestarët shpirtërorë të pleqve për plotësimin e nevojave të anëtarëve të kishës.[48]

Shkrimi përdor terma të ndryshëm për të përshkruar pleqtë, mes të cilave fjalët plak, pastor apo bari dhe mbikëqyrës. Të treja këto përshkrime gjenden të lidhura ngushtë te 1 Pjetrit 5 dhe të Veprat e Apostujve 20 (fjalët me shkronja të pjerrëta janë shpjegime shtesë):

> **1 Pjetrit 5:1-2**
> U lutem pleqve tuaj, unë që jam plak bashkë me ta, si dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit e pjesëtar i lavdisë që do të shfaqet: ruajeni (baritojeni) grigjën e Perëndisë që ju është besuar dhe mbikëqyreni jo me detyrim, por vullnetarisht sipas dëshirës së Perëndisë, as për përfitim, por me dëshirë.

> **Veprat e Apostujve 20:17, 28**
> Nga Mileti, Pali u çoi fjalë pleqve të kishës në Efes që ta takonin... e u tha: "...ruajeni veten tuaj dhe tërë grigjën, mbi të cilën Shpirti i Shenjtë ju ka vënë mbikëqyrës, që të kujdeseni (baritoni) për kishën e Perëndisë, të cilën Ai e bleu me gjakun e Vet".

Secili prej këtyre termave ndihmon në plotësimin e tablosë që tregon se nga çfarë duhet të karakterizohet një burrë i tillë:

- *Plaku* është një burrë i matur e i pjekur, me karakter të paqortueshëm.
- *Pastori/bariu* është një burrë që kujdeset mirë për të tjerët, të cilët i janë besuar atij prej Krishtit, Kryebariut.
- *Mbikëqyrësi* është një burrë i cili siguron udhëheqje dhe mbikëqyjre të efektshme.

[48] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 772.

Aleksandër Stauç e përmbledh këtë rol duke shkruar: "Sipas konceptit të Dhiatës së Re mbi pleqësinë, pleqtë e udhëheqin kishën, predikojnë dhe japin mësim mbi Fjalën, e mbrojnë kishën nga mësuesit e rremë, këshillojnë, nxitin dhe qortojnë shenjtorët sipas doktrinës së shëndoshë, vizitojnë dhe luten për të sëmurët, si dhe gjykojnë çështje doktrinore. Në terminologjinë biblike, pleqtë baritojnë, mbikëqyrin, udhëheqin dhe kujdesen për kishën lokale."[49]

Fjala e përdorur në Dhiatën e Re për **dhjak** (*diakonos*) shpesh përkthehet si "shërbenjës" apo "shërbëtor". Shumica e përdorimeve të saj janë më tepër të përgjithshme sesa referime të rolit formal të dhjakut. Megjithatë, përdorimi i saj edhe për rolin e dhjakëve tregon qartë se këta persona janë ata që shërbejnë. Prandaj, dhjakët janë ata që duke shërbyer, i ndihmojnë pleqtë në udhëheqjen e kishës. Duke e ditur që çdo besimtar duhet të shërbejë, atëherë ajo që e dallon rolin e dhjakut nga çdo besimtar besnik është sigurimi i mbikëqyrjes së shërbimit përmes udhëheqjes dhe shembullit të tyre.

Ndërkohë që ka debate lidhur me origjinën e rolit të dhjakut në kishën e hershme, Veprat 6 jep të paktën një pamje të qartë se si duhet të plotësojnë njëri-tjetrin roli i plakut dhe ai i dhjakut.

> **Veprat e Apostujve 6:1-6**
> Ato ditë, ndërsa po rritej numri i dishepujve, greqishtfolësit u ankuan ndaj hebraisht folësve, se vejushat e tyre po liheshin pas dore gjatë shpërndarjes së përditshme të ushqimit. Atëherë të dymbëdhjetët thirrën të gjithë bashkësinë e dishepujve e thanë: "Nuk është e drejtë të lëmë mënjanë Fjalën e Perëndisë e të shërbejmë në tryezë. Prandaj, vëllezër, zgjidhni ndërmjet jush shtatë veta me emër të mirë, të mbushur me Shpirt e me urti, që t'i ngarkojmë me këtë detyrë. Ne, nga ana jonë, do t'i kushtohemi lutjes dhe predikimit të Fjalës". Këto fjalë i pëlqyen tërë bashkësisë dhe zgjodhën Stefanin, njeri plot besim e i mbushur me Shpirtin e Shenjtë, Filipin, Prokorin, Nikanorin, Timonin, Parmenin e Nikollën nga Antiokia, që ishte kthyer në besimin e judenjve. Këta i sollën para apostujve, të cilët u lutën e vunë duart mbi ta.

- Sipas këtij teksti, si i ndihmojnë "dhjakët" apostujt në udhëheqjen e kishës së hershme?

- Si i ilustron kjo gjë funksionet përkatëse të pleqve dhe dhjakëve?

## SHUMËSI I PLEQVE DHE DHJAKËVE

Një nga tiparet e rëndësishme të udhëzimit të Dhiatës së Re në lidhje me pleqtë dhe dhjakët është se ata pothuajse gjithmonë referohen në numrin shumës, duke nënkuptuar qartë që praktika normative e kishës është udhëheqja nga disa pleq të ndihmuar nga shumë dhjakë.

[49] Alexander Strauch, *Biblical Eldership* (Colorado Springs, CO: Lewis and Roth, 1995), 16.

> **Veprat e Apostujve 14:23**
> Në çdo kishë ata zgjodhën pleqtë drejtues dhe me agjërim e lutje ia paraqitën Zotit, në të cilin kishin besuar.

> **Filipianëve 1:1**
> Pali e Timoteu, shërbëtorë të Krishtit Jezu, po ju shkruajmë të gjithë të shenjtëve në Krishtin Jezu, peshkopëve e dhjakëve që janë në Filipi.

- Cilat janë përfitimet e udhëheqjes nga shumë persona krahasuar me udhëheqjen e një personi të vetëm?

- Cilat janë disa nga qëndrimet kyçe që nevojiten për udhëheqësit (në shumës) që ata të mund të punojnë mirë bashkërisht?

Perëndia e ka skicuar plot mençuri kishën që ajo të udhëhiqet nga një numër i madh njerëzish. Shumë udhëheqës japin një shërbesë më të madhe e me më shumë urtësi nga sa mund të bënte çdo individ i vetëm.

## CILËSITË E PLEQVE DHE DHJAKËVE

Dëshira për të pasur shumë pleq dhe dhjakë nuk duhet të minojë përkushtimin për të pasur udhëheqës të kualifikuar. Pleqtë dhe dhjakët duhet të plotësojnë cilësitë e theksuara në Shkrim pasi ata duhet të shërbejnë si shembull i pjekurisë shpirtërore. Modeli i jetës së një plaku apo dhjaku duhet të jetë i tillë saqë nëse turma e ndjek, ajo duhet të imitojë Krishtin (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11).

- Lexoni Titit 1:5-9 dhe 1 Timoteut 3:1-10.
  - Cilat janë cilësitë biblike për pleqtë?

  - Cilat janë cilësitë biblike për dhjakët?

  - Përse është kaq shumë e rëndësishme që kisha të ketë udhëheqës me cilësi biblike?

Një nga cilësitë e theksuara në Shkrim është që pleqtë duhet të jenë burra. Edhe pse burrat dhe gratë janë shpirtërisht të barabartë përpara Perëndisë, Ai u ka dhënë atyre role të ndryshme dhe plotësuese si në shtëpi ashtu edhe në kishë. Duhet të kuptohet qartë e të përqafohet mirë dallimi mes këtyre roleve, me qëllim që t'i qëndrojmë besnik Krishtit dhe Fjalës së Tij.

Ndërkohë që Shkrimi është i qartë përsa u përket pleqve si burra, sërish ka debat mes atyre që i janë përkushtuar autoritetit të Shkrimit nëse gratë mund të shërbejnë si dhjake. Kishat kanë lirinë të përcaktojnë se si do ta trajtojnë këtë çështje bazuar kryesisht te interpretimi i tyre ndaj grave të përmendura te 1 Timoteut 3:11, nëse ato ishin dhjake apo bashkëshorte dhjakësh.

Pavarësisht kësaj, nga Shkrimi del qartë që çdo grua duhet t'i përdorë dhuntitë e saj për të shërbyer në kishë nën udhëheqjen dhe drejtimin e pleqve të kishës dhe të bashkëshortit të saj, nëse është e martuar (1 Pjetrit 4:10-11, 1 Pjetrit 5:1-3, Efesianëve 5:22-24).

> **Aleksandër Strauç**
> Fryma e Shenjtë fuqizon dhe u jep dhunti gjithë besimtarëve – burrave dhe grave – për shërbesë. Gratë e krishtera të shekullit të parë luajtën një rol të domosdoshëm në punën e Zotit. Në ditët e para të lëvizjes së krishterë, ato u vlerësuan, u përfshinë dhe ishin mjaft aktive (Veprat e Apostujve 1:14). Megjithatë roli i tyre aktiv në përparimin e ungjillit dhe në kujdesin ndaj njerëzve të Zotit u realizua në mënyrë të tillë që nuk e cënoi aspak strukturën hyjnore të udhëheqjes mashkullore në Kishë.[50]

Cilësia kryesore e përmendur për pleqtë, e cila nuk kërkohet për dhjakët, është aftësia për të dhënë mësim (1 Timoteut 3:2). Edhe pse jo të gjithë pleqtë kanë dhunti të barabarta, sërish çdo plak duhet të jetë "i aftë të këshillojë të tjerët me mësimin e shëndoshë e të bindë ata që e kundërshtojnë" (Titit 1:9).

- Përse duhet që pleqtë të jenë të aftë që të japin mësim, për të përmbushur rolin e tyre, siç theksohet në vargjet e mëposhtme?
  - 1 Timoteut 1:3-4
  - 2 Timoteut 2:2
  - 2 Timoteut 4:1-2
  - Efesianëve 4:11-13

Disa e mendojnë të qenurit dhjak si një trampolinë drejt të bërit plak. Edhe pse kjo gjë është patjetër e mundshme, dhuntitë e ndryshme që kërkohen nënkuptojnë se jo çdo dhjak do të bëhet plak apo as ta aspirojë atë pozicion. Xherri Rag shkruan: "Habitem se sa shumë dhjakë të mirë përpiqen pafundësisht të bëhen pleq, pasi mendojnë se do të kenë më shumë ndikim dhe një status më të lartë në atë nivel. Për pasojë, ata mbajnë barrat e udhëheqësisë për të cilat nuk kanë qenë kurrë të dhuntuar, ndërsa nevoja për dhjakë të perëndishëm mbetet e paplotësuar."[51] Ata që janë përkushtuar të shërbejnë në kishë duhet të jenë të kënaqur të ushtrojnë me besnikëri dhuntitë që u ka dhënë Perëndia, duke ditur se çdo pjesë e trupit është jetësore për rritjen e trupit për lavdinë e Krishtit.

[50] Strauch, *Men and Women, Equal Yet Different*, 97.
[51] Wragg, *Exemplary Spiritual Leadership*, 85.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si i plotësojnë pleqtë dhe dhjakët rolet e ndryshme në udhëheqjen e kishës suaj?
3. Çfarë përvojash keni në mësimdhënie? A besoni se jeni të aftë të jepni mësim? Nëse po, si është konfirmuar nga të tjerët dhuntia juaj për mësimdhënie?
4. Si funksiononi praktikisht në udhëheqjen e shërbesave nën autoritetin e bashkëshortit tuaj? Po nën autoritetin e pleqve të kishës suaj?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i përëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Hosea 4:6**
> Populli im u zhbi prej padijes, se ti e përbuze njohurinë, ndaj edhe Unë priftërinë do ta përbuz. E harrove ligjin e Perëndisë tënd, ndaj edhe Unë do t'i harroj bijtë e tu.

## SHQYRTIM BIBLIK

**PËRGATITJE INDIVIDUALE:**

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## ISAIA

Kur Isaia nisi shërbesën e tij rreth vitit 740 para Krishtit, Izraeli po kalonte një kohë krize në historinë e vet. Asiria, fqinji kërcënues verilindor, po bëhej një forcë dominuese në rajonin e lashtë të Lindjes së Mesme. Si mbretëritë e veriut, ashtu edhe ato të jugut po tundoheshin të formonin aleanca politike pro ose kundër Asirisë. Ndërkohë, Izraeli dhe Juda po vuanin pasojat shkatërruese të kompromiseve morale dhe fetare. Perëndia e porositi Isaian të thërriste Izraelin dhe Judën në pendim ndaj mëkateve të tyre dhe për mosbesimin e treguar ndaj Tij si për shpëtimin personal ashtu edhe për çlirimin e kombit.[52]

### SKICIMI:

I. Ndëshkimi i Perëndisë (1-39)
II. Ngushëllimi i Perëndisë (40-66)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Shpëtimi

### KAPITUJT KYÇË:

6 Thirrja dhe porosia e Isaias
40-48 Izraelit i premtohet çlirimi
53 Shërbëtori Vuajtës
66 A ardhmja e lavdishme në Sion; plotësimi i historisë

- Përse “shpëtimi” është tema e duhur për librin e Isaias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Isaias.
- Lexoni gjithë librin e Isaias.

[52] H. L. Willmington, *Willmington’s Bible Handbook* (Wheaton, IL: Tyndale House, 1997), 355.

## JEREMIA

Braktisja, idhujtaria, adhurimi i papëlqyeshëm, rënia morale – këto ishin kushtet në të cilat jetoi dhe shërbeu Jeremia. Orteku i gjykimit po vjen dhe Jeremia thirret të shpallë këtë mesazh për dyzet vite. Si reagim i predikimeve të tij, profeti i dhembshur i Perëndisë përjeton dhimbje të forta nga duart e bashkëatdhetarëve të tij: kundërshtime, rrahje, izolim, burgim. Megjithatë, edhe pse i refuzuar e i persekutuar, Jeremia jetoi aq sa mundi të shohë shumë prej profecive të tij të bëra realitet. Ushtria babilonase mbërrin; hakmarrja zë fill; shenjtëria dhe drejtësia e Perëndisë përligjen, edhe pse kjo e thyen zemrën e profetit.[53]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Thirrja e Jeremias | (1) |
| II. | Profecitë e Judës | (2-45) |
| III. | Profecitë e Paganëve | (46-51) |
| IV. | Rënia e Jeruzalemit | (52) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Paralajmërimi Përfundimtar i Perëndisë

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 25 | Gjykimi i ardhshëm i Judës përmes Babilonisë për 70 vite; gjykohet Babilonia; gjithë kombet. |
| 31-32 | Restaurimi; besëlidhja e re; burgosja e Jeremias; ble një tokë; Perëndia shpjegon. |
| 52 | Shkatërrimi i Jeruzalemit |

- Përse “paralajmërimi përfundimtar i Perëndisë” është tema e duhur për librin e Jeremias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Jeremias.
- Lexoni gjithë librin e Jeremias.

[53] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 197.

## VAJTIMET

Vajtimet, ndoshta libri më i trishtueshëm i Dhiatës së Vjetër, është shkruar nga lotët e profetit Jeremia pas rënies së Jeruzalemit. Në pesë "kujat e vdekjes", Jeremia shpreh tmerrin dhe pafuqinë që ndjen duke parë qytetin më madhështor të judenjve të kthyer në rrënoja. Disfatë, kasaphanë, rrënim – tmerri i premtuar prej kohësh por shumë shpesh i mospërfillur – vjen tani nga duart e babilonasve brutalë. Megjithatë, edhe pse zemra e profetit thyhet, ai ndalon për të shpallur dëshminë kumbuese të besimit të thellë në mirësinë dhe mëshirën e Perëndisë.[54]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Shkatërrimi i Jeruzalemit | (1) |
| II. | Zemërimi i Perëndisë | (2) |
| III. | Kërkesa për Mëshirë | (3) |
| IV. | Rishqyrtim i Rrethimit | (4) |
| V. | Kërkesa për restaurim | (5) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Vajtim mbi Jeruzalemin

- Përse "vajtim mbi Jeruzalemin" është tema e duhur për librin e Vajtimeve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Vajtimeve.
- Lexoni gjithë librin e Vajtimeve.

[54] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 206.

## EZEKIELI

Ezekieli u kap rob e u çua në Babiloni, në 597 para Krishtit... Ai jetoi në Babiloni gjatë ditëve të fundit të mbretërisë jugore të Judës. Është e rëndësishme të themi që kapitujt 1-24 u dhanë përpara rënies dhe shkatërrimit të Jeruzalemit në 586 para Krishtit. Këta kapituj flasin për mëkatin dhe mosbesimin e Judës me deklarata shumë të vrazhda. Pas rënies së Jeruzalemit në 586 para Krishtit, mesazhi i Ezekielit ndryshon rrënjësisht në profeci shprese dhe ngushëllimi (kap. 33-48).[55]

### SKICIMI:

I. Dënim (1-32)
II. Ngushëllim dhe Restaurim (33-48)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Dënim, Ngushëllim dhe Restaurim

### KAPITUJT KYÇË:

8-11 Lavdia e Perëndisë largohet
36-37 Bekohen malet e Izraelit; ripërtëritja e Izraelit; lugina e eshtrave të thata; ribashkimi i Izraelit dhe Judës; Davidi do të bëhet mbreti i tyre.
38-39 Profeci kundër Gogut dhe Magogut
40-48 Tempulli; lavdia e Perëndisë; adhurimi; restaurimi i tokës

- Përse "dënim, ngushëllim dhe restaurim" është tema e duhur për librin e Ezekielit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Ezekielit.
- Lexoni gjithë librin e Ezekielit.

[55] Paul Benware, *Survey of the Old Testament* (Chicago, IL: Moody, 1993), 233.

## DANIELI

I shpërngulur në Babiloni... dhe i zgjedhur në shërbim të qeverisë, Danieli bëhet zëdhënësi profetik i Perëndisë për botën pagane dhe judaike, duke shpallur qëllimin aktual dhe të përjetshëm të Perëndisë... Si në aventurat e tij personale, ashtu edhe në vizionet profetike, Danieli tregon udhëzimin, ndërhyrjen dhe fuqinë e Perëndisë në çështjet e njerëzve.[56]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Historia Personale e Danielit/Të Mbeturit | (1) |
| II. | Plani Profetik për Paganët/Perëndia është në kontroll | (2-7) |
| III. | Plani Profetik për Izraelin/Ka një të Ardhme | (8-12) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni çdo kapitull kyç.

**TEMA:** Sovraniteti i Perëndisë përmbi Historinë Njerëzore

### KAPITUJT KYÇË:

3 Shtatorja idhull e Nabukodonosorit; furra e zjarrit
5 Belshacari dhe shkrimi mbi mur.
6 Dekreti i Darit dhe Danieli në gropën e luanëve
7 Vegimi i Danielit mbi katër bishat
9 Vegimi i Danielit mbi shtatëdhjetë javët

- Përse “sovraniteti i Perëndisë përmbi historinë njerëzore” është tema e duhur për librin e Danielit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Danielit.
- Lexoni gjithë librin e Danielit.

[56] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 221.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Çfarë gjendet tek Isaia 55?
    - Cila është tema e librit të Jeremias?
    - Çfarë gjendet te Danieli 9?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Kënga e Këngëve.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – EKLEZIOLOGJI

> **1 Timoteut 3:15**
> ...por nëse vonohem, të dish se si duhet të sillet njeriu në shtëpinë e Perëndisë, që është kisha e Perëndisë së gjallë, shtylla dhe themeli i së vërtetës.

**Ekleziologjia** është studimi i doktrinës së kishës.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në ekleziologji janë:

- Natyra e Kishës (Lokale dhe Universale)
- Qëllimet e Kishës
- Qeverisja e Kishës
  - Pleqtë
  - Dhjakët
- Urdhëresat e Kishës
  - Pagëzimi
  - Darka e Zotit

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Kishës.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth ekleziologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### CILAT JANË QËLLIMET E KISHËS?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Mateu 28:19-20
  - Veprat e Apostujve 2:42
  - Efesianëve 3:20-21, 4:11-16
  - Kolosianëve 1:28

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Mejhju në *Doktrina Biblike***
> Për sa i përket mënyrës se si lidhet kisha me anëtarët e saj, qëllimi i saj mund të përmblidhet si më poshtë: kisha ekziston për të lavdëruar Perëndinë (Efes. 1:5-6, 12-14; 3:20-21; 2 Sel. 1:12) duke i ndërtuar e forcuar anëtarët e saj në besim (Efes. 4:12-16), duke dhënë mësime me besnikëri ndaj Fjalës (2 Tim. 2:15; 3:16-17), duke vëzhguar rregullisht urdhëresat që i janë dhënë asaj (Luka 22:19; Veprat e Apostujve 2:38-42), duke ushqyer aktivisht miqësinë mes besimtarëve (Veprat e Apostujve 2:42-47; 1 Gjonit 1:3), duke shpallur me guxim të vërtetën e ungjillit ndaj të humburve (Mat. 28:19-20). Ky qëllim mund të përmblidhet në tre nëntitujt e mëposhtëm.
>
> **Lartësimi i Perëndisë** – Meqë Perëndia është i zellshëm për lavdinë e Tij (Isa. 48:9-11; krahaso edhe Isa. 43:6-7; 49:3), atëherë populli i Tij duhet të pushtohet nga dëshira për ta lavdëruar dhe lartësuar Atë (1 Kor. 10:31; 6:20). Për pasojë, një kishë besnike përqendrohet te Perëndia dhe jo te njeriu. Kisha është shpenguar që besimtarët ta lavdërojnë Atë duke i shërbyer njëri-tjetrit (1 Pjet. 4;11) dhe duke shpallur "veprat e Tij madhështore, i cili i thirri (ata) nga errësira në dritën e Tij të mrekullueshme" (1 Pjet. 2:9).
>
> Një nga mënyrat kryesore me të cilat e lavdëron kisha Perëndinë është përmes adhurimit dhe lavdërimit. Sa herë që kisha mblidhet bashkërisht, adhurimi duhet të jetë përparësia themelore...
>
> **Edukimi i besimtarëve -** ...edukimi dhe mësimi zënë vend përmes shërbesës së Fjalës (Veprat e Apostujve 20:32; 2 Tim. 3:15-17; 1 Pjet. 2:2), mentorimit të udhëheqësve të perëndishëm (Efes. 4:11-12), ushtrimit të dhuntive shpirtërore pa u mburrur (1 Kor. 12:7; 1 Pjet. 4:10), dhe zbatimit praktik të urdhërimeve mbi "njëri-tjetrin" në Dhiatën e Re...
> **Ungjillizimin e të humburve** – Një kishë që ndjek me pasion lavdinë e Perëndisë e thekson fuqishëm ungjillizimin, si atë lokal, ashtu edhe atë përreth botës... urdhërimi ungjillizues i kishës është artikuluar nga vetë Jezui, te Mateu 28:18-20.[57]

- Përgjigjuni me fjalët tuaja pyetjes: "Cilat janë qëllimet e kishës?".

[57] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 751–53.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e Kishës si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:
    - Cilat janë qëllimet e Kishës?
    - Cilat janë dallimet mes pleqve dhe dhjakëve?
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
    - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?
    - Si do ta përkufizonit Trininë?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Klement**
> Sa më i madh të duket (dikush), aq më shumë i përulur duhet të jetë dhe aq më shumë duhet të kërkojë të mirën e përbashkët përpara asaj të vetes.[58]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Jo mendjemadh**

  **Titit 1:7** Peshkopi… duhet të jetë i paqortueshëm, jo përbuzës, as gjaknxehtë…

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni 1 Pjetrit 4:1-3. Përse duhet që çdo besimtar të jetojë për vullnetin e Perëndisë dhe jo për dëshirat e veta?

  - Si mund të tundoheni të jetoni të përqendruar te vetvetja?

    - Në shtëpi?

[58] *Clement's First Letter*, 48:6–49:1.

- Në kishë?

- Në punë?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si mund ta shkatërrojë unitetin mes udhëheqjes një udhëheqës egoist mendjemadh?
3. Çfarë e motivon një udhëheqës të perëndishëm, joegoist e jomendjemadh?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## STUDIM BIBLIK

> **2 Timoteut 2:15**
> Mundohu të dalësh i sprovuar përpara Perëndisë, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që e shpjegon drejt Fjalën e së vërtetës.

> **Xhonatan Eduarts**
> Jam i vendosur të studioj Shkrimin vazhdimisht e në mënyrë të rregullt, në mënyrë që të mund të rritem e të thellohem në të.[59]

- Përse është e rëndësishme që jo vetëm ta lexoni Biblën, por edhe ta studioni atë më në thellësi?

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të studimit të Biblës. Çfarë mjetesh ndihmëse përdorni zakonisht gjatë studimit?

- Përse ka rëndësi studimi i rregullt personal i Biblës në rritjen dhe pjekurinë shpirtërore?

[59] "*The Resolutions of Jonathan Edwards*," Desiring God, December 30, 2006, https://www.desiringgod.org/articles/the-resolutions-of-jonathan-edwards.

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si jeni rritur në aftësitë tuaja për të studiuar Biblën?
3. Çfarë keni mësuar kohët e fundit gjatë studimit tuaj të Biblës?

# Kapitulli 6

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **UDHËHEQJE SHËRBËTORE**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Hosea:** Dashuria Besnike e Perëndisë
  - **Joeli:** Dita e Zotit
  - **Amosi:** Padrejtësia Shoqërore në Izrael
  - **Abdia:** Gjykimi i Edomit
  - **Jonai:** Mëshira e Perëndisë ndaj Paganëve të Penduar
  - **Mikea:** Drejtësia e Perëndisë përballë Padrejtësisë Shoqërore të Judës
  - **Naumi:** Shkatërrimi i Ninivës
  - **Habakuku:** Besim dhe Dyshim Pavarësisht Mërgimit të Judës
  - **Sofonia:** Gjykimi i Ardhshëm Global
  - **Hagai:** Thirrje për të Rinisur Rindërtimin e Tempullit
  - **Zakaria:** Ngushëllimi dhe Lavdia e Izraelit (Përgatitje për Mesian)
  - **Malakia:** Thirrje për Pendim; Pritje për Mesian

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Antropologji dhe Hamartiologji: Studimi i Doktrinës së Njeriut dhe Mëkatit
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Jo gjaknxehtë apo i ashpër, por i butë dhe paqësor

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Shërbimi

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## UDHËHEQJE SHËRBËTORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Shpesh udhëheqja keqkuptohet së tepërmi. Për shumë njerëz, udhëheqja është kryesisht të paturit e autoritetit për t'i vënë të tjerët të bëjnë atë që do ti, si edhe për marrjen e nderit dhe njohjes që besojnë se mund të vijë me pozicionin e tyre. Shumë, në mos shumica, që aspirojnë udhëheqjen, veprojnë në këtë mënyrë duke i pasur kryesisht këto qëllime në mendjen e tyre. Madje edhe dishepujt, të cilët kaluan kohë të mjaftueshme me Jezuin, kishin të njëjtin këndvështrim në lidhje me udhëheqjen të përqendruar te vetvetja. Nga fundi i shërbesës së Krishtit, Marku 10 tregon se si prisnin ata që Jezui të fillonte të mbretëronte dhe sundonte si mbret, bashkë me dëshirën e tyre për të siguruar vendin e tyre të nderit dhe autoritetit përkrah Tij.

> **Marku 10:35-41**
> Jakobi e Gjoni, bijtë e Zebedeut, iu afruan e i thanë: "Mësues, duam të bësh për ne gjithçka që të kërkojmë". Ai u tha: "Çfarë doni që të bëj?". Ata i thanë: "Na lejo që në lavdinë Tënde të ulemi njëri në të djathtën e tjetri në të majtën Tënde". Por Jezui u tha: "Ju nuk dini çfarë kërkoni. A mund ta pini ju kupën që do të pi Unë, apo të pagëzoheni me pagëzimin që me të cilin do të pagëzohem Unë?". Ata iu përgjigjën: "Mundemi". Jezui u tha: "Kupën që do të pi Unë do ta pini edhe ju e do të pagëzoheni me pagëzimin me të cilin do të pagëzohem edhe Unë, por që të uleni në të djathtën a në të majtën Time, nuk më takon Mua ta vendos, sepse vendet u takojnë atyre për të cilët janë përgatitur". Kur e dëgjuan këtë gjë, dhjetë të tjerët u zemëruan me Jakobin e me Gjonin.

Jakobi dhe Gjoni dëshironin vende nderi dhe autoriteti në krah të Jezuit dhe nuk kishin fare turp t'i kërkonin Atij pozita të tilla. Dishepujt e tjerë u indinjuan me ta, ka të ngjarë "për faktin se ata u sulën të parët dhe u përpoqën të përfitonin një favor në mënyrë të padrejtë mbi kolegët e tyre, në garën për vendet e para. Në lidhje me këtë gjë, ata janë që të gjithë bashkëfajtorë të të njëjtit gabim."[60]

Jezui e përdori këtë mundësi për t'i mësuar ata në lidhje me udhëheqjen e vërtetë, për madhështinë e vërtetë. Sikurse shkruan edhe J. Osvald Sendërs, Ai u mësoi atyre që "madhështia e vërtetë, udhëheqja e vërtetë, gjendet duke e dhënë veten në shërbim të të tjerëve dhe jo duke kërkuar apo duke i detyruar ata që t'ju shërbejnë juve."[61]

### KONTRASTI I QARTË I UDHËHEQJES SHËRBËTORE

Një udhëheqje e tillë qëndron në kontrast të plotë me udhëheqjen e botës. Jezui dëshironte që dishepujt e Tij ta kishin shumë të qartë këtë dallim.

[60] R. T. France, *The Gospel of Mark: A Commentary on the Greek Text* (Grand Rapids, MI: Eerdmans;Paternoster, 2002), 418.
[61] Sanders, *Spiritual Leadership,* 15.

> **Marku 10:42-44**
> Por Jezui i afroi pranë vetes e u tha: "Ju e dini se ata që e mbajnë veten si krerë të kombeve sundojnë mbi to dhe të mëdhenjtë e tyre ushtrojnë pushtet mbi to. Me ju nuk duhet të ndodhë kështu, por nëse dikush nga ju dëshiron të bëhet i madh, le të jetë shërbëtori juaj, dhe nëse dikush dëshiron të jetë i pari, le të bëhet shërbëtor i të gjithëve".

- Si mund të sundojnë udhëheqësit mbi të tjerët në po atë mënyrë siç veprojnë sunduesit paganë?

Kur Jezui vuri në dukje udhëheqësit botërorë, me sundimin e autoritetit të tyre, Ai nuk po denigronte autoritetin në vetvete. Bibla është e qartë që Perëndia është autoriteti përfundimtar dhe Ai vetë ka themeluar struktura të autoritetit njerëzor për të mirën tonë (Romakëve 12:1-2). Një autoritet i tillë është i nevojshëm në shoqëri, në kishë dhe në shtëpi. Jezui po e vinte theksin tek autoriteti dhe madhështia e vërtetë, të cilat nuk janë për të ushtruar autoritet mbi të tjerët dhe se përdorimi i tyre do të jetë krejtësisht i ndryshëm për udhëheqësit që ndjekin Krishtin. Udhëheqësit biblikë mund ta ushtrojnë autoritetin sipas skicimit të Perëndisë, por ata e bëjnë këtë si shërbëtorë, si skllevër ndaj të gjithëve.

> **Uein Mak**
> Sipas Biblës, udhëheqësi është së pari dhe mbi të gjitha një shërbëtor. Meraku i tij nuk është vetvetja; shqetësimi i tij nuk është të japë urdhëra, të jetë shef mbi të tjerët, të bëjë si di vetë. Meraku i tij duhet të jetë plotësimi i nevojave të të tjerëve.[62]

> **Methju Henri**
> ...ata që vendosen nën ngarkimin tuaj, duhet të jenë si delet në ngarkim të bariut, i cili duhet t'i ruajë e t'i ushqejë ato, t'u shërbejë atyre, dhe jo t'i ketë si kuajt nën urdhërat e kalorësve, të cilët i shfrytëzojnë e i rrahin, duke kërkuar t'u nxjerrin të zitë e ullirit.[63]

- Çfarë ndryshimesh ka kur një udhëheqës e sheh veten së pari e mbi të gjitha si shërbyes ndaj të tjerëve, dhe jo si një pronar përmbi ta?

- Përse është e vështirë që udhëheqësit të ruajnë këtë këndvështrim?

[62] Wayne Mack, *Strengthening Your Marriage* (Phillipsburg, NJ: P&R, 1999), 33.
[63] Matthew Henry, *Matthew Henry's Commentary on the Whole Bible: Complete and Unabridged in One Volume* (Carol Stream, IL: Hendrickson/Tyndale House, 1994), 1802.

## SHEMBULLI I PËRKRYER I UDHËHEQËSIT SHËRBËTOR

Udhëzimi i Jezuit mbi natyrën e udhëheqjes ishte tërësisht i ndryshëm dhe tejet tronditës. J. Osvald Sendërs e përshkruan Atë si "një revolucionar, jo në kuptimin e luftës guerrile, por në mësimdhëniet e Tij mbi udhëheqjen". Jezui nuk i thirri dishepujt e Vet dhe as ne drejt një standarti të cilin nuk do ta arrinte dot Vetë. Përkundrazi, Ai është shembulli i përkryer i udhëheqjes shërbëtore të cilën janë thirrur ta veshin gjithë ndjekësit e Tij.[64]

> **Marku 10:45**
> ...sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi t'i shërbejnë, por erdhi për të shërbyer e për të dhënë jetën e Vet si shpengim për shumë njerëz.

> **R. H. Stein**
> Për Markun, modeli më i mirë i madhështisë dhe i shërbëtorit në mbretërinë e Perëndisë gjendet te Jezui, udhëheqësi model...[65]

- Si ju shërbeu Jezui të tjerëve?

- Lexoni Gjoni 13:1-17. Si duhet të ndikojë shembulli i Jezuit në këndvështrimin dhe praktikën tuaj mbi udhëheqjen?

## ZEMRA VETËMOHUESE E UDHËHEQËSIT SHËRBËTOR

Nëse udhëheqësit do të ndjekin shembullin e Jezuit për të qenë udhëheqës shërbëtorë ndaj të tjerëve, atëherë ata jo vetëm që duhet të imitojnë veprimet e Tij, por gjithashtu duhet të bashkë ndajnë edhe zemrën e Tij. Për shkak të dashurisë së Tij të madhe, Jezui shërbeu me vullnet, madje deri në vdekje. Disa nga vargjet më të njohura në Bibël përqendrohen në lidhjen mes dashurisë së Perëndisë dhe sakrificës së Krishtit (Gjoni 3:16, Romakëve 5:8, 1 Gjonit 4:7- 10). Sikurse thuhet edhe te 1 Gjonit 3:16, "Ja si e njohëm dashurinë: Jezu Krishti dha jetën e Tij për ne..." Po kështu, udhëheqja e vërtetë shërbëtore duhet të rrjedhë nga zemra e mbushur me dashuri për Perëndinë dhe për të tjerët.

> **1 Korintasve 13:1-3**
> Sikur të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, por të mos kisha dashuri do të isha si bronzi që kumbon, ose si cimbali që tingëllon. Edhe sikur të kisha dhuntinë e profecisë, të njihja të gjitha të fshehtat, të zotëroja të gjitha dijet dhe të kisha gjithë besimin për të lëvizur malet prej vendit, por të mos kisha dashuri, nuk do të isha asgjë. Edhe sikur t'ua ndaja të varfërve gjithë pasurinë dhe ta jepja trupin të digjej, por të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë.

[64] Sanders, *Spiritual Leadership*, 21.
[65] R. H. Stein, *Mark* (Grand Rapids, MI: Baker, 2008), 488.

> **Robert Peterson & Aleksandër Strauç**
> Për ata që kërkojnë të jenë udhëheqës dhe mësues për popullin e Perëndisë, Jezu Krishti këmbënguli vazhdimisht që së pari të jemi të përulur në mendimet tona, që të mos orvatemi për reputacion, famë apo pozitë. Ai na thërret që t'i shërbejmë njëri-tjetrit duke sakrifikuar, t'i falim ata që na lëndojnë, si dhe ta trajtojmë njëri-tjetrin si vëllezër e motra në familjen e Perëndisë. Të gjitha këto mund t'i përmbledhim me një fjalë – dashuri.[66]

- Përse është thelbësore dashuria për udhëheqjen biblike?

Përveç zemrës vetë ofruese plot dashuri, udhëheqja shërbëtore duhet të rrjedhë nga një zemër e përulur që shqetësohet sinqerisht më shumë për të tjerët sesa për veten.

> **Stjuart Skot**
> Kur dikush është i përulur, ai përqendrohet te Perëndia dhe te të tjerët, jo te vetvetja. Edhe përqendrimi te të tjerët vjen nga dëshira për të dashur e për të lavdëruar Perëndinë. Nuk ka pse të bjerë në sy apo të duartrokitet. Nuk ka konkurrencë me Perëndinë e as me të tjerët. Nuk ka nevojë ta lartësojë veten, duke e ditur që është i falur dhe që dashuria e Perëndisë është vendosur brenda tij në mënyrë të pameritуar e të pakthyeshme. Synimi i një personi të përulur është që të lartësohet Perëndia dhe të inkurajohen të tjerët.[67]

Jezui e demonstroi në mënyrë të përsosur një përulësi të tillë, duke u përqendruar në lavdinë e Atit dhe në të mirën e të tjerëve, jo te Vetvetja. Jemi thirrur të kemi të njëjtin qëndrim.

> **Filipianëve 2:3-8**
> Mos bëni asgjë prej sedrës së sëmurë a për lavdi të kotë, por me përulësi çmojeni tjetrin më shumë se veten. Mos kërkoni vetëm të mirën tuaj, por edhe të mirën e të tjerëve. Kini ndër ju po atë mendje që kishte edhe Krishti Jezu, I cili, megjithëse kishte natyrë hyjnore, të qenit i barabartë me Perëndinë nuk e pa si diçka pas së cilës të mbahej fort, por e zbrazi veten duke marrë natyrë shërbëtori e u bë i ngjashëm me njerëzit. Kur u shfaq si njeri, Ai e përuli veten e u bë i bindur deri në vdekje, madje me vdekje në kryq.

- Çfarë do të jetë ndryshe nëse një udhëheqës përqendrohet në të mirën e të tjerëve dhe jo në interesin e vet personal?

[66] Robert Peterson and Alexander Strauch, *Agape Leadership* (Littleton, CO: Lewis and Roth, 1991), 8.
[67] Stuart Scott, *The Exemplary Husband* (Bemidji, MN: Focus, 2002), 197.

- Përse është më e lehtë që udhëheqësit të përqendrohen te vetvetja? Si mund të mbrohen ndaj këtij tundimi?

Udhëheqja e përqendruar te vetja është në kundërshtim të plotë me udhëheqjen që i ngjason Krishtit dhe qortohet ashpër nga Perëndia (p.sh. Ezekieli 34:1-3). Po ashtu, ajo është vrastare për udhëheqësin dhe lënduese për njerëzit që udhëheq ai.

> **Xherri Rag**
> Kur udhëheqja përqendrohet te vetvetja dhe bëhet tmerruese prej mëkatit, atëherë ne jemi si ai njeri jeta e të cilit rrethohet prej pasqyrave në të cilat ai vështron me nervozizëm për të ruajtur imazhin e vet. Burimet dhe marrëdhëniet kthehen në objekte të thjeshta për t'u përdorur, jo për të mirën e të tjerëve, por për ngritjen më tej të reputacionit dhe të rëndësisë që i jep vetes. Vizioni dhe dallimi rrjedhin tek ai udhëheqës qëllimi kryesor i të cilit qëndron shumë më lart se madhështia personale. Një udhëheqës-shërbëtor i vërtetë i kanalizon energjitë dhe dhuntitë e të tjerëve drejt qëllimeve të denja.[68]

- Si udhëheqës, a mund të dalloni kur keni qenë të përqendruar te vetja më shumë se te të tjerët dhe te Krishti?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Çfarë ndryshimi praktik do të sjellë në mënyrën tuaj të udhëheqjes mendësia e udhëheqësit shërbëtor:
    - Në shtëpi?
    - Në punë?
    - Në kishë?
3. Si mund të tundoheni që të sundoni mbi të tjerët me mënyrën tuaj të udhëheqjes? Si duhet t'i shihni dhe t'i trajtoni të tjerët?
4. Si duhet ta pasqyrojnë udhëheqësit biblikë shembullin e Krishtit në mënyrën e tyre të udhëheqjes?

[68] Wragg, *Exemplary Spiritual Leadership*, 32.

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik i kishës kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i përëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Xhon MekArthër**
> ...udhëheqësi duhet ta njohë Shkrimin. Ai duhet të besojë me bindje të patundur që Fjala e Perëndisë është e vërtetë. Po ashtu, duhet të jetë i aftë të komunikojë të vërtetën e Fjalës së Perëndisë me bindje e siguri.[69]

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

[69] MacArthur, *Called to Lead*, 35.

## HOSEA

Historia e trishtueshme e Hoseas dhe e gruas së tij mosbesuese, Gomerës, ilustron dashurinë besnike të Perëndisë dhe tradhtinë shpirtërore të Izraelit. Hosea nxjerr në pah mëkatin e Izraelit duke e vënë atë në kontrast me shenjtërinë e Perëndisë. Kombi duhet të gjykohet për mëkatet e tij, por në të ardhmen ai do të restaurohet për shkak të dashurisë dhe besnikërisë së Perëndisë.[70]

### SKICIMI:

I. Bashkëshortja Imorale dhe Bashkëshorti Besnik (1-3)
II. Izraeli Imoral dhe Zoti Besnik (4-14)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Dashuria Besnike e Perëndisë

- Përse "dashuria besnike e Perëndisë" është tema e duhur për librin e Hoseas?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Hoseas.
- Lexoni gjithë librin e Hoseas.

[70] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 230.

## JOELI

Ky libër hedh vështrimin pas, në një ngjarje kur një mori karkalecash vërshuan dhe shkatërruan tokën e Judës, për të ilustruar ditën tejet tmerruese të Zotit. Toka do të pushtohet nga një ushtri e frikshme, para së cilës karkalecat do të dukeshin si diçka shumë e lehtë. Sidoqoftë, Perëndia u bën thirrje njerëzve të pendohen, në mënyrë që të shmanget shkatërrimi që po afrohet. Meqë njerëzit nuk pendohen, gjykimi do të vijë, por ai do ta pasohet nga bekime të mëdha.[71]

**SKICIMI:**

I. Dita e Zotit në Retrospektivë (1:1-2:17)
II. Dita e Zotit në Perspektivë (2:18-3:21)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Dita e Zotit

- Përse "dita e Zotit" është tema e duhur për librin e Joelit?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Joelit.
- Lexoni gjithë librin e Joelit.

[71] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 239.

## AMOSI

Amosi profetizoi gjatë një periudhe optimizmi kombëtar në Izrael. Tregtia po vlonte dhe kufijtë ekonomikë po shpërthenin. Por nën sipërfaqe, lakmia dhe padrejtësia po gërryenin. Veprimtaria fetare hipokrite kishte zënë vendin e adhurimit të vërtetë, duke krijuar kështu një ndjenjë të rreme sigurie dhe një pandjeshmëri në rritje ndaj dorës disiplinuese të Perëndisë... Amosi, bujku fshatar i kthyer në profet, dënoi rëndë dhe me vendosmëri mëkatin, duke u përpjekur të përfytyronte afrimin e gjykimit të Perëndisë dhe duke e mobilizuar kombin për pendim.[72]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Tetë Profecitë e Gjykimit | (1-2) |
| II. | Tre Predikimet mbi Mëkatin e Izraelit | (3-6) |
| III. | Pesë Vizionet e Ndëshkimit | (7-9:10) |
| IV. | Pesë Premtimet për Restaurimin e Izraelit | (9:11-15) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Padrejtësi Shoqërore në Izrael

- Përse "padrejtësi shoqërore në Izrael" është tema e duhur për librin e Amosit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Amosit.
- Lexoni gjithë librin e Amosit.

[72] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible,* 244.

## ABDIA

Ky profet jo shumë i njohur i mbretërisë së jugut ia drejton profecinë e tij të shkurtër kombit të Edomit, i cili shtrihej në kufirin juglindor të Judës. Edomi (që rridhte nga Esau) refuzoi të kujdesej për vëllanë e vet, Judën (që rridhte nga Jakobi). Gjykimi ndaj tij do të jetë një shkatërrim i plotë, për shkak të gëzimit që shfaqi kur u pushtua Jeruzalemi.[73]

### SKICIMI:

I. Gjykimi ndaj Edomit (1:1-18)
II. Restaurimi i Izraelit (1:19-21)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Gjykimi ndaj Edomit

- Përse "gjykimi ndaj Edomit" është tema e duhur për librin e Abdias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Abdias.
- Lexoni gjithë librin e Abdias.

[73] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 250.

## JONAI

Libri i Jonait tregon se si Perëndia do të falë këdo që pendohet. Kjo është e vërtetë si për një shërbëtor të pabindur të Tij, ashtu edhe për armiqtë kërcënues të popullit të Tij, që në këtë rast janë asirianët e Ninivës. Ngurrimi dhe rebelimi i Jonait për të shkuar e për të predikuar pendimin në kryeqytetin asirian të Ninivës vjen për shkak se ai e di që Perëndia do të tregojë mëshirë për asirianët nëse ata pendohen, si edhe për shkak se ai i sheh ata me të drejtë si një kërcënim i madh për sigurinë e Izraelit. Ky libër thekson nevojën e atyre që e njohin Perëndinë për t'iu bindur Atij pa kushte. Po ashtu, ai na kujton se Perëndia është Sovran në kohën e Vet dhe në mënyrën se si i cakton rrethanat.[74]

**SKICIMI:**

I. Mëshira e Perëndisë ndaj Jonait (1-2)
II. Mëshira e Perëndisë ndaj Ninivës (3-4)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Mëshira e Perëndisë ndaj Paganëve që Pendohen

- Përse "mëshira e Perëndisë ndaj paganëve që pendohen" është tema e duhur për librin e Jonait?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Jonait.
- Lexoni gjithë librin e Jonait.

[74] Chrispin, *The Bible Panorama*, 374.

## MIKEA

Mikea profetizoi gjatë një periudhe padrejtësie të madhe shoqërore në Judë. Profetë të rremë profetizonin për pasuri, jo për drejtësi. Princat jepeshin pas mizorive, dhunës e korrupsionit. Priftërinjtë i shërbenin më tepër lakmisë se Perëndisë. Pronarët vidhnin të varfrit dhe dëbonin të vejat. Gjyqtarët digjeshin për ryshfete. Tregtarët mashtronin në masa e kandarë. Mëkati kishte hyrë në çdo segment të shoqërisë... Mikea rendit mëkatet e popullit, mëkate të cilat do të çojnë përfundimisht në shkatërrim e robëri. Megjithatë, në mes të errësirës ka shpresë. Do ta dalë një Çlirimtar Hyjnor dhe drejtësia do të mbizotërojë. Edhe pse drejtësia tani nëpërkëmbet, një ditë ajo do të triumfojë.[75]

### SKICIMI:

I. Parashikimi i Shpagimit (1-3)
II. Parashikimi i Restaurimit (4-5)
III. Lutje për Pendim (6-7)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Drejtësia e Perëndisë përballë Padrejtësisë Shoqërore të Judës

- Përse “drejtësia e Perëndisë përballë padrejtësisë shoqërore të Judës” është tema e duhur për librin e Mikeas?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Mikeas.
- Lexoni gjithë librin e Mikeas.

[75] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 261.

## NAUMI

Ninivës i ishte dhënë privilegji për të njohur Perëndinë e vetëm të vërtetë. Pas predikimit të Jonait, ky qytet i madh pagan u pendua dhe Perëndia plot mëshirë e ndali gjykimin e Tij. Megjithatë, njëqind vite më vonë, Naumi shpalli rënien e po këtij qyteti. Asirianët e kanë harruar tashmë rizgjimin e tyre u dhe janë kthyer zakoneve të dhunës, idhujtarisë dhe arrogancës. Për pasojë, Babilonia do ta shkatërrojë kaq keq qytetin sa nuk ka për t'i mbetur as nam e nishan – profeci e plotësuar deri në detaje të dhimbshme.[76]

### SKICIMI:

I. Shenjtëria Madhështore e Perëndisë (1)
II. Gjykimi ndaj Ninivës (2-3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Shkatërrimi i Ninivës

- Përse "shkatërrimi i Ninivës" është tema e duhur për librin e Naumit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Naumit.
- Lexoni gjithë librin e Naumit.

[76] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 267.

## HABAKUKU

Habakuku profetizon ndërkohë që dielli është duke perënduar në perandorinë asiriane dhe duke lindur në atë babilonase. Libri paraqet problemin e Habakukut, veçanërisht faktin që ai nuk mund ta kuptojë dot se përse mëkati, dhuna dhe padrejtësia mund të përhapen kaq shumë. Më pas, kur atij i thuhet se Perëndia do të gjykojë popullin e Tij me shtypjen që do të vijë nga kaldeasit tejet mizorë e paganë, ai nuk mund ta rrokë dot se si Perëndia, që është i shenjtë, të mund të përdorë një popull të tillë kaq barbar si instrument gjykimi ndaj popullit të Tij. Edhe pse nuk e kupton tërësisht, Habakuku lutet me përulësi për mëshirën e Perëndisë dhe e lavdëron Atë për fuqinë e Tij madhështore. Ai gjen ngushëllim te Perëndia, i cili është forca e tij dhe mbetet besnik në të gjitha situatat, madje edhe në ato më të pafavorshmet e më armiqësoret.[77]

### SKICIMI:

I. Paqartësitë e Habakukut (1-2)
II. Lutja/Lavdërimi i Habakukut (3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Besim dhe Dyshim nën dritën e Robërimit të Judës

- Përse “besim dhe dyshim nën dritën e robërimit të Judës” është tema e duhur për librin e Habakukut?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Habakukut.
- Lexoni gjithë librin e Habakukut.

[77] Chrispin, *The Bible Panorama*, 381.

## SOFONIA

Në terma shumë të qarta, Sofonia zhvillon temën e ditës së Zotit, e cila po afron si një ditë e gjykimit të mrekullueshëm dhe e ndjekur nga bekime të mëdha. Sofonia e nis me gjykimin që po afron ndaj Judës dhe e zgjeron idenë duke përfshirë edhe paganët. Juda do të mbetet nën ndëshkim, pasi nuk pranon të kërkojë Zotin. Megjithatë, një pjesë e mbetur do të ngazëllohet kur Perëndia të restaurojë pasuritë e popullit të Tij.[78]

### SKICIMI:

I. Profecitë e Gjykimit (1-2)
II. Profecitë e Bekimit të Ardhshëm (3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Gjykimi i Ardhshëm Global

- Përse "gjykimi i ardhshëm global" është tema e duhur për librin e Sofonias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Sofonias.
- Lexoni gjithë librin e Sofonias.

[78] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 277.

## HAGAI

Pas mërgimit babilonas, judenjtë nisën të rindërtonin tempullin, por puna u la në mes sepse ata rindërtuan shtëpitë e tyre. Meqë nuk i dhanë përparësi Perëndisë, ata nuk mund të gëzonin bekimet e Tij në tokën e tyre. Hagai iu përgjërua popullit që të përfundonin tempullin sepse Perëndia kishte premtuar që do ta mbushte me gëzim. Pasi i bëri të kuptojnë papastërtinë e tyre, Hagai e mbyll me një premtim për bekimin e ardhshëm.[79]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Qortim për Mosbindje | (1:1-11) |
| II. | Rindërtimi i Tempullit | (1:12-15) |
| III. | Rikthimi i Lavdisë së Perëndisë | (2:1-9) |
| IV. | Pyetje Fetare | (2:10-19) |
| V. | Sundimi i Perëndisë | (2:20-23) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Thirrje për të Rifilluar Rindërtimin e Tempullit

- Përse “thirrje për të rifilluar rindërtimin e tempullit” është tema e duhur për librin e Hagait?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Hagait.
- Lexoni gjithë librin e Hagait.

[79] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 282.

## ZAKARIA

Edhe Zakaria, një bashkëkohës i Hagait, i nxit judenjtë që të përfundojnë ndërtimin e tempullit. Zakaria i motivon ata me anë të inkurajimit – tempulli është qendra e trashëgimisë shpirtërore të Izraelit dhe ai lidhet me ardhjen e Mesias. Seria e vizioneve, mesazheve dhe barrëve që mbartte Zakaria na jep disa nga profecitë më të qarta mesianike në Shkrim. Perëndia zbulon që programi që ka Ai për popullin e Tij është ende larg realizimit.[80]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Thirrja për Pendim | (1:1-6) |
| II. | Tetë Vizionet e Zakarias | (1:7-6) |
| III. | Katër Mesazhet e Zakarias | (7-8) |
| IV. | Dy Barrët e Zakarias | (9-14) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Ngushëllimi dhe Lavdia e Izraelit (Përgatitja për Mesian)

- Përse “ngushëllimi dhe lavdia e Izraelit (përgatitja për Mesian)” është tema e duhur për librin e Zakarias?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Zakarias.
- Lexoni gjithë librin e Zakarias.

[80] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible,* 288.

## MALAKIA

Në kohën e Malakias, profetit të fundit të Dhiatës së Vjetër, klima morale dhe shpirtërore e popullit është ftohur shumë. Adhurimi i tyre është mospërfillës e i pakuptimtë dhe, ndërkohë që largohen akoma më shumë nga Perëndia, ata karakterizohen nga kompromise fetare dhe shoqërore.[81]

**SKICIMI:**

I. Deklarata e Perëndisë kundër Izraelit (1-3:15)
II. Premtimi i Perëndisë ndaj Izraelit (3:16-4:6)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Thirrje për Pendim, në Pritje për Mesian

- Përse "thirrje për pendim, në pritje për Mesian" është tema e duhur për librin e Malakias?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të librit të Malakias.
- Lexoni gjithë librin e Malakias.

[81] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 294.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e librit të Hoseas?
    - Cila është tema e librit të Naumit?
    - Cila është tema e librit të Zakarias?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Danieli.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – ANTROPOLOGJI DHE HAMARTIOLOGJI

> **Zanafilla 1:27**
> Perëndia krijoi njeriun në shëmbëlltyrën e Vet, në shëmbëlltyrën e Perëndisë e krijoi, mashkull e femër i krijoi.

**Antropologjia** është studimi i doktrinës së njeriut.
**Hamartiologjia** është studimi i doktrinës së mëkatit.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në antropologji janë:

- Krijimi i Njeriut
- Imazhi i Perëndisë
- Natyra e Njeriut
  - Trup dhe Shpirt
  - Gjinia

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në hamartiologji janë:

- Rënia në Mëkat
- Shthurja
- Vdekja

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e njeriut dhe mëkatit.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Lexoni kapitujt rreth antropologjisë dhe hamartiologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### SI MUND TA PËRKUFIZONI SHTHURJEN TOTALE?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Jeremia 17:9
  - Romakëve 3:10-18
  - Efesianëve 2:1-3
  - Efesianëve 4:17-19

> **J. I. Paker në *Teologjinë e Përmbledhur***
> Shprehja shthurje totale përdoret zakonisht për të qartësuar ndikimet e mëkatit origjinal. Kjo nënkupton një korruptim të natyrës sonë morale dhe shpirtërore që është totale dhe shtrihet kudo në masë, por jo në shkallë (pasi askush nuk është aq i keq sa filani). Shprehja deklaron që asnjë pjesë e jona nuk ka mbetur e paprekur nga mëkati, ndaj për këtë arsye asnjë veprim i yni nuk është aq i mirë sa duhet dhe për pasojë asnjë gjë e jona apo brenda nesh nuk e meriton vëmendjen e Perëndisë. Çfarëdo që të bëjmë, ne nuk mund ta fitojmë dot favorin e Perëndisë; pa hirin shpëtues, ne jemi të humbur.
>
> Shthurja totale çon në paaftësi totale, që do të thotë se askush nuk mund të reagojë ndaj Perëndisë dhe Fjalës së Tij me një zemër të pastër e të sinqertë (Gjoni 6:44; Rom. 8:7-8). Këtë mos reagim të zemrës së rënë në mëkat, Pali e quan vdekje (Ef. 2:1, 5; Kol. 2:13), ndërsa në deklaratën e Rrëfimit Uestministër thuhet: "Me rënien e tij në gjendjen e mëkatit, njeriu e ka humbur tërësisht gjithë aftësinë e vullnetit ndaj çdo të mire shpirtërore që pason e shoqëron shpëtimin; prandaj çdo njeri natyror, duke qenë plotësisht kundër kësaj të mire dhe i vdekur në mëkat, e ka të pamundur që me forcat e veta të kthehet atje ku ishte, apo të zhbëjë atë që është bërë" (IX. 3).[82]

- Përkufizoni me fjalët tuaja shthurjen totale.

[82] Packer, *Concise Theology: A Guide to Historic Christian Beliefs*, 83–84.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e njeriut dhe të mëkatit si dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjes së mëposhtme:
    - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
    - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?
    - Si do ta përkufizonit Trininë?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
    - Cilat janë qëllimet e kishës?

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Albert Mohler**
> Karakteri është i domosdoshëm për besueshmërinë, ndërkohë që besueshmëria është thelbësore për udhëheqjen.[83]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Jo gjaknxehtë apo i dhunshëm, por i butë dhe paqe bërës**

  **Titit 1:7** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... as gjaknxehtë... as i dhunshëm...

  **1 Timoteut 3:2-3** Peshkopi duhet të jetë i patëmetë... jo i dhunshëm, por i durueshëm, jo grindavec (paqe bërës)...

  - Përkufizojini me fjalët tuaja këto cilësi.

  - Përse janë të nevojshme këto cilësi për udhëheqjen?

  - Nga vargjet e mëposhtme, çfarë këshillash dhe paralajmërimesh jep Shkrimi për të gjithë besimtarët, në lidhje me këto cilësi?

    - Fjalët e Urta 14:17
    - Fjalët e Urta 15:18
    - Fjalët e Urta 16:32

[83] Mohler, *The Conviction to Lead*, 72.

- Romakëve 12:18
- Filipianëve 4:5
- Jakobi 3:17
- Titit 3:1-2

- Lexoni Jakobin 4:1-3.
  - Si lindin grindjet, zënkat e konfliktet nga dëshirat mëkatare të zemrës?

  - Si mund të tundohen besimtarët për të justifikuar konfliktet e mëkatshme?

## DISKUTIM MENTORAL (-15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si mund të jetë i butë dhe paqe bërës një udhëheqës i perëndishëm, ndërkohë që ruan bindje të forta biblike?
3. Kur duhet të jetë i gatshëm për kompromis një udhëheqës i perëndishëm? Kur duhet të qëndrojë i palëkundur?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## SHËRBIM

> **1 Pjetrit 4:10-11**
> Secili prej jush, si kujdestar i mirë i dhuntive të ndryshme të Perëndisë, ta përdorë dhuntinë e tij për t'u shërbyer të tjerëve. Kush predikon, le të predikojë fjalët e Perëndisë dhe kush shërben, le të shërbejë sipas fuqisë që i jep Perëndia, që Perëndia të përlëvdohet në gjithçka nëpërmjet Jezu Krishtit, të cilit i përket lavdia e pushteti, në shekuj të shekujve! Amen!

> **Pam Hardi**
> ...ekuilibri mes *familjes* dhe *shërbesës*... është i nevojshëm për të gjitha gratë e krishtera... Duket qartë që si familja ashtu edhe shërbesa janë bekime të mrekullueshme nga Zoti. Si besimtarë, kemi detyrime në të dyja këto fusha. Nëse jeni bashkëshorte, apo nëna, Bibla flet shumë për përgjegjësitë tuaja ndaj bashkëshortit dhe fëmijëve tuaj... Megjithatë, si anëtarë të trupit të Krishtit, kemi përgjegjësi për t'u shërbyer edhe të tjerëve brenda trupit... Të gjithëve na janë dhënë dhunti shpirtërore të cilat duhet t'i përdorim në shërbim të vëllezërve dhe motrave tona në Krishtin.[84]

- Përshkruani praktikën e rregullt të shërbimit brenda kishës.

- Përse shërbimi i rregullt është një aspekt i rëndësishëm në jetën e çdo besimtari?

- Çfarë i pengon disa besimtarë që t'i përdorin dhuntitë e tyre në shërbim të trupit?

[84] Pam Hardy, *Keeping Your Balance* (Franklin, TN: Carpenter's Son Publishing, 2020), 9-10.

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Përse shërbimi mund të shfaqë pjekurinë shpirtërore dhe përse është i rëndësishëm ai për rritje në këtë pjekuri?
3. Diskutoni për dhuntitë që ju ka dhënë Perëndia për shërbim.
    - Si po i përdorni rregullisht dhuntitë tuaja brenda trupit?
    - Si mund t'i vendosni në punë më me besnikëri dhuntitë që ju ka dhënë Krishti?
4. Si mund të mbani në ekuilibër përparësinë e të shërbyerit brenda shtëpisë dhe atë të të shërbyerit jashtë saj, në kishë? Çfarë e bën të vështirë ruajtjen e ekuilibrit të duhur?
5. Si mund të tundoheni që t'i krahasoni me gra të tjera dhuntitë apo aftësitë tuaja për shërbesë, bazuar te rrethanat apo te periudha aktuale e jetës suaj? Si mund të kultivoni një qëndrim kënaqësie, ndërkohë që luftoni për të qenë kujdestare besnike e gjërave që ju ka besuar Perëndia?

# Kapitulli 7

**TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE**

- **UDHËHEQJE E SHKËLQYER**

**TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE**

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Mateu:** Jezui si Mbret
  - **Marku:** Jezui si Shërbëtor
  - **Luka:** Jezui si Biri i Njeriut
  - **Gjoni:** Jezui si Biri i Perëndisë

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Soteriologji (Pjesa 1):** Studimi i Doktrinës së Shpëtimit
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Çfarë duhet të bëjë dikush për t'u shpëtuar? A është thelbësor pendimi për kthimin në besim?
    - Shpjegoni se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.

**TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE**

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Jo i Dhënë pas Përfitimeve të Pandershme dhe as pas Parasë

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Mësimi përmendësh i pjesëve nga Bibla

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## UDHËHEQJE E SHKËLQYER

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Për besimtarin, e gjithë jeta duhet jetuar si adhurim. Madje edhe detyrat më të rëndomta duhen bërë me dëshirën për të lavdëruar Perëndinë.

> **1 Korintasve 10:31**
> Edhe kur hani, edhe kur pini, edhe kur bëni ndonjë gjë tjetër, bëjeni për lavdi të Perëndisë.

> **Kolosianëve 3:17**
> Gjithçka që thoni e gjithçka që bëni, ta bëni në emër të Zotit Jezu, duke falënderuar nëpërmjet Tij Perëndinë Atë.

Kjo dëshirë, për të lavdëruar Perëndinë në gjithçka, ndikon si në motivimin për të punuar, ashtu edhe në mënyrën se si plotësohen detyra të caktuara. Besimtarët punojnë shumë, jo për të fituar shpëtimin, por për shkak se iu është dhuruar tashmë falas, me anë të hirit. Besimtarët bëjnë përpjekje për të shkëlqyer, jo për ta merituar favorin e Krishtit, por si një akt adhurimi ndaj Atij që meriton më të mirën.

Nxitja e Palit te Kolosianëve 3, drejtuar skllevërve të shekullit të parë në lidhje të punuarit në mënyrë të shkëlqyer, tingëllon e vërtetë edhe për çdo besimtar, sot.

> **Kolosianëve 3:23-24**
> Gjithçka që bëni, bëjeni me shpirt si ta bënit për Zotin e jo për njerëzit, sepse ju e dini se prej Zotit do të merrni si shpërblim trashëgimin e mbretërisë së Tij. Në të vërtetë ju i shërbeni Zotit Jezu Krisht.

Të krishterët duhet të punojnë kudo që janë sikur i shërbejnë Krishtit, sepse pikërisht këtë bëjnë ata.

> **Xhon Stot**
> Nevoja jonë e madhe është të vështrojmë qartë Jezu Krishtin dhe t'i japim përparësi Atij. Është e mundshme që një shtëpiake ta gatuajë ushqimin sikur të vinte vetë Jezu Krishti e të hante, apo të pastronte shtëpinë sikur Jezu Krishti të ishte i ftuari i nderit. Është e mundshme që edhe mësuesit t'i edukojnë fëmijët, që mjekët t'i trajtojnë pacientët dhe infermieret të kujdesen për ta, që juristët e avokatët t'i ndihmojnë klientët e tyre, punonjësit e supermarketeve t'u shërbejnë blerësve, ekonomistët të mbajnë llogaritë e sekretarët të mbajnë shënime sikur në secilin prej këtyre rasteve ata t'i shërbenin Jezu Krishtit.[85]

[85] J. R. W. Stott, *God's New Society: The Message of Ephesians* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1979), 252.

## TË UDHËHIQNI NË MËNYRË TË SHKËLQYER

Udhëheqësit e shërbesave duhet të kërkojnë që të plotësojnë rolin e tyre në mënyrë të shkëlqyer. Kjo nuk duhet bërë që ata të lavdërohen e të duartrokiten, por duhet bërë nga dëshira për të kënaqur Krishtin e për ta parë Atë të lavdëruar. Ne duhet të shërbejmë "...si kujdestarë të mirë... që Perëndia të përlëvdohet në gjithçka nëpërmjet Jezu Krishtit, të cilit i përket lavdia e pushteti, në shekuj të shekujve! Amen!" (1 Pjetrit 4:10-11)

Reagimi që dëshirojmë nuk duhet të jetë "sa punë të mirë që po bëni", por përkundrazi, "sa i mrekullueshëm është Perëndia të cilit po i shërbeni". Udhëheqësit biblikë dëshirojnë me zjarr që vëmendja të drejtohet te Krishti e jo tek ata. Prandaj edhe të udhëhequrit në mënyrë të shkëlqyer për hir të Krishtit bën pikërisht këtë gjë.

Ndonjëherë, të punuarit në mënyrë të shkëlqyer mund të mendohet si përsosmëri. Por ky nuk është standardi biblik për punën apo udhëheqjen tonë. Perëndia ka krijuar secilin prej nesh me dhunti, role dhe përgjegjësi të ndryshme. Të shkëlqesh në punë nuk do të thotë që t'i bësh të gjitha gjërat sa më mirë të jetë e mundur. Në fakt, të shkëlqesh ka kuptimin të punosh fort për të përmbushur me besnikëri dhe sa më mirë atë gjë për të cilën ju ka thirrur Perëndia për Lavdinë e Tij, me kohën dhe burimet e mundshme sipas përparësive dhe qëllimeve tuaja biblike. Dikush që punon gjithë ditën në oborrin e tij mund ta bëjë atë të duket shumë më bukur se oborri i dikujt tjetër që punon vetëm disa orë në të, por i pari mund të lërë pas dore përparësi dhe përgjegjësi të tjera biblike gjatë asaj pune.

- Përse është e pamundur që t'i bësh të gjitha gjërat "sa më mirë që të keni mundësi"? Si mund të ruajë dikush përkushtimin për të qenë i shkëlqyer, ndërkohë që balancon edhe përparësitë apo përgjegjësitë e tjera që i ka dhënë Perëndia?

Të udhëheqësh në mënyrë të shkëlqyer kërkon jo vetëm përkushtimin për t'i bërë gjërat mirë, por edhe urtësinë për të përcaktuar përparësitë, si edhe kohën dhe energjinë e duhur që meriton gjithsecila.

## TË PUNONI ME ZELL E ME DISIPLINË

Që t'i bësh gjërat mirë, kërkohet punë e madhe dhe disiplinë. Pali e kujtoi Timoteun që jeta e tij si udhëheqës duhej bërë me disiplinën dhe zellin e një ushtari, atleti dhe fermeri (2 Timoteut 2:3-6). Në udhëheqje nuk ka vend për përtaci.

- Lexoni Fjalët e Urta 6:6-11 dhe 26:13-16. Nga se karakterizohet personi i zellshëm në krahasim me përtacin ?

Përveç punës së papërtuar, udhëheqësit duhet të menaxhojnë mirë edhe kohën e tyre. Sikurse shkruan edhe J. Osvald Sendërs, "Problemi ynë nuk është që nuk kemi kohë, por që të përdorim sa më mirë kohën që kemi."[86] Kjo nuk do të thotë që të bëjmë një jetë pa pushim e të rrëmbyer, pasi Perëndia na ka krijuar me limite njerëzore dhe na urdhëron që të pushojmë e të çlodhemi për të marrë veten. Për këtë arsye, duhet t'i japim përparësinë e duhur përdorimit të kohës sonë, sipas planit që kishte Zoti ynë.

> **Kevin DeJang**
> [Jezui] ishte shumë i zënë, por asnjëherë deri në atë masë sa të ndihej i marrosur, i dërrmuar, i nervozuar, në ankth, krenar, ziliqar, apo i shpërqendruar nga gjëra më të vogla... Jezui e dallonte ndryshimin mes gjërave urgjente dhe atyre të rëndësishme. Ai e kuptoi se të gjitha gjërat e mira që mund t'i bënte nuk ishin domosdoshmërisht gjërat që duhej t'i bënte.[87]

Udhëheqësit që e menaxhojnë mirë kohën e tyre do të jenë të zënë dukë bërë gjërat e duhura, por do të ruhen nga rreziku i zvarritjes së gjërave. Dëshira për të bërë diçka të vështirë vetëm për faktin se është e vështirë ta heq gëzimin, duke të ngarkuar me barrën e një detyre të papërfunduar dhe priret të të shpërqendrojë nga kryerja e detyrave të tjera që mund të kesh në dorë.

Të jesh i zënë me gjërat e duhura nuk do të thotë që t'i marrësh si barrë apo si shqetësim ndërhyrjet që sjell Perëndia në jetën tonë. Në vend që të shkalafiten kundër providencës së Perëndisë, udhëheqësit e perëndishëm do të kërkojnë të ndërtojnë hapësira në jetën e tyre në mënyrë të tillë që të mund të përqafojnë ato mundësi që shpesh janë të paplanifikuara për shërbesë dhe që vijnë në mënyrë të papritur nga dora e Perëndisë. I tillë është shembulli i përsosur i Krishtit.

> **J. Osvald Sendërs**
> Sa interesante që regjistrimet e ungjillit nuk përmbajnë asnjë aludim në lidhje me ndonjë ndërhyrje që të mund ta ketë trazuar qetësinë e Birit të Perëndisë. Të pakta janë ato gjëra që mund të shkaktojnë më tepër tension në një jetë të ngarkuar sesa ndërhyrjet e papritura. Megjithatë, për Jezuin nuk pati gjëra të tilla. Ngjarjet "e papritura" ishin gjithmonë të parashikuara në planifikimin e Atit, prandaj edhe Jezui nuk u shpërqendrua kurrë prej tyre.[88]

- Si mund ta menaxhoni mirë kohën tuaj, duke lënë vend për ndërhyrje të paplanifikuara prej jush, të cilat padyshim që do të vijnë prej Perëndisë?

- Cilat janë disa nga pengesat e zakonshme për një jetë të zellshme e të disiplinuar? Si mund të ndesheni me pengesat dhe si mund t'i kultivoni këto karakteristika në jetën tuaj?

[86] Sanders, *Spiritual Leadership*, 96.
[87] Kevin DeYoung, *Crazy Busy* (Wheaton, IL: Crossway, 2013), 54–55.
[88] Sanders, *Spiritual Leadership*, 96–97.

## DALLIMI DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Të punosh në mënyrë të shkëlqyer do të thotë që udhëheqësit duhet të merren me dallimin dhe zgjidhjen e problemeve. Është ideale nëse udhëheqësit e dallojnë më parë një problem të mundshëm dhe punojnë për ta parandaluar atë. Disa herë, problemet vihen në dukje nga persona të tjerë. Shpesh kjo bëhet në formën e kritikës dhe jo gjithmonë ndërton. Mënyra se si reagon një udhëheqës ndaj kritikave të tilla tregon shumë për karakterin dhe mënyrën e tij të udhëheqjes.

- Cilat janë disa nga mënyrat e gabuara të reagimit ndaj kritikave? Si duhet të reagojë një udhëheqës ndaj kritikave drejtuar atij vetë, apo çështjeve për të cilat ai është përgjegjës për udhëheqje?

Te Veprat e Apostujve 6:1-6, apostujt japin një shembull të dobishëm për zgjidhjen e problemit. Para tyre u ngrit një ankesë në lidhje me disa të veja të cilat po anashkaloheshin gjatë shërbimit të përditshëm të ushqimit. Në vend që të reagonin duke mbrojtur veten, apo duke fajësuar të tjerë, apostujt punuan në mënyrë aktive për një zgjidhje që solli përfshirjen e të tjerëve dhe nuk i shpërqendroi ata nga përparësitë që u kishte dhënë Perëndia.

## PAJISJA DHE DELEGIMI TE TË TJERËT

Një nga çelësat për zgjidhjen e problemit, te Veprat e Apostujve 6 ishte delegimi i përgjegjësive te të tjerët. Shpeshherë, ngrihen disa çështje apo humbin disa mundësi potenciale për shkak se udhëheqësit kanë kufij. Një udhëheqës mund të mos jetë në gjendje të kushtojë kohën apo energjinë e nevojshme ndaj një çështjeje apo individi që ka nevojë për ndihmë, për shkak të volumit të përgjegjësive që ka mbi shpatulla. Ndoshta një udhëheqës mund ta humbasë apo ta lërë pas dore një mundësi të caktuar thjesht për faktin se është i mbytur deri në fyt.

Zgjidhja për këtë nuk është që ai të bëjë më tepër apo të punojë më shumë. Përkundrazi, ai duhet të kuptojë që një nga rolet më të vlefshme të udhëheqësit biblik është që të dallojë dhe të pajisë shërbëtorë të tjerë besnikë dhe më pas t'u delegojë atyre përgjegjësi të caktuara.

> **J. Osvald Sendërs**
> Një aspekt i udhëheqjes është aftësia për të dalluar aftësitë dhe kufizimet e veçanta të të tjerëve, e ndërthurur kjo me kapacitetin për të përshtatur secilin prej tyre në punën që ata mund ta bëjnë më mirë. Suksesi për t'i përfunduar gjërat me anë të të tjerëve është lloji më i lartë i udhëheqjes. Duait L. Mudi, njohës mendjemprehtë i njerëzve, tha dikur që e kishte më mirë të vinte në punë një mijë njerëz, sesa të bënte vetë punën e një mijë personave.[89]

- Lexoni nga Eksodi 18:13-26. Përse kishte kaq shumë rëndësi, si për Moisiun ashtu edhe për njerëzit, që ai ta delegonte udhëheqjen te njerëz të tjerë, që ishin besnikë?

[89] Sanders, *Spiritual Leadership*, 137.

- Përse mund të hezitojë një udhëheqës që të delegojë punën te persona të tjerë?

- Nga çfarë duhet të ketë kujdes një udhëheqës kur e delegon punën te të tjerët?

## RUAJTJA E STANDARTIT PËR TË QENË TË SHKËLQYER

Përveç ruajtjes së përkushtimit për të qenë vetë të shkëlqyer nga ana biblike, udhëheqësit e shërbesave duhet të ndihmojnë që edhe të tjerët të mund ta shohin e të rendin drejt këtij standardi. Edhe pse kjo mund të përfshijë vënien në dukje të fushave që kanë nevojë për përmirësim, sërisht nuk duhet bërë duke i kritikuar të tjerët kur ata dështojnë përpara këtij standardi. Përkundrazi, kjo përfshin ndihmën ndaj tyre për ta parë qartë Perëndinë si të denjë për gjithë nderin e lavdinë, në mënyrë që ata të motivohen për ta adhuruar Atë në çdo detaj të jetës e të shërbesës. Po ashtu kërkohet që udhëheqësit t'i ndihmojnë ata të kuptojnë se ç'do të thotë të jesh i shkëlqyer në ato fusha shërbimi ku ata kanë dhunti dhe t'i nxisin ata për të bërë më të mirën për lavdinë e Krishtit. Gjatë kohës, mund të duhet që udhëheqësit të drejtojnë dikë në një rol tjetër, të cilin mund ta luajnë më mirë në bazë të dhuntive të tyre apo të pjekurisë shpirtërore që kanë arritur.

- Cilat janë disa nga mënyrat e gabuara me të cilat një udhëheqës kërkon t'i motivojë të tjerët për të luajtur më mirë rolin e tyre?

- Cila janë disa nga mënyrat e duhura me të cilat ai kërkon të nxitë përmirësimin?

Nuk ka gëzim më të madh në udhëheqjen e kishës sesa të shohësh njerëzit e Perëndisë të shfaqin besnikëri në shërbimin e tyre ndaj Tij, pavarësisht nëse kjo nënkupton pastrimin e tualeteve, përgatitjen e ushqimit, përdorimin e një instrumenti muzikor, kujdesin për një foshnjë, apo mësimdhënien e Fjalës së Perëndisë.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Cilat janë pikat tuaja të forta përsa i përket udhëheqjes në mënyrë të shkëlqyer? Në ç'mënyre keni nevojë të rriteni për të siguruar një udhëheqje sa më të shkëlqyer (p.sh. vetë-disiplinë më e madhe, delegim i përgjegjësive, etj.)?
3. Bashke ndani e bisedoni në lidhje me punën dhe historinë e punës suaj. Si kërkoni ta nderoni Zotin në punën tuaj? Çfarë përvojash keni në punësimin tuaj, në lidhje me udhëheqjen?
4. Cilat janë disa nga sfidat që dalin përpara në ruajtjen e ekuilibrit mes kërkesave të punës, përparësive të tjera dhe përfshirjes në udhëheqjen e kishës? Si i trajtoni aktualisht, apo si do t'i trajtoni këto gjëra për të qenë i shkëlqyer në të gjitha fushat e jetës suaj?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik i kishës kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i perëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Aleksandër Strauç**
> Njohuria pa dashuri e fryn egon dhe e mashtron mendjen. Ajo mund të çojë në snobizëm intelektual, qëndrim tallës dhe përqeshjen e pikëpamjeve që kanë të tjerët, në një shpirt përbuzës ndaj atyre që kanë më pak njohuri dhe kokëfortësi ndaj njerëzve me të cilët nuk ju përputhen mendimet.[90]

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë nga secili libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

[90] Alexander Strauch, *Leading with Love* (Littleton, CO: Lewis and Roth, 2006), 11.

## MATEU

Meqë Mateu merret më shumë me paraqitjen e Jezuit si Mesia, Mbreti i Judenjve, atëherë përgjatë këtij ungjilli ai na zgjon interesin te premtimet e bëra në Dhiatën e Vjetër në lidhje me mbretërinë. Fraza simbolike e Mateut, "Mbretëria e Qiejve", shfaqet 32 herë në këtë libër (dhe askund tjetër në Shkrim). Gjenealogjia hyrëse është skicuar për të dokumentuar kredencialet e Krishtit si mbret të Izraelit, ndërsa pjesa tjetër e librit plotëson pikërisht këtë temë... Mateu e bën të qartë që Ai është plotësimi i dhjetëra profecive të Dhiatës së Vjetër në lidhje me mbretin që do të vinte. Ai po jep prova njëra pas tjetrës për të theksuar karakterin mbretëror të Krishtit. Të gjitha temat e tjera historike dhe teologjike të këtij libri vërtiten rreth kësaj ideje.[91]

### SKICIMI:

I. Prezantimi i Mbretit (1-10)
II. Kundërshtimi i Mbretit (11-28)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyç.

### TEMA: Jezui si Mbret

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 4 | Tundimi dhe prezantimi i shërbesës së Jezuit; thirrja e Pjetrit, Andreas, Jakobit dhe Gjonit. |
| 5-7 | Predikimi në Mal. |
| 10 | Të dymbëdhjetët dërgohen për të predikuar. |
| 13 | Shëmbëlltyra të mbretërisë: mbjellësi, gruri dhe egjra, fara e sinapit, brumi dhe majaja, etj. |
| 18 | Mjerë gurët pengues; disiplina e kishës; skllavi që nuk fal. |
| 23 | Shtatë mjerimet e 'Skribëve dhe Farisenjve'. |
| 24-25 | Fjalim në malin e ullinjve. |
| 28 | Porosia e Madhe. |

- Përse "Jezui si Mbret" është tema e duhur për librin e Mateut?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Mateut.
- Lexoni gjithë librin e Mateut.

[91] MacArthur, *The MacArthur Study Bible*, 1389.

## MARKU

Marku nuk ishte mes dymbëdhjetë apostujve, por ishte shoqërues shumë i ngushtë me apostullin Pjetër, ndaj pa dyshim ka përfituar shumë nga përvoja që pati Pjetri me Krishtin. Ungjilli i tij është shkruar kryesisht për paganët, veçanërisht romakët... Ai nxjerr në pah Jezuin si shërbëtor, prandaj nuk përmban gjenealogji, pasi kush interesohet për pemën familjare të një shërbëtori? Është ungjilli më i shkurtër e më i thjeshtë... Sigurisht që këtu portretizohet me autoritet shërbesa e mësimdhënies së Jezuit, megjithatë theksohen më shumë veprat e Krishtit sesa fjalët e Tij.[92]

**SKICIMI:**

I. I dërguar për të Shërbyer (1-10)
II. I dërguar për të Shpëtuar (11-16)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Jezui si Shërbëtor

- Përse "Jezui si shërbëtor" është tema e duhur për librin e Markut?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Markut.
- Lexoni gjithë librin e Markut.

[92] Chrispin, *The Bible Panorama*, 416.

## LUKA

Luka, jo-apostull pagan, shoqërohej dhe identifikohej shumë me apostullin Pal dhe nën ndikimin e Frymës së Shenjtë të Perëndisë, shkroi kryesisht për paganët e tjerë. Për këtë, ai koordinoi dhe renditi raporte të besueshme në shkrimin e librit të tij. Ungjilli i tij është në harmoni të përsosur me ungjijtë e tjerë, megjithatë është një varietet autentik. Ungjilli i tretë e portretizon Jezuin si një burrë, duke ndjekur kështu gjenealogjinë e tij deri te burri i parë (Adami) përmes linjës së Marisë. Fraza kyçe është "Biri i Njeriut". Këtu nënvizohet humaniteti i Jezuit përmes përfshirjes në ungjill të dhjetë lutjeve të Tij. Megjithatë, Jezui është plotësisht njeri dhe plotësisht Perëndi, dhe hyjnia e Tij rrezaton prej këtij ungjilli ashtu si edhe prej tre ungjijve të tjerë.[93]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Lindja e Birit të Njeriut | (1-3) |
| II. | Shërbesa e Birit të Njeriut | (4-19) |
| III. | Kryqëzimi dhe Ringjallja e Birit të Njeriut | (20-24) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe kapitullin kyç.

**TEMA:** Jezui si Biri i Njeriut

### KAPITUJT KYÇË:

2 Lindja e Krishtit

- Përse "Jezui si Biri i Njeriut" është tema e duhur për librin e Lukës?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Lukës.
- Lexoni gjithë librin e Lukës.

[93] Chrispin, *The Bible Panorama*, 445.

## GJONI

Gjoni është shkruar pjesërisht si plotësim i ungjijve sinoptikë të Mateut, Markut dhe Lukës, por kryesisht për të treguar që Zoti Jezu Krisht është Biri i përjetshëm i Perëndisë dhe, në të njëjtën kohë, Perëndia Bir. Meqë është Perëndi, nuk ka gjenealogji. Ai ka ekzistuar gjithnjë, ekziston dhe do të ekzistojë përjetë. Kështu, Gjoni thekson përjetësinë e Zotit Jezu Krisht, mishërimin, shenjtërinë si edhe të qenët Krijues. Ai është Perëndi, pavarësisht përbuzjes dhe refuzimit të disa prej njerëzve të cilët Ai erdhi t'i shpëtojë. Në mrekullitë e Tij janë dhënë shenja për të ndihmuar vëzhguesit e përulur të shohin se kush është Jezui. Aty portretizohet qartë shpëtimi me anë të besimit në Të. Gjoni është shkruar për "cilindo", në çdo brez e në çdo komb, prej çdo prejardhjeje etnike apo fetare.[94]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Shërbesa Publike e Jezuit | (1:12) |
| II. | Shërbesa Private e Jezuit | (13-17) |
| III. | Pasioni dhe Ringjallja e Jezuit | (18-21) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Jezui si Biri i Perëndisë

### KAPITUJT KYÇË:

2 Dasma në Kanë (shenja e parë); pastrimi i tempullit
3 Nikodemi; dëshmia e Gjon Pagëzorit
4 Gruaja samaritane
10 Bariu i Mirë; debat mbi shenjtërinë e Tij
13 Darka e Fundit/larja e këmbëve; tradhtia e Judës; parashikohet mohimi i Pjetrit
14 Pyetje-përgjigje: Ai është "Udha" (14:6); "në Atin" (14:9); dërgimi i Frymës së Shenjtë (14:26)
15 Marrëdhëniet: Perëndia – hardhi/degë; besimtarët – "duajeni njëri-tjetrin"; bota – "ju urren"
16 Zbulesa e gjërave që do të vijnë: refuzime; Fryma e Shenjtë; ringjallja; Ati
17 Lutje Kryepriftërore
21 Jezui iu shfaqet dishepujve në Galile

- Përse "Jezui si Biri i Perëndisë" është tema e duhur për librin e Gjonit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Gjonit.
- Lexoni gjithë librin e Gjonit.

[94] Chrispin, *The Bible Panorama*, 426.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e ungjillit të Mateut?
    - Cila është tema e ungjillit të Markut?
    - Çfarë jepet te Gjoni 17?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Malakia.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – SOTERIOLOGJI (PJESA 1)

> **Titit 3:5**
> Ai na shpëtoi, jo për shkak të ndonjë vepre drejtësie që bëmë ne, por për shkak të mëshirës së Tij, përmes larjes së rilindjes e përtëritjes që Shpirti i Shenjtë kryen në ne.

**Soteriologjia** është studimi i doktrinës së shpëtimit.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në soteriologji janë:

- Ungjilli
- Shpengimi
  - Plani i Perëndisë për Shpengim
  - Shpengimi Realizohet
  - Shpengimi Zbatohet

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e shpëtimit.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat e keqkuptimit apo të neglizhimit të këtyre të vërtetave?

  - Çfarë pyetjesh keni mbi të vërtetat që deklarohen aty?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Filloni të lexoni kapitujt rreth soteriologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

### ÇFARË DUHET TË BËJË DIKUSH QË TË SHPËTOHET? A ËSHTË THELBËSOR PENDIMI PËR KTHIMIN NË BESIM?

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Marku 1:15
  - Romakëve 10:9-10

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Mejhju në *Doktrina Biblike***
> Të dyja bashkë, pendimi dhe besimi, përbëjnë aktin e vetëm të kthimit në besim. Duhet të jetë e dukshme që pendimi dhe besimi janë të lidhura ngushtë dhe madje të pandashme nga njëra-tjetra. Ato janë vërtet si dy anët e një monedhe. Së pari, lidhja e tyre ndjek një logjikë të thjeshtë: është e pamundur që dikush t'i kthejë shpinën diçkaje pa u kthyer drejt diçkaje tjetër. Po kështu, një person nuk mundet ta kthejë vëmendjen drejt diçkaje pa e larguar atë nga çfarëdolloj gjëje në të cilën ishte i përqendruar më përpara. Për më tepër, është e pamundur që të shohësh në dy drejtime të ndryshme në të njëjtën kohë. Por, pandashmëria e pendimit dhe besimit është edhe një domosdoshmëri teologjike. Është e papërfytyrueshme që personi që e koncepton mëkatin dhe Krishtin ashtu si janë vërtet, të mund ta ndjekë Krishtin pa e lënë pas mëkatin, apo që të braktisë mëkatin pa e përqafuar Krishtin…
>
> Për këtë arsye, thirrja e ungjillit për shpëtim është një kërkesë e dyfishtë, si për pendim ashtu edhe për besim. Sipas Markut, përmbajtja e "ungjillit të Perëndisë" që shpalli Jezu Krishti mund të përmblidhet me këto fjalë: "Ka ardhur koha dhe mbretëria e Perëndisë është te dera; pendohuni dhe besoni te ungjilli" (Marku 1:15). Në kthimin e vërtetë në besim, ka gjithnjë një largim nga mëkati (pendim) dhe njëkohësisht edhe kthim te Perëndia në Krishtin (besim). Është e pamundur që njëra prej tyre të shfaqet pa tjetrën.[95]

- Përgjigjuni me fjalët tuaja pyetjeve: "Çfarë duhet të bëjë dikush që të shpëtohet? A është thelbësor pendimi për kthimin në besim?"

[95] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 590–91.

**SHPJEGONI SE SI E KUPTONI VDEKJEN ZËVENDËSUESE TË KRISHTIT.**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Marku 10:45
  - Romakëve 3:21-26
  - 2 Korintasve 5:21

> **Pol Enns në *Manuali Moody mbi Teologjinë***
> Vdekja e Krishtit ishte zëvendësuese – Ai vdiq në vend të mëkatarëve dhe zuri vendin e tyre. Kjo përshkruhet edhe nga fjala latine vicarius që ka kuptimin "një njeri në vend të një tjetri". Vdekja e Krishtit është e tillë në kuptimin që Ai është Zëvendësuesi që ndëshkohet me dënimin që meritojnë mëkatarët, duke marrë përsipër fajin e tyre në mënyrë që të merrte edhe ndëshkimin që meritonin ata". Ka shumë pasazhe që theksojnë shlyerjen zëvendësuese të Krishtit në vend të njerëzimit. Krishti ishte zëvendësues duke u bërë mëkat për të tjerët (2 Kor. 5:21); Ai mori mëkatet e të tjerëve në trupin e Tij mbi kryq (1 Pjetrit 2:24); Ai vuajti një herë për të mbartur mëkatet e të tjerëve (Heb. 9:28); Ai përjetoi vuajtje të tmerrshme, u fshikullua dhe vdiq në vend të mëkatarëve (Isa. 53:4-6).[96]

- Shpjegoni me fjalët tuaja se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e shpëtimit dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:
   - Çfarë duhet të bëjë dikush që të shpëtohet? A është i rëndësishëm pendimi për kthimin në besim?
   - Shpjegoni se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
   - Si do ta përshkruanit pagabueshmërinë e Shkrimit?
   - Si do ta përkufizonit Trininë?
   - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
   - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
   - Cilat janë qëllimet e kishës?
   - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?

[96] Paul Enns, *The Moody Handbook of Theology*, J. Vincent & A. Sholes, eds.; Revised and Expanded (Chicago, IL: Moody, 2014), 335–37.

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Xhon MekArthër**
> Sipas Shkrimit, pothuajse gjithçka që e kualifikon vërtet dikë për udhëheqje lidhet drejtpërdrejt me karakterin e tij. Nuk ka të bëjë me stilin, statusin, karizmën (aftësinë) personale, fuqinë, pushtetin apo suksesin sipas botës. Integriteti është çështja kryesore që bën dallimin mes udhëheqësit të mirë dhe atij të keq.[97]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Jo i dhënë pas përfitimeve të pandershme dhe jo lakmitar parash**

  **1 Timoteut 3:2-3** Peshkopi duhet të jetë i patëmetë... jo lakmitar parash.

  **Titit 1:7** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... as lakmitar përfitimesh të pandershme.

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni 1 Timoteut 6:10. Çfarë mëkatesh rrjedhin nga lakmia për para? Përse është lakmia për para një çështje serioze në jetën e besimtarit?

[97] John MacArthur, *Grace to You Newsletter*, Oct. 15, 2004.

- Lexoni Hebrenjve 13:5. Si mund të kultivoni të kënaqurit me aq sa keni?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si mund të tundohet një udhëheqës kishe për ta përdorur autoritetin apo pozitën e tij për përfitim të pandershëm?
3. Si mund të krijojnë mbrojtje ndaj këtij tundimi udhëheqësit individualë apo edhe e gjithë kisha bashkërisht?
4. Në vend të përfitimeve financiare, nga se duhet të motivohen udhëheqësit e kishës?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## MËSIM PËRMENDËSH NGA BIBLA

> **Psalmi 119:11**
> Thëniet e Tua i mbaj fshehur në zemër, që të mos mëkatoj kundër Teje.

> **Xherri Brixhis**
> Fjala e Perëndisë duhet të fiksohet kaq fort në mendjen tonë, saqë të mund të japë ndikimin dominues në mendimet, qëndrimet, dhe veprimet tona. Një nga mënyrat më efektive të ndikimit në mendjen tonë është mësimi përmendësh nga Shkrimi.[98]

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të mësimit përmendësh nga Bibla.

- Përse ka rëndësi mësimi i rregullt përmendësh nga Bibla, për rritjen dhe pjekurinë tuaj shpirtërore?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Çfarë përfitimesh shpirtërore keni vënë re në jetën tuaj, apo në jetën e personave që ju kanë ndihmuar në besim, nga mësimi përmendësh i Fjalës së Perëndisë?
3. Cilat këshilla apo ndihma praktike kanë qenë të dobishme për ju në mësimin përmendësh nga Shkrimi?

[98] Jerry Bridges, *The Pursuit of Holiness* (Colorado Springs, CO: NavPress, 1996), 86.

# Kapitulli 8

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE: T'I NDIHMOJMË NJERËZIT TË NDRYSHOJNË**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Veprat e Apostujve:** Lindja dhe Rritja e Kishës
  - **Romakëve:** Ungjilli i Perëndisë
  - **1 Korintasve:** Korrigjim dhe Dënim
  - **2 Korintasve:** Mbrojtje e Apostullimit
  - **Galatasve:** Shfajësimi Vetëm Përmes Besimit
  - **Efesianëve:** Plani i Përjetshëm i Perëndisë

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Soteriologji (Pjesa 2):** Studimi i Doktrinës së Shpëtimit
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Përkufizojmë doktrinën e zgjedhjes
    - Përkufizojmë doktrinën e ripërtëritjes.
    - Përkufizojmë doktrinën e shfajësimit.
    - Përkufizojmë doktrinën e shenjtërimit.
    - Përcaktojmë doktrinën e lavdërimit.
    - Përkufizojmë doktrinën e sigurisë së përjetshme.

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Jo i Dhënë pas Verës, por i Arsyeshëm, me Vetëkontroll, i Përmbajtur dhe i Matur.
- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Meditim nga Bibla

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE:
## T'I NDIHMOJMË NJERËZIT TË NDRYSHOJNË

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Udhëheqësit biblikë të kishës duhet të përkushtohen personalisht që t'i ndihmojnë të tjerët të rriten në ngjashmërinë me Krishtin dhe duhet ta pajisin gjithë kishën për të rendur bashkërisht drejt një pjekurie të tillë shpirtërore (Efesianëve 4:11-13).

> **Kolosianëve 1:28**
> Këtë Krisht predikojmë edhe ne, duke këshilluar e duke mësuar çdo njeri me gjithë urtinë që kemi, me qëllim që të gjithë njerëzit t'i paraqesim të përsosur përmes Krishtit para Perëndisë.

Rritja drejt pjekurisë shpirtërore kërkon një ndryshim rrënjësor të dëshirave, qëndrimeve dhe sjelljes së çdo besimtari. Duhet ta jetojmë "atë që ka mbetur nga jeta në trup jo sipas kënaqësive njerëzore, por sipas vullnetit të Perëndisë" (1 Pjetrit 4:2). Nëse dëshirojmë të ndryshojmë dhe t'i ndihmojmë edhe të tjerët të ndryshojnë, atëherë duhet që të kuptojmë fillimisht se çfarë mëson Shkrimi për mënyrën se si ndryshojmë.

### THEMELI PËR NDRYSHIMIN BIBLIK: RIPËRTËRITJA

Kolosianëve 3 jep një nga përshkrimet më të plota të ndryshimit që duhet të karakterizojë besimtarët. Vargjet 5-9 japin një seri dëshirash dhe veprimesh mëkatare të cilat duhen hedhur tej (zhveshur); vargjet 12-17 japin dëshira dhe veprime të drejta përkatëse të cilat duhen veshur. Por vini re se si nis kapitulli.

> **Kolosianëve 3:1**
> Përderisa u ngjallët bashkë me Krishtin...

Ndryshimi që përshkruhet te Kolosianëve 3 është i mundshëm vetëm nëse dikush është ngjallur bashkë me Krishtin. Themeli i ndryshimit biblik është jeta e re në Të përmes ungjillit. Përpara shpëtimit, njeriu është i vdekur në mëkatet e tij (Efesianëve 2:1) dhe skllav i mëkatit (Romakëve 6:16-18). Por kur dikush ripërtërihet dhe reagon ndaj ungjillit me pendim e besim, ai nuk është më si dikur. Ndryshimi i vërtetë e i vazhdueshëm është diçka që mund të ndodhë dhe pritet të ndodhë. Sado që të dëshirojë të fluturojë, vemja e ka të pamundur. Por pasi bëhet flutur, asaj i mundësohet një mënyrë tërësisht e re jete. Një transformim i tillë jete është i vërtetë edhe për besimtarin.

> **2 Korintasve 5:17**
> Kështu, kush bashkohet me Krishtin, bëhet një krijesë e re. Gjërat e vjetra shkuan dhe, ja, u bënë të reja.

> **Galatasve 2:20**
> Jam kryqëzuar me Krishtin e nuk jetoj më unë, por Krishti jeton në mua. Këtë jetë, që tani jetoj në trup njerëzor, e jetoj me besim në Birin e Perëndisë, i cili më deshi e dha veten për mua.

Për këtë arsye, besimtarët që kërkojnë t'i ndihmojnë të tjerët për ndryshim duhet t'ia nisin me ungjillin dhe me jetën e re që sjell ai pasi të kuptohet e të përqafohet. Kjo është një nga arsyet se përse Pali i nis letrat, si ajo drejtuar Kolosianëve, me theksin tek ungjilli dhe puna e tij transformuese (p.sh. Kolosianëve 1:3-6, 1:21-23, 2:9-14).

- Përse është e nevojshme që të kërkoni të dalloni nëse dikush e kupton dhe reagon ndaj ungjillit, përpara se të kërkoni ta ndihmoni atë person me çështje të veçanta të jetës së tij?

## PROCESI I NDRYSHIMIT BIBLIK: SHENJTËRIMI

Perëndia premton që do ta çojë deri në fund punën që Ai fillon me ripërtëritjen duke i çuar të Tijtë në lavdi (Romakëve 8:29-30, Filipianëve 1:6), deri në konformitet të plotë me Krishtin. Ndërkohë që kjo do të realizohet përfundimisht kur ne ta shohim Jezuin ballë për ballë (1 Gjonit 3:2), Perëndia vazhdon të punojë duke i bërë fëmijët e Tij më të ngjashëm me Krishtin. Këtë proces, Bibla e quan shenjtërim.

Mjeti i parë për shenjtërim është Fjala e Perëndisë. Ashtu siç u lut edhe Jezui, "Shenjtëroji me të vërtetën; Fjala Jote është e vërteta" (Gjoni 17:17). Ndërkohë që shohim Krishtin përmes Fjalës së Tij – duke e lexuar atë, duke e studiuar, mësuar përmendësh, medituar ndaj saj, apo edhe duke e dëgjuar të predikuar – Fryma na transformon në imazhin e Tij (2 Korintasve 3:18).
Megjithatë, ky nuk është një proces pasiv. Besimtarët duhet të "punojnë" për shpëtimin me frikë e me dridhje, se është vetë Perëndia Ai që jep vullnetin e forcën për të vepruar, ashtu siç i pëlqen Atij (Filipianëve 2:12-13).

Të punuarit për shpëtimin ka nevojë për një riorientim të përgjithshëm të jetës sonë përreth Krishtit dhe Fjalës së Tij.

> **Kolosianëve 3:1-2**
> Përderisa u ngjallët bashkë me Krishtin, kërkoni gjërat që janë lart në qiej, atje ku Ai rri ulur në të djathtën e Perëndisë. Mendoni për gjërat që janë lart në qiej dhe jo për ato që janë këtu poshtë në tokë.

Të punuarit për shpëtimin përfshin gjithashtu edhe punën drejt ndryshimeve specifike në qëndrimet dhe në sjelljen tonë. Xhoel Xheims e përmbledh qartë këtë proçes biblik të ndryshimit në burimin e tij të dobishëm.

> **Xhoel Xheims në *Këshilloni me Mirëbesim***
> Plani i Perëndisë për ndryshim të përditshëm praktik është: **zhvishni** / **ripërtërihuni** / **vishni** (Efes. 4:22-24; Kol. 3:8-14). Plani përfshin komponentët e mëposhtëm:
>
> ***Zhvishni:***
> • Përdorimi i Biblës për të dalluar mëkatin (Ps. 19:10-11; 119:9).

- Pranimi i përgjegjësisë personale për atë mëkat dhe kërkimi i faljes për të (Jakobi 1:14; 1 Gjonit 1:9).
- Të dëshironi e të jeni të gatshëm për ndryshim (Ps. 119:10, 30-32).
- Me anë të hirit të Perëndisë, të ndaloni së bëri atë mëkat (1 Pjetrit 4:1-3).
- Ta organizoni jetën në mënyrë të tillë që ta keni të vështirë ta bëni përsëri atë mëkat (Rom. 13:14).

***Ripërtërihuni në mendjen tuaj:***

- Ndiqni një riorientim të plotë biblik për të menduarit tuaj, duke studiuar Fjalën e Perëndisë (LiP. 5:29; Ps. 95:10; Fja. 4:23; Rom. 12:1-2).

***Vishni:***

- Zëvendësojini mendimet, fjalët dhe veprimet mëkatare me të kundërtat e perëndishme të tyre (Rom. 12:21; Ef. 4:25-32; Kol. 3:10-17).[99]

Shpesh, besimtarët dëshirojnë të zhveshin mëkatin dhe të veshin drejtësinë, por dështojnë të vlerësojnë aq sa duhet çështjet e rrënjosura thellë në zemrën dhe në mendjen e tyre. Pa këtë ripërtëritje të brendshme, ndryshimi do të jetë thjesht i përkohshëm apo sipërfaqësor, pasi bazohet kryesisht në nivelin e vetëkontrollit të personit dhe jo në ndryshimin e vazhdueshëm të zemrës.

Zgjidhni një fushë mëkati në të cilën duhet të punoni. Plotësoni tabelën e mëposhtme si një ndihmë për të punuar përmes këtij ndryshimi në jetën dhe zemrën tuaj, duke përdorur si model shembullin e dhënë.

| ***Zhvishni*** | ***Ripërtërini mendjen/zemrën*** | | ***Vishni*** |
|---|---|---|---|
| Qëndrime dhe veprime mekatare | Mendime dhe dëshira të gabuara | Mendime dhe dëshira të (të vërteta biblike dhe pjesë nga shkrimi) | Qëndrime dhe veprime në ngjashmëri me Krishtin |
| • *Gënjeshtra (ekzagjerim i arritjeve të mia kur flas me kolegë apo bashkëpunëtorë)* | • *Duhet t'i bëj të tjerët të mendojnë mirë për mua.*<br>• *Do të bëj çfarëdo që nevojitet për t'u ngritur në detyrë.* | • *Është më e rëndësishme*<br>• *të kënaqësh Perëndinë, sesa njerëzit.*<br>• *Perëndia nuk gënjen kurrë (Num. 23:19)*<br>• *Lev. 19:11; Ef. 4:25* | • *Fol të vërtetën*<br>• *(të tregoj kujdes për të treguar drejt kontributet e mia).* |

[99] Joel James, *Counsel with Confidence* (Wapwallopen, PA: Shepherd, 2018), 22–23.

Meditimi mbi të vërtetën e Fjalës së Perëndisë është një nga mënyrat më të rëndësishme për të ripërtërirë zemrën dhe mendjen, në mënyrë që të shohim ndryshim të vazhdueshëm në jetën tonë. Shpesh, besimtarët e shohin përciptazi të vërtetën dhe vazhdojnë punën e tyre. Por që të jeni bërës i Fjalës kërkohet "të shikoni me kujdes ligjin e përsosur..." (Jakobi 1:22-25). Një përsiatje e tillë plot kujdes të çon në bindje (Jozuehu 1:8).

## LEHTËSIMI I NDRYSHIMIT BIBLIK: DISHEPULLIMI

E vërteta biblike është mjeti kryesor për ndryshim dhe kjo e vërtetë shpesh pasohet nga një person te tjetri përmes një marrëdhënieje dishepullizuese. Ndërkohë që e vërteta e Perëndisë nuk ndryshon, besnikëria jonë në marrëdhënien me personin që kërkojmë të ndihmojmë do të rritet ose do të shpërqëndrohet nga ajo e vërtetë që dëgjohet.

- Si ju ndihmojnë vargjet e mëposhtme për të kuptuar rëndësinë e marrëdhënieve në komunikimin e të vërtetës biblike?

  - Fjalët e Urta 27:6, 9

  - Veprat e Apostujve 20:18-21, 31

  - 1 Selanikasve 2:7-12

Përveç themelimit të marrëdhënies me personat që kërkojnë t'i ndihmojmë, udhëheqësit biblikë kujdesen që të punojnë për të kuptuar çështjet e përfshira si edhe gjëndjen e personit përpara se të kërkojnë zgjidhjen e situatave në mënyrë biblike (Fjalët e Urta 18:2, 13; 1 Selanikasve 5:14). Ashtu si doktori që duhet të diagnostikojë saktë pacientin për ta trajtuar atë si duhet, po kështu edhe besimtarët duhet të punojnë për t'i kuptuar drejt të tjerët përpara se t'i ndihmojnë e t'i këshillojnë ata. Qëllimi nuk është të thoni gjëra që janë biblikisht të vërteta, por të thoni atë që është e duhur dhe më e përshtatshme (Fjalët e Urta 15:23).

Xheremi Pierr dhe Dipak Rixhu japin një përmbledhje se si t'i ndihmoni të tjerët të ndryshojnë në këtë mënyrë, duke kaluar "nga dëgjimi në përgatitjen për të folur.

- *Dëgjoni problemin* – për të kuptuar kontekstin e jetës dhe telasheve të personit në fjalë (Fja. 18:2, 13; Jakobi 1:19).
- *Merrni parasysh reagimet e zemrës* – si po reagon zemra e personit ndaj Perëndisë, ndaj vetvetes, ndaj të tjerëve dhe ndaj rrethanave (Fja. 20:5).
- *Flisni të vërtetën me dashuri* – me qëllim që t'i jepni mësim, ngushëllim, paralajmërim, inkurajim, këshillim dhe qortim në mënyrën e duhur (2 Korintasve 1; Kol. 3:16; 1 Sel. 5:14)."[100]

[100] Jeremy Pierre and Deepak Reju, *The Pastor and Counseling* (Wheaton, IL: Crossway, 2015), 48–49.

- Cilat janë parimet kyçe biblike për të ndihmuar besnikërisht dikë që të ndryshojë?

- Si mund t'i ndihmoni të tjerët që të kuptojnë dhe të punojnë përmes procesit biblik të ndryshimit në jetën e tyre?

## KËMBËNGULJA PËR NDRYSHIMIN BIBLIK TË TË TJERËVE: DISIPLINA E KISHËS

Ka raste kur ndonjë i ashtuquajtur besimtar në kishë të mos shfaqë fare dëshirën për ndryshim në një fushë të caktuar të jetës ku duket qartë që po mëkaton. Në raste të tilla, pjesa tjetër e trupit nuk mund të stepet dhe ta lejojë atë të vazhdojë drejt modelit të qartë të rebelimit zemërgur.

Nisur nga dashuria dhe meraku për këtë person, nga dëshira për të ruajtur pastërtinë dhe dëshminë e kishës, si edhe kryesisht nga përkushtimi për të lavdëruar Krishtin, ata që e njohin atë person, por dhe pjesa tjetër e trupit duhet të tregohen këmbëngulës për të ndjekur udhëzimet e Krishtit në lidhje me disiplinën e kishës. Kjo është një ide e keqkuptuar dhe shumë dashakeqe në kishën e sotme dhe shpesh shihet si diçka vulgare, e rëndë dhe e prapambetur. Por një kuptim i duhur biblik tregon se në të vërtetë ajo buron nga një zemër plot dashuri për personin në fjalë dhe për Krishtin. Nuk mund të bëjmë asgjë tjetër për t'u kujdesur besnikërisht ndaj besimtarit rebel veçse të ndjekim hapat që thekson Zoti ynë.

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Mejhju në *Doktrina Biblike***
> Duke menduar që fjala disiplinë ka një domethënie negative, praktikimi i disiplinës së kishës duhet të motivohet nga një dëshirë pozitive plot dashuri si për të ruajtur pastërtinë e kishës (2 Kor. 7:1; krah. Vap. 5:11; 1 Kor. 5:1-13; 2 Sel. 3:6-15; 1 Tim. 1:19-20; Titit 1:10-16), ashtu edhe për të rikthyer në bashkësi vëllezërit apo motrat që mëkatojnë (krah. Luka 15:3-8; Juda 1:23). Disiplina e kishës nuk duhet të motivohet kurrë nga krenaria e vete drejtësisë, nga programet politike, nga dëshira për të ushtruar pushtet në mënyrë jo biblike, apo nga qëllime për të turpëruar njerëzit. Përkundrazi, ajo duhet mbikëqyrur nga pleqtë, të cilët si barinj të grigjës, dëshirojnë me çiltërsi që t'i shohin delet endacake të pendohen, të kthehen dhe të ripërtërihen. (krah. Gal. 6:1).[101]

Disiplina e kishës është ballafaqimi i qëllimshëm gjithnjë e në rritje i mëkatit të hapur e të pashpirt brenda kishës – gjithmonë e kryer me durim e me dëshirën për ta parë vëllain apo motrën që mëkaton të rikthehet në miqësi me Zotin dhe me të tjerët, e jo nga dëshira për të ndëshkuar apo për të turpëruar. **Hapi i parë** i këtij procesi është kur dikush sheh një mëkat të tillë te një tjetër dhe shkon tek ai personalisht për ta përballur me atë mëkat.

> **Mateu 18:15**
> Nëse vëllai yt mëkaton kundër teje, shko e qortoje vetëm për vetëm. Po të dëgjoi, e ke fituar vëllain tënd.

[101] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 793.

> **Galatasve 6:1**
> Vëllezër, nëse ndokush kapet në faj, ju që keni Shpirtin e Shenjtë ndreqeni atë me shpirtbutësi, po rruhuni se mos tundoheni edhe ju vetë.

Nëse nuk ka pendim, persona të tjerë, shpesh udhëheqja e kishës, sillen në ballafaqim si një **hap i dytë** për të konfirmuar realitetin e një mëkati të tillë dhe të kërkojnë të ofrojnë më shumë qartësi biblike duke pasur si synim pendimin dhe pajtimin. Sërish, çështja duhet trajtuar në mënyrë sa më private që të jetë e mundur, nisur nga konsiderata për atë person dhe nga bindja ndaj Krishtit.

> **Mateu 18:16**
> "Por, nëse nuk të dëgjon, merr edhe një ose dy të tjerë me vete, QË ÇDO FJALË TË MUND TË MBËSHTETET ME DËSHMINË E DY OSE TRE DËSHMITARËVE".

Nëse nuk ka pendim akoma, si **hap i tretë** duhet që kisha të vihet në dijeni për situatën, në mënyrë që i gjithë trupi të mund të lutet e të këmbëngulë për personin apo personat në fjalë, duke i nxitur për pendim. Nëse ata nuk e dëgjojnë as kishën, atëherë, si **hap i katërt**, ata duhen trajtuar si jobesimtarë dhe jo si pjesë e kishës, pasi rebelimi i tyre i dukshëm dhe i vazhdueshëm kundër Krishtit e vë në pikëpyetje besimin e tyre në Krishtin e për pasojë edhe anëtarësinë e tyre në kishë.

> **Mateu 18:17**
> "Nëse nuk pranon t'i dëgjojë, tregoja kishës dhe, po nuk pranoi të dëgjojë as kishën, le të jetë për ty si një prej kombeve apo si një tagrambledhës".

Ta konsiderosh dikë si jobesimtar nuk do të thotë që kisha duhet të sillet keq me të apo ta shmangë atë. Kjo do të thotë që persona të tillë duhen parë si nevojtarë për ungjillin e jo si persona me të cilët mund të shijosh miqësi.

- Përse ndodh që shumë kisha refuzojnë të praktikojnë disiplinën e kishës? Cilat janë pasojat që vijnë kur lihet pas dore ky proces, si urdhërim prej Krishtit?

Edhe personat në udhëheqje duhet të japin llogari për mëkatet e tyre, me gjithë kujdesin që duhet treguar për të ndjekur udhëzimet e dhëna te 1 Timoteut 5.

> **1 Timoteut 5:19-20**
> Kundër plakut të kishës mos prano padi, veçse kur ka dy ose tre dëshmitarë. Ata që mëkatojnë, qortoji para të gjithëve, që të kenë frikë edhe të tjerët.

- Si e motivon disiplina e kishës gjithë trupin që t'i bindet me kujdes Krishtit?

Megjithëse asnjë besimtar nuk kënaqet nga mendimi për të ballafaquar të tjerët me mëkatin, sërish, të gjithë besimtarët, veçanërisht ata që janë në udhëheqje, duhet të jenë të gatshëm të përqafojnë urtësinë e Krishtit në këtë fushë. Çdo besimtar duhet të ballafaqojë me dashamirësi mëkatin e dukshëm te të tjerët sikurse edhe të pranojë vetë një ballafaqim të tillë nga të tjerët, pasi kjo është thelbësore në ecjen bashkërisht e me këmbëngulje për t'u bërë të ngjashëm me Krishtin.

> **D. A. Karson**
> Udhëheqësit e krishterë të mos guxojnë ta anashkalojnë përgjegjësinë e tyre për t'i udhëhequr njerëzit e Perëndisë drejt një jete që është sipas ungjillit... dhe nëse njerëzit e Perëndisë ngulin këmbë në mosbindje, atëherë mund të vijë koha që udhëheqësit e krishterë të paralajmërojnë, të qortojnë dhe si përfundim të disiplinojnë me vendosmëri ata që marrin emrin e Krishtit por janë moskokëçarës për ta ndjekur Atë. Hapat e rëndë nuk duhen marrë kurrë me nxitim apo me lehtësi. Megjithatë disa herë ata duhen bërë. Kjo është pjesë e përgjegjësisë së udhëheqjes së krishterë.[102]

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si ju ka ndihmuar ky kapitull për t'u pajisur më shumë:
    - për të punuar drejt ndryshimit në jetën tuaj personale?
    - për t'i ndihmuar të tjerët të ndryshojnë?
3. Si mund të rriteni për të qenë më besnik e më i aftë në ndihmën që u jepni të tjerëve për ndryshim?
4. Përse është i nevojshëm përkushtimi në ushtrimin e disiplinës së kishës në kohën e duhur biblike, me qëllim që trupi të përparojë drejt rritjes e pjekurisë? Çfarë pyetjesh keni në lidhje me praktikën e disiplinës së kishës në kishën tuaj lokale?

[102] D. A. Carson, *The Cross and Christian Ministry* (Grand Rapids, MI: Baker, 1993), 129.

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik i kishës kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i perëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **2 Pjetrit 1:2-3**
> Hiri e paqja u shtofshin mbi ju me njohjen e Perëndisë e të Zotit tonë Jezu! Fuqia e Tij hyjnore na dhuroi gjithçka që na nevojitet për jetën e përkushtuar ndaj Perëndisë, nëpërmjet njohjes së Atij që na thirri në lavdinë dhe fuqinë e Tij.

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë nga secili libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## VEPRAT E APOSTUJVE

Luka e nis librin e Veprave të Apostujve aty ku e la ungjillin e tij. Veprat e Apostujve japin fillimin e plotësimit të Urdhërimit të Madh të Mateut 28:19-20, ndërsa ndjekin nisjen dhe zgjerimin e kishës së Dhiatës së Re. Fjalët e fundit të Krishtit, të thëna përpara së Ai të ngrihej në qiell, plotësohen në mënyrë kaq të përsosur në librin e Veprave saqë ato theksojnë në mënyrë të përmbledhur e të suksesshme edhe përmbajtjen e këtij libri: "Ju do të jeni dëshmitarët e Mi në Jeruzalem (kap. 1-7), në gjithë Judenë dhe Samarinë (kap. 8-12) dhe deri në skajin e tokës (kap. 13-28)". Kështu, Veprat e Apostujve ndjekin përhapjen e shpejtë të ungjillit, duke filluar në Jeruzalem e duke shkuar në mbarë perandorinë romake.[103]

### SKICIMI:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| GJEOGRAFIK | I. | Jeruzalem | (1-7) | (rreth 3 vite) |
| | II. | Jude dhe Samari | (8-12) | (rreth 11 vite) |
| | III. | Në Skajet e Tokës | (13-28) | (rreth 18 vite) |
| APOSTUJT | I. | Pjetri | (1-12) | |
| | II. | Pali | (13-28) | |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Lindja dhe Rritja e Kishës

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 1 | 40 ditë pas ringjalljes; zgjedhja e Matisë |
| 2 | Pentakosti; ardhja e Frymës së Shenjtë |
| 5 | Hananiahu dhe Sapfira; përndjekje; hyjnia e Frymës së Shenjtë |
| 6 | Dhjakët e parë |
| 7 | Predikimi dhe martirizimi i Stefanit |
| 9 | Kthimi i Saulit - Pali |
| 13-14 | Udhëtimi i parë misionar |
| 15 | Këshilli i Jeruzalemit |
| 27-28 | Udhëtimi i Palit për në Romë |

- Përse "lindja dhe rritja e kishës" është tema e duhur për librin e Veprave të Apostujve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Veprave.
- Lexoni gjithë librin e Veprave të Apostujve.

[103] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 351.

## ROMAKËVE

Tema e kësaj letre është vetë ungjilli, i cili nuk jepet vetëm për judenjtë, por për mëkatarët e humbur, gjithandej. Kryesisht letra drejtuar Romakëve bën fjalë për shfajësimin prej besimit bazuar mbi drejtësinë e Perëndisë në Krishtin, si edhe mbi premtimet e Perëndisë... Letra tregon se të gjithë njerëzit janë mëkatarë, nën dënimin e drejtë të Perëndisë, si edhe përgjigjen që gjendet te Krishti, drejtësia e të cilit i jepet mëkatarit që pendohet duke i besuar Atij, ashtu sikurse mëkatet e mëkatarit paguhen nga vdekja zëvendësuese e Jezuit në kryq. Kjo prodhon një zbatim praktik dhe vënien në punë të drejtësisë së Perëndisë në shenjtërimin e besimtarit me anë të Frymës së Perëndisë. Veprimtaria e besimtarit do të rrjedhë gjithmonë nga zbatimi i duhur i doktrinës biblike.[104]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Zbulimi i Drejtësisë së Perëndisë | (1-8) |
| II. | Përligjja e Drejtësisë së Perëndisë | (9-11) |
| III. | Zbatimi i Drejtësisë së Perëndisë | (12-16) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Ungjilli i Perëndisë

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 3-5 | Shfajësimi |
| 9-11 | Izraeli – zgjedhja e kaluar, refuzimi i tanishëm, restaurimi i ardhshëm |
| 12-13 | Përgjegjësia ndaj Perëndisë, qeveria dhe shoqëria |
| 14-15 | Liria e krishterë- parimet dhe praktikat |
| 16 | Përfundim – lavdërim dhe përshëndetje |

- Përse “ungjilli i Perëndisë” është tema e duhur për letrën drejtuar Romakëve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të letrës drejtuar Romakëve.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Romakëve.

[104] Chrispin, *The Bible Panorama*, 477.

## 1 KORINTASVE

Tema bazë e kësaj letre është zbatimi i parimeve të krishtera në nivel personal dhe shoqëror. Kryqi i Krishtit është mesazh për të transformuar jetën e besimtarëve dhe për t'i bërë ata të ndryshëm nga bota që i rrethon, si persona dhe si një trup i përbashkët. Por korintasit po e shkatërronin dëshminë e tyre si të krishterë për shkak të imoralitetit dhe përçarjes. Pali e shkroi këtë letër si një reagim korrigjues ndaj lajmit për problemet dhe pështjellimet që ekzistonin mes korintasve. Letra u skicua për të hedhur poshtë qëndrime dhe veprime të gabuara, si edhe për të nxitur një frymë uniteti mes vëllezërve në marrëdhëniet dhe në adhurimin e tyre.[105]

### SKICIMI:

I. Ndarjet në Kishë (1-4)
II. Mosbindja në Kishë (5-6)
III. Vështirësitë në Kishë (7-16)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

### TEMA: Korrigjim dhe Dënim

### KAPITUJT KYÇË:

3 Papjekuri; themel; mishor; shpërblime
5 Incest / qëndrimi ndaj një vëllai që mëkaton
6 Padi / akuzë; imoralitet / liri
7 Udhëzime për martesën dhe beqarinë
8-10 Liria e krishterë
11 Rregull! Gratë / Darka e Zotit
12 Parimet bazë të dhuntive shpirtërore
13 Përparësia e dashurisë ndaj dhuntive shpirtërore
14 Procedura dhe rregulli në dhuntitë shpirtërore
15 Ringjallja

- Përse "korrigjim dhe dënim" është tema e duhur për letrën e Parë drejtuar Korintasve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Korintasve.
- Lexoni gjithë letrën e Parë drejtuar Korintasve.

[105] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 382.

## 2 KORINTASVE

Te 2 Korintasve, Pali vazhdon të ndërtojë duke pasuar letrën e tij të parë drejtuar kishës së Korintit, me tri nënndarje kryesore: shërbesa e Palit shihet në veprime, thirrja e tij për t'u dhënë të tjerëve përmes pikëpamjes së krishterë, dhe mbrojtja e tij ndaj apostullimit që i ishte dhënë nga Perëndia. Përveç rikthimit që u bën situatave të prekura në letrën e tij të parë, ai zbulon edhe situata të reja. Ndërkohë që letra e tij e parë zbulon më shumë mesazhin e Palit, kjo e dyta zbulon më shumë karakterin e tij. Megjithëse i shkruhet një kishe, ajo është një letër personale, ku ai jep detaje mbi biografinë e vet.[106]

### SKICIMI:

I. Karakteri: Shpjegimi i Palit ndaj Shërbesës së Vet (1-7)
II. Dhurimi: Pali Mbledh Ndihma për Shenjtorët (8-9)
III. Kredenciale: Pali Mbron Apostullimin e Vet (10-13)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

### TEMA: Mbrojtja e Apostullimit

### KAPITUJT KYÇË:

3 Vërtetim i shërbesës apostolike përmes jetëve të ndryshuara; venitja e lavdisë së Moisiut përpara lavdisë transformuese të shenjtërimit
5 Motivimet e shërbesës
8-9 Dhurimi

- Përse "mbrojtja e apostullimit" është tema e duhur për letrën e Dytë drejtuar Korintasve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Korintasve.
- Lexoni gjithë letrën e Dytë drejtuar Korintasve.

[106] Chrispin, *The Bible Panorama,* 497.

## GALATASVE

Pali e shkroi letrën drejtuar Galatasve për të kundërshtuar mësuesit e rremë judaizues të cilët po minonin doktrinën qendrore të Dhiatës së Re të shfajësimit me anë të besimit... Duke mos përfillur dekretin e këshillit të Jeruzalemit (Veprat e Apostujve 15:23-29), ata përhapën mësimin e tyre të rrezikshëm që paganët duhet të bëhen fillimisht prozelitë ,judenj dhe t'i nënshtrohen gjithë ligjit të Moisiut përpara se të bëheshin të krishterë... I tronditur nga qëndrimi i galatasve ndaj kësaj herezie të mallkuar (krah. 1:6), Pali shkroi këtë letër për të mbrojtur shfajësimin me anë të besimit dhe i paralajmëroi këto kisha për pasojat e tmerrshme që vinin nga braktisja e kësaj doktrine thelbësore.[107]

### SKICIMI:

I. Mbrohet Shfajësimi me anë të Besimit (1-2)
II. Shpjegohet Shfajësimi me anë të Besimit (3-4)
III. Zbatohet Shfajësimi me anë të Besimit (5-6)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

### TEMA: Shfajësimi Vetëm me anë të Besimit

### KAPITUJT KYÇË:

2 Pali merret me apostujt e tjerë; qortohet Pjetri
5 Liria e krishterë; të lirë për të shërbyer; ecni me Frymën

- Përse "shfajësimi vetëm me anë të besimit" është tema e duhur për letrën drejtuar Galatasve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Galatasve.
- Lexoni gjithë letrën e drejtuar Galatasve.

[107] MacArthur, *The MacArthur Study Bible*, 1786–87.

## EFESIANËVE

Gjysma e parë e kësaj letre është doktrinale dhe u drejtohet të krishterëve për të korrigjuar gabimet dhe për të mësuar doktrinën e shëndoshë, duke theksuar gjithçka që kanë në Kreun e lavdishëm të kishës, Zotin Jezu Krisht. Gjysma e dytë është praktike dhe nxit të jetuarit e mësimdhënies duke nderuar Perëndinë me jetën praktike. Për këtë, aty trajtohen tema dhe çështje të rëndësishme, duke përfshirë edhe qëllimin dhe planet e Perëndisë për kishën e Tij. Jepen mësime kyçe në lidhje me zgjedhjen, paracaktimin, shpengimin me anë të gjakut të derdhur, ringjalljen, kishën si trupi i Krishtit, shpëtimin me anë të hirit të Perëndisë përmes besimit në Krishtin, të jetuarit e gjërave që Perëndia sjell brenda nesh, Krishti si guri i qoshes, planet e Perëndisë për të shpëtuar paganët, bashkësia e vërtetë në një si të krishterë, ngritja në qiell, dhuntitë e Perëndisë për kishën, shenjtërimi dhe mos trishtimi i Frymës, sjellja në marrëdhënie të veçanta përfshirë edhe martesën, si edhe armatimi i Perëndisë. Kjo është një letër me thellësi doktrinale dhe me inkurajim të madh.[108]

### SKICIMI:

I. Pozita e Krishterë (1-3)
II. Praktika e Krishterë (4-6)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Plani i Përjetshëm i Perëndisë

### KAPITUJT KYÇË:

1 Të zgjedhur e të vulosur
2 Të shpëtuar prej hirit; uniteti në një trup
3 Misteri i kishës
4 Uniteti në trup; dhuntitë shpirtërore; jeta e mëparshme
5 Të ecurit në Frymë; përgjegjësitë shtëpiake
6 Skllevër dhe zotërinj; armatimi i besimtarit

- Përse “plani i përjetshëm i Perëndisë” është tema e duhur për letrën drejtuar Efesianëve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Efesianëve.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Efesianëve.

[108] Chrispin, *The Bible Panorama*, 507.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Romakëve?
    - Cila është tema e 2 Korintasve?
    - Çfarë jepet tek Efesianëve 5?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te Gjoni.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – SOTERIOLOGJI (PJESA 2)

> **Efesianëve 2:4-9**
> Por Perëndia, që është i pasur në mëshirë, për shkak të dashurisë së Tij të madhe me të cilën na deshi, na dha jetë bashkë me Krishtin, ndonëse ishim të vdekur në paudhësitë tona. Ju jeni shpëtuar me anë të hirit. Perëndia na ngjalli me Jezu Krishtin e na uli bashkë me Të në vendet qiellore. Kështu, nga mirësia që tregoi për ne përmes Krishtit Jezu, Ai shpalosi për epokat e ardhshme pasurinë e pamasë të hirit të Tij. Në të vërtetë, ju jeni shpëtuar me anë të hirit, përmes besimit e kjo nuk vjen prej jush, por është dhuratë nga Perëndia. Ju nuk u shpëtuat prej veprave tuaja, kështu që askush të mos mburret.

**Soteriologjia** është studimi i doktrinës së shpëtimit.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në soteriologji janë:

- Ungjilli
- Shpengimi
  - Plani i Perëndisë për Shpengim
  - Shpengimi Realizohet
  - Shpengimi Zbatohet

- Lexoni sërish pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e shpëtimit.
  - Çfarë pyetjesh të tjera keni në lidhje me të vërtetat kyçe që shprehen në të?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Vazhdoni të lexoni kapitujt rreth soteriologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E PËRZGJEDHJES.**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Romakëve 8:28-30
  - Romakëve 9:8-16
  - Efesianëve 1:3-6

> **Ueini Grudem në *Teologji Sistematike***
> Përzgjedhjen mund ta përkufizojmë kështu: Përzgjedhja është vepër e Perëndisë që përpara krijimit, përmes të cilës Ai zgjodhi disa njerëz për të qenë të shpëtuar, jo mbi bazat e meritave të tyre të parashikuara, por vetëm për shkak të kënaqësisë së Tij të mirë e sovrane.109

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e përzgjedhjes:

[109] Wayne A. Grudem, *Systematic Theology: An Introduction to Biblical Doctrine* (Leicester, England; Grand Rapids, MI: Inter-Varsity; Zondervan, 2004), 670.

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E RIPËRTËRITJES**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Gjoni 3:3-8
  - Efesianëve 2:4-5
  - Titit 3:5

> **J. I. Paker në *Teologji e Përmbledhur***
> Koncepti i ripërtëritjes është që Perëndia ripërtërin zemrën, thelbin e qenies së njeriut, duke rrënjosur në të një parim të ri dëshirash, qëllimesh dhe veprimesh, një dinamikë ndërvepruese e cila shprehet në reagimin pozitiv ndaj ungjillit dhe Krishtit. Fraza e Jezuit "lind nga uji e nga Shpirti" (Gjoni 3:5) e kthen vëmendjen tek Ezekieli 36:25-27, ku në mënyrë simbolike tregohet që Perëndia pastron personat nga ndotja e mëkatit (me anë të ujit) dhe i dhuron një "zemër të re" duke vendosur Frymën e Tij në ta...
>
> Ripërtëritja është tërësisht puna e Perëndisë Frymë e Shenjtë. Fryma e ngre të përzgjedhurin nga vdekja shpirtërore në një jetë të re në Krishtin (Ef. 2:1-10). Ripërtëritja është një kalim nga vdekja shpirtërore në jetë shpirtërore, në një besim të ndërgjegjshëm, të qëllimshëm dhe veprues në Krishtin, me fryt të menjëhershëm, jo kauzë të menjëhershme.110

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e ripërtëritjes.

[110] Packer, *Concise Theology*, 157–58.

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E SHFAJËSIMIT**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Romakëve 3:21-26
  - Romakëve 5:1-2
  - 2 Korintasve 5:21

> **Luis Berkhof në *Teologji Sistematike***
> Shfajësimi është një veprim i ligjshëm i Perëndisë, në të cilin Ai deklaron mbi bazën e drejtësisë së Jezu Krishtit se gjithë pohimet e ligjit janë plotësuar me nderim ndaj mëkatarit. Zbatimi i veprës së shpengimit është diçka unike në faktin që është veprim i ligjshëm i Perëndisë, një deklaratë që respekton mëkatarin, dhe jo një akt apo proces rinovimi, si ai i ripërtëritjes, kthimit në besim dhe shenjtërimit. Edhe pse e respekton mëkatarin, ky akt nuk e ndryshon jetën e brendshme të tij. Ai nuk ndikon gjendjen, por situatën e tij, dhe në këtë ndryshon nga të gjitha pjesët themelore të rregullit të shpëtimit. Ai përfshin faljen e mëkateve dhe restaurimin për përkrahje hyjnore.[111]

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e shfajësimit.

[111] Berkhof, *Systematic Theology*, 513.

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E SHENJTËRIMIT**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - 1 Korintasve 1:2
  - Filipianëve 1:6
  - Filipianëve 2:12-13

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Meihju në *Teologji Biblike***
> Edhe pse shenjtërimi kuptohet kryesisht si një proces përmes të cilit besimtari ndryshohet drejt imazhit të Krishtit (p.sh. Shkrimi flet për besimtarët si "ata që shenjtërohen" (Heb. 10:14), ai proces ka një fillim të qartë në ripërtëritje. Aspekti i kohës së tashme të shenjtërimit quhet shpesh shenjtërim progresiv (i vazhdueshëm e në rritje), ndërsa aspekti i kohës së shkuar mund të quhet shenjtërim fillestar, i çastit, apo përfundimtar.[112]

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e shenjtërimit.

[112] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 632.

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E NGRITJES NË LAVDI**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Romakëve 8:29-30
  - 1 Korintasve 15:50-53
  - Filipianëve 3:21

> **Xhon MekArthër dhe Riçërd Meihju në *Teologji Biblike***
> Ngritja në lavdi është transformimi i plotë i trupit dhe i shpirtit të besimtarëve, duke i bërë ata të përsosur në shenjtëri dhe të përshtatshëm për jetën e amshuar në tokën e re, në bashkësi të përsosur me Perëndinë trini. Murrei na ndihmon kur e përshkruan ngritjen në lavdi si "shpengimin e plotë e përfundimtar të të gjithë personit, kur në integritetin e trupit e të shpirtit, njerëzit e Perëndisë do të ndryshohen sipas imazhit të Shpengimtarit të ringjallur, të lartësuar e të ngritur në lavdi, dhe kur trupi poshtërues do të ndryshohet në trupin e lavdisë së Krishtit" (krah. Fil. 3:21).[113]

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e ngritjes në lavdi.

[113] MacArthur and Mayhue, *Biblical Doctrine*, 653.

**PËRKUFIZONI DOKTRINËN E SIGURISË SË PËRJETSHME**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Gjoni 10:27-29
  - Filipianëve 1:6
  - 1 Pjetrit 1:3-5
  - 1 Gjonit 2:19

> **Rollënd MekKjun në *Një Teologji Sistematike e Krishtërimit Biblik***
> **(1)** Ruajtja dhe siguria e përjetshme janë sinonime. Perspektiva e *ruajtjes* vjen nga këndvështrimi i Perëndisë. Perëndia e shpëton dhe e siguron besimtarin. Një doktrinë e përafërt, ajo e *këmbënguljes*, e sheh këtë nga këndvështrimi i besimtarit; kjo nënkupton që besimtari do të përparojë në jetën e krishterë deri në ditën e shpengimit përfundimtar.
> **(2)** Siguria e përjetshme merret vetëm me ata që janë vërtet të shpëtuar, jo me të ashtuquajturit të krishterë. Vetëm besimtarët e vërtetë merren parasysh...
> **(3)** Siguria e përjetshme nuk do të thotë që një besimtar nuk mund të rrëshqasë kurrë. I krishteri nuk mund të jetë kurrë pa mëkat në këtë jetë, e madje mundet edhe që besimtari të bjerë në mosbindje. Por, ashtu sikurse u pa edhe në kapitullin e mëparshëm të shenjtërimit, ka një kufi të qartë se deri ku mund të shkojë një besimtar i vërtetë në lidhje me këtë çështje. Mëkati nuk do të sundojë më kurrë mbi të (Rom. 6:14). Ndarja vendimtare dhe e përjetshme nga mëkati nëpërmjet bashkësisë me Krishtin (në vdekjen dhe në ringjalljen e Tij; Rom. 6:2, 6-10) nuk e lejon braktisjen e plotë të besimit dhe humbjen e jetës së përjetshme të besimtarit...[114]

- Përkufizoni me fjalët tuaja doktrinën e sigurisë së përjetshme.

[114] Rolland McCune, *A Systematic Theology of Biblical Christianity: The Doctrines of Salvation, the Church, and Last Things,* vol. 3 (Allen Park, MI: Detroit Baptist Theological Seminary, 2010), 159–60.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e shpëtimit dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e përzgjedhjes?
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e ripërtëritjes?
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e shfajësimit?
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e shenjtërimit?
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e ngritjes në lavdi?
    - Si mund ta përkufizoni doktrinën e sigurisë së përjetshme?
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
    - Si do ta përkufizonit pagabueshmërinë e Shkrimit?
    - Si do ta përkufizonit Trininë?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
    - Cilat janë qëllimet e kishës?
    - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?
    - Çfarë duhet të bëjë dikush që të shpëtohet? A është thelbësor pendimi, për kthimin në besim?
    - Shpjegoni se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **1 Korintasve 9:25-27**
> Të gjithë ata që marrin pjesë në vrapim i nënshtrohen një disipline të rreptë, ata për të fituar një kurorë që prishet, ndërsa ne atë që nuk prishet. Kështu vrapoj edhe unë tani, por jo pa synim të qartë, kështu luftoj me grushte, por jo sikur rrah erën. E mundoj trupin dhe e nënshtroj, që të mos përjashtohem vetë, pasi t'u kem predikuar të tjerëve.

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Jo i dhënë pas verës, por i arsyeshëm, me vetëkontroll, i përmbajtur dhe i matur**

  **1 Timoteut 3:2-3** Peshkopi duhet të jetë i patëmetë… i kthjellët, i matur… jo pijanec…

  **Titit 1:7-8** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm… as i dhënë pas verës… por… dashamirës, i urtë… e i matur.

  - Përkufizojini me fjalët tuaja këto cilësi.

  - Përse janë të nevojshme këto cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni Efesianëve 5:18-21. Kush duhet t'i kontrollojë mendimet dhe sjelljen e çdo besimtari? Çfarë do të prodhojë kjo gjë në jetën e besimtarit?

- Si mund ta demonstroni vetëkontrollin dhe mendje kthjelltësinë në...
    - mendimet tuaja?
    - vendimmarrjet tuaja?
    - ndërveprimet me të tjerët?
- Lexoni 1 Timoteut 3:11 dhe Titit 2:3. Kur dhe në ç'mënyra janë të ndjeshme gratë në përpjekjet për të ruajtur vetëkontrollin në fjalët që thonë ato për të tjerët? Çfarë janë thashethemet dashakeqëse dhe përse janë ato një tundim i zakonshëm mes grave?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Si mund t'i ekuilibrojë një person i pjekur shpirtërisht seriozitetin e jetës e shërbesës me gëzimin dhe kënaqësinë e jetës? Si mund të duket kjo gjë ndryshe në besimtarë të ndryshëm?
3. Kur mund të tundohet një udhëheqës drejt fjalëve apo sjelljeve të pamenduara e moskokëçarëse? Si mund ta ruajnë veten nga tundime të tilla?
4. Përse është e lehtë të gjesh justifikime për thashethemet, sidomos nëse jeni duke shërbyer në një rol udhëheqjeje? Përse është shumë e rrezikshme kjo gjë? Si mund ta ruani zemrën dhe të folurit tuaj në lidhje me këtë?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## MEDITIM NGA BIBLA

> **Jozuehu 1:8**
> Mos e hiq nga goja librin e këtij ligji. Përsiate ditë e natë, që ta mbash e të bësh gjithçka është shkruar në të. Vetëm atëherë do të kesh mbarësi e begati.

> **David U. Sakston**
> Meditimi hyjnor ka një vlerë të shumanshme. Ai na jep dallimin shpirtëror; përmirëson leximin nga Bibla dhe jetën tonë të lutjes; vë në zbatim të vërtetat madhore të Biblës në mënyrë personale dhe specifike; na forcon zemrën duke u përqendruar në të vërtetat shpirtërore; siguron përfitim të vazhdueshëm duke banuar në të vërtetat që njohim.[115]

- Përshkruani praktikën tuaj të rregullt të meditimit nga Bibla.

- Përse ka rëndësi meditimi i rregullt nga Bibla, për rritjen dhe pjekurinë tuaj shpirtërore?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Çfarë përfitimesh shpirtërore keni vënë re në jetën tuaj, apo në jetën e personave që ju keni shërbyer, nga meditimi mbi Fjalën e Perëndisë?
3. Cilat këshilla apo ndihma praktike kanë qenë të dobishme për ju në meditimin rreth Shkrimit?

[115] David W. Saxton, *God's Battle Plan for the Mind* (Grand Rapids, MI: Reformation Heritage, 2015), 5.

# Kapitulli 9

**TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE**

- **SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE: TË KUJDESEMI PËR ATA QË VUAJNË**

**TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE**

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Filipianëve:** Jeta Themelore e Krishterë
  - **Kolosianëve:** Gjithë-Mjaftueshmëria e Krishtit
  - **1 Selanikasve:** Rritja e një Kishe të Re; Kisha Model
  - **2 Selanikasve:** Ngushëllim dhe Korrigjim
  - **1 Timoteut:** Një Manual për Jetën e Kishës
  - **2 Timoteut:** Shërbesa si Betejë Shpirtërore
  - **Titit:** Pasion për Doktrinën e Perëndisë
  - **Filemonit:** Manual mbi Faljen

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - **Eskatologji:** Studimi i Doktrinës së Gjërave të Fundit
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Të japim një linjë kohore të përgjithshme mbi ngjarjet e kohëve të fundit.

**TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE**

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Mikpritës

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Përsëritje

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE:
## TË KUJDESEMI PËR ATA QË VUAJNË

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Kujdesi sa më mirë për ata pjesëtarë që vuajnë brenda trupit është një përgjegjësi kyçe e udhëheqjes së kishës. Vuajtja ka për të qenë një realitet në çdo kishë lokale, sepse ajo është një pjesë e trashëgimisë së jetës në këtë botë të rënë.

> **Heath Lambert**
> Të jetuarit në një botë mëkatare sjell dhimbje. Pavarësisht nëse vuajmë për shkak të mëkatit tonë, të mëkatit të të tjerëve, të mëkateve të botës, të dhimbjes së të tjerëve, të veprimeve të djallit, të çoroditjeve tona, apo të dobësive dhe përkeqësimit të trupit tonë drejt vdekjes, sido që të jetë, ne vuajmë.[116]

Por në mes të vuajtjeve ka shpresë. Udhëheqësit biblikë kanë privilegjin dhe përgjegjësinë për t'u sjellë ndihmë e shpresë personave që vuajnë.

### TË KUPTOJMË VUAJTJEN DHE MËKATIN

Është jetësore të kuptoni lidhjen mes mëkatit dhe vuajtjes, në mënyrë që të kujdeseni mirë për ata që përballen me mundime në këtë jetë. Në tërësi, vuajtja është pasojë e mëkatit. Te Zanafilla 1 dhe 2 nuk ka fare vuajtje. Po kështu, nuk ka fare vuajtje as në fund të Zbulesës. Por, nga Zanafilla 3 deri te Zbulesa 20, vuajtjet janë me bollëk pasi mëkati dhe pasojat e tij gëlojnë.

Megjithatë, vuajtjet e dikujt nuk janë gjithmonë pasojë e mëkatit të tij, apo të saj. Në fakt, disa herë besimtarët vuajnë për shkak të mirësisë që tregojnë (1 Pjetrit 2:19-21). Vuajtjet janë gjithmonë një mundësi për të lavdëruar Perëndinë. Merrni parasysh ndërveprimin e Jezuit me dishepujt e Tij në lidhje me njeriun që kishte lindur i verbër.

> **Gjoni 9:2-3**
> Dishepujt e pyetën: "Mësues, kush ka mëkatuar që ai ka lindur i verbër, ai vetë apo prindërit e tij?". Jezui u përgjigj: "Nuk kanë mëkatuar as ai e as prindërit e tij, por ka lindur i verbër që në të të shfaqen veprat e Perëndisë."

Disa nga "shërbesat" më të keq drejtuara ndaj personave që vuajnë vijnë si pasojë e moskuptimit të duhur e të mjaftueshëm të lidhjes mes mëkatit dhe vuajtjes. Miqtë e Jobit bënë mirë që shkuan tek ai "për t'i ndenjur pranë e për ta ngushëlluar"(Jobi 2:11-13). Sidoqoftë, fjalët e tyre, që pa dyshim synonin t'i vinin në ndihmë, hodhën kaq shumë faj mbi Jobin saqë nuk u bënë as burim ngushëllimi dhe mbi të gjitha nuk përmbanin asnjë të vërtetë në to.

[116] Heath Lambert, *A Theology of Biblical Counseling* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2016), 255.

> **Jobi 4:7-9**
> Thirri mendjes, cili i pafajshëm u rrënua? Ku është ai i drejtë që u shkatërrua? Me sa kam parë unë, kush mih ligësi e mbjell prapësi, ato edhe korr. Ata i rrënon puhiza e Perëndisë, i fundos fryma e zemërimit të Tij.

Miqtë e Jobit kishin një botëkuptim tepër të thjeshtë të lidhjes mes mëkatit dhe vuajtjes. Ata besonin se kushdo që vuante kishte mëkatuar, prandaj edhe e meritonte të vuante. Nëse ai pendohej, atëherë vuajtjet merrnin fund dhe jeta do të shkonte vaj. Për pasojë, atyre u mungonte dhembshuria për Jobin dhe përfundimisht ashpërsuan edhe kritikat dhe gjuhën e përdorur ndaj tij.

Është e vërtetë që si mëkatarë të gjithë meritojmë gjykimin dhe ndëshkimin e Perëndisë (Zanafilla 2:16-17; Romakëve 6:23). Në të vërtetë, asnjë "i pafajshëm nuk u rrënua" (Jobi 4:7). Nga njëra anë, ne meritojmë çdo vuajtje me të cilën përballemi në këtë jetë. Në fakt, kjo është më pak sesa meritojmë, pasi ne meritojmë vdekjen. Po ashtu është e vërtetë që mëkati ka pasoja në këtë jetë dhe ka raste kur Perëndia sjell disiplinë në jetën e dikujt, përfshirë edhe vuajtjet, si reagim ndaj ndonjë mëkati specifik, në mënyrë që personi në fjalë të pendohet (1 Korintasve 11:27-30; Hebrenjve 12:4-11).

Kështu pra, është gjëja e duhur që kur dikush vuan, të shqyrtojë vetveten e të marrë parasysh se si ndoshta mëkati personal mund ta ketë çuar në këtë vuajtje. Është gjëja e duhur që kur vuan, ta urresh mëkatin dhe t'i mbash sytë me durim drejt ditës kur mallkimi i mëkatit nuk do të ekzistojë më. Gjithashtu është e vërtetë që vuajtjet janë një realitet i zakonshëm i jetës në një botë të rënë dhe jo pasojë e drejtpërdrejtë e ndonjë mëkati specifik personal në jetën e dikujt. Në këtë jetë, të gjithë vuajnë në kohë të caktuara.

> **Jobi 5:7**
> "Për t'u pikëlluar ka lindur njeriu, sikurse shkëndijat për të fluturuar lart".

Kjo nuk do të thotë që të gjithë do të vuajnë në mënyrë të barabartë. Perëndia plot sovranitet lejon vuajtjet në sasinë e duhur në jetën e çdo besimtari për të realizuar planin e Tij të përsosur, për lavdinë e Tij dhe për të mirën e besimtarëve.

> **Romakëve 8:28-29**
> Ne e dimë se Perëndia bën që të gjitha gjërat të bashkëveprojnë për mirë për ata që e duan Atë dhe që janë thirrur sipas qëllimit të Tij. Sepse Perëndia i njihte ata që më përpara dhe i paracaktoi për t'u bërë të ngjashëm me shëmbëllimin e Birit të Tij, në mënyrë që Biri të jetë i parëlinduri mes shumë vëllezërve.

Perëndia e përcakton të mirën që Ai kryen duke na bërë "të ngjashëm me shëmbëllimin e Birit të Tij". Vuajtjet janë një mundësi për të mprehur botëkuptimin tonë për Perëndinë, për të rafinuar karakterin tonë dhe për të forcuar shpresën dhe pasionin tonë për përjetësinë.

- Si mund të ndikohet shërbesa jonë ndaj personave që vuajnë, nëse nuk e kuptojmë si duhet lidhjen mes mëkatit dhe vuajtjes?

## REAGIMI NDAJ VUAJTJEVE

Jezui karakterizohej nga dhembshuria ndaj atyre që pikëllohen në mes të vuajtjeve (Mateu 9:36, 14:14, 15:32, 20:34; Marku 1:41; Luka 7:13). Zemrën e Tij plot dhembshuri duhet ta bashkë ndajnë edhe udhëheqësit biblikë. Kjo dhembshuri do të ushqejë dëshirën për të lehtësuar dhimbjet, për të ngushëlluar e për t'u kujdesuar për ata që vuajnë. Shpesh Perëndia na përgatit për të ngushëlluar me dhembshuri të tjerët, nëpërmjet ngushëllimit që kemi marrë vetë përmes vuajtjeve tona.

- Lexoni 2 Korintasve 1:3-5. Si na ngushëllon Perëndia në vuajtjet tona? Si na përgatit kjo për të ngushëlluar të tjerët?

Përveç përkujdesit dhe ngushëllimit ndaj atyre që vuajnë, udhëheqësit biblikë kërkojnë gjithashtu të jenë përkrah atyre personave me qëllim që t'i ndihmojnë të reagojnë në mënyrë të tillë që ta nderojnë Zotin. Perëndia i thërret besimtarët që në mes të vuajtjeve të tyre, t'i zënë besë Atij, duke njohur sovranitetin, mirësinë, urtësinë, besnikërinë dhe dashurinë e Tij. Një pyetje thelbësore, së cilës duhet t'i japë përgjigje kushdo që vuan, është: "A do t'i lejoj këto vuajtje që të më largojnë tej Perëndisë, drejt zemërimit, inatit dhe hidhërimit, apo që të ma afrojnë më pranë Tij plot besë dhe adhurim?"

- Lexoni Jobi 1:1-2:10. Krahasoni reagimin e Jobit ndaj vuajtjeve me atë të gruas së tij.

Vetëm kur besimtarët mbeten të përqendruar te Fjala dhe te karakteri i Perëndisë, atëherë ata do të gjejnë ngushëllim dhe do të jenë në gjendje t'i besojnë Atij në mes të vështirësive të jetës. Pasi përshkruan ankthet dhe dhimbjet e vuajtjeve te Vajtimet 3:1-20, Jeremia dallon në vargjet pasuese atë që i jep shpresë dhe e bën të vazhdojë t'i zërë besë Zotit.

- Lexoni Vajtimet 3;21-28. Cilën gjë nga karakteri i Perëndisë solli në mendje Jeremia me qëllim që të ruante perspektivën e duhur në mes të vuajtjeve?

Perëndia jo vetëm që i thërret besimtarët t'i zënë besë Atij në mes të vuajtjeve, por gjithashtu Ai i urdhëron ata të ***gëzohen***. Një gëzim i tillë nuk gjendet te vuajtjet, por në shpresën e ungjillit (1 Pjetrit 1:3-6) dhe te besimi që mund të ketë dikush në punën e vazhdueshme të Perëndisë (Jakobi 1:2-4). Kur besimtarët reagojnë ndaj vuajtjeve me besim e gëzim, shpesh ata kanë mundësi domethënëse për të shpallur ungjillin, pasi këto nuk janë reagime normale njerëzore ndaj vuajtjeve (Filipianëve 1:12-14).

- Si mund t'i ndihmoni të tjerët të gëzohen mes vuajtjeve pa minimizuar dhimbjet dhe ankthet me të cilat përballen?

Në mirësinë dhe urtësinë e Tij, Perëndia i përdor vuajtjet për të rafinuar dhe për t'i dhënë formë popullit të Tij në ngjashmëri me imazhin e Tij. Ashtu si argjendari që pastron një metal të çmuar, Perëndia përdor nxehtësinë e mundimeve për të pastruar të Tijtë. Besimtarët duhet t'i pranojnë mundimet si mënyrat parësore që Perëndia i përdor për t'i ***rritur*** ata. Besimtarët duhet t'u nënshtrohen me përulësi dhe t'i durojnë mundimet, duke kërkuar të mësojnë gjithçka që Perëndia dëshiron t'u mësojë atyre përmes vuajtjeve që Ai vetë i lejon, ndërsa i përgatit ata për lavdi.

> **Xhimi Ierikson Tada dhe Stiv Estes**
> Dhimbjet tokësore vazhdojnë ta dërrmojnë shpresën tonë, duke na kujtuar se kjo botë nuk mund të na kënaqë kurrë; vetëm qielli mund të na lumturojë. Sa herë që fillojmë të rehatohemi së tepërmi në planetin e Tij, Perëndia ndërhyn e shpërthen digën duke bërë që dushi i ftohtë i vuajtjeve të na zgjojë nga dremitja shpirtërore.[117]

- Lexoni Romakëve 5:3-5; Jakobi 1:2-4; dhe 1 Pjetrit 1:6-7. Si i përdor mundimet për mirë Perëndia në jetën e besimtarit?

Udhëheqësit biblikë i inkurajojnë personat që vuajnë për t'i besuar më shumë Zotit, të gëzohen në Të, të mësojnë gjithçka që Perëndia synon t'u mësoje atyre dhe t'i shfrytëzojnë plotësisht mundësitë për shërbesë që vijnë nga rrethanat e tyre të vështira. Këto përparësi duhet që të reflektohen gjithashtu në lutjet tona për ata që vuajnë, pasi lutja është një aspekt thelbësor i shërbesës ndaj tyre.

Po ashtu, shërbimi besnik përfshin edhe dëshirën, vullnetin dhe gatishmërinë për të folur plot hir në jetën e tyre kur ata të ndeshen më mëkate të tilla si hidhërimi, murmuritja, apo inati.

> **Xhoel Xheims**
> Kur dikush mëkaton apo përballet me mundime të dhimbshme, ne duhet të tregojmë dhembshuri. Sidoqoftë, duhet të kuptojmë gjithashtu që reagimi i tij/saj është ose i mëkatshëm, ose i drejtë. Nëse të bërtet bashkëshorti i dikujt apo nëse diagnostikohesh me kancer nuk është mëkat: por mënyra se si reagojmë ndaj këtyre situatave mund të jetë mëkat. Si këshilltar, kur keni të bëni me mëkate reagimi, duhet të ecni në fije të perit. Duhet të shfaqni dhembshuri dhe durim, e njëkohësisht me butësi të vini në pah reagimet e pa perëndishme (Rom. 12:15; Gal. 6:1-2).[118]

[117] Joni Eareckson Tada and Steve Estes, *When God Weeps (*Grand Rapids, MI: Zondervan, 1997), 202.
[118] James, *Counsel with Confidence*, 37.

- Kur dhe si mund të përballni me durim dikë që reagon në mënyrë të mëkatshme ndaj vuajtjeve? Cilët faktorë mund të ndikojnë në mënyrën se si përqaseni me këtë përballje?

## VIZITOJMË TË SËMURËT

Një aspekt i veçantë i kujdesit ndaj atyre që vuajnë është vizita te të sëmurët. Jezui kaloi kohë të konsiderueshme dhe shpenzoi energji të shumta duke u shërbyer atyre që kishin probleme dhe sëmundje të ndryshme fizike (Mateu 4:23-24). Kjo gjë duhet të jetë e vërtetë edhe për ata që janë besnikë në dashurinë e tyre ndaj Krishtit dhe njerëzve të Tij. Te Mateu 25:34-40, Jezui e bën të qartë se duke vizituar të sëmurët, ne jo vetëm që kujdesemi për ta, por edhe i shërbejmë Krishtit, siç thotë vetë Ai: "sa herë e keni bërë këtë gjë për njërin nga këta vëllezërit e Mi më të vegjël, ma keni bërë Mua" (v. 40).

Gjatë shërbesës së Jezuit në tokë, shpesh Ai i shëroi të sëmurët për të shfaqur dhembshurinë, fuqinë dhe të vërtetat e mbretërisë së Tij që po afronte (Mateu 4:23-24). Në të njëjtën mënyrë, edhe udhëheqësit biblikë sot duhet të interesohen vërtet për mirëqenien fizike të të tjerëve dhe duhet të luten për shërim në përputhje me vullnetin e Perëndisë (Jakobi 5:14-16). Sidoqoftë, fokusi i shërbesës dhe lutjes për të sëmurët duhet të jetë në shëndetin dhe në rritjen e tyre shpirtërore në mes të sëmundjeve apo lëndimeve fizike që po kalojnë.

> **Riçërd Bakster**
> Duhet të jemi të zellshëm për të vizituar të sëmurët e t'i ndihmojmë ata, qoftë për një jetë të frytshme, apo për një vdekje të lumtur.[119]

> **Çarls Spërxhën**
> Guxoj të them se bekimi më i madh tokësor që mund t'i japë Perëndia kujtdo prej nesh është shëndeti, përveç sëmundjeve. Për shenjtorët e Perëndisë, shpesh sëmundjet kanë qenë më të dobishme se shëndeti.[120]

Kur vizitoni një të sëmurë apo të lënduar, është e rëndësishme t'u kushtoni vëmendje pyetjeve, pjesëve nga Shkrimi dhe përparësive të duhura për vizitën, ndërkohë që duhet të jeni të hapur gjithashtu për t'u përshtatur për ndërveprime në kushtet shpirtërore dhe fizike të personit në fjalë.

- Çfarë pyetjesh mund t'i drejtoni një personi të sëmurë, apo edhe dikujt që gjendet pranë vdekjes, me qëllim që të njehsoni shëndetin e tyre shpirtëror e ta ktheni bisedën drejt të vërtetave biblike?

[119] Richard Baxter, *The Reformed Pastor*, ed. William Brown (Edinburgh: Banner of Truth, 2001), 102.
[120] Charles Haddon Spurgeon, *An All-Round Ministry* (Edinburgh: Banner of Truth, 1960), 384.

Ndërveprimi me personat që vuajnë fizikisht kërkon mençuri dhe urtësi për të dalluar situatën...

- Që të kaloni kohë të mjaftueshme për të inkurajuar e për të ndihmuar personin në fjalë, ndërkohë që të mos e teproni me vizitën (pasi personi ka nevojë për pushim e qetësi).
- Që të tregoni interes të vërtetë duke e pyetur rreth shëndetit fizik, por të shmangni sa më shumë këshillat mjekësore.
- Që të tregoni kujdes për sfidat aktuale fizike dhe të përkohshme, ndërkohë që të kërkoni gjithashtu ta drejtoni personin në të vërtetat e përjetshme shpirtërore. Shpesh, pyetja "Për çfarë mund të lutem për ty?" mund t'ju ndihmojë praktikisht që ta ktheni bisedën drejt çështjeve shpirtërore dhe të luteni si duhet për të, përpara se të largoheni.

Ndonjëherë, vizita te të sëmurët mund të hapë mundësi për t'iu shërbyer anëtarëve të tjerë të familjes, apo miqve që mund të jenë të pranishëm. Ndërkohë që duhet të përqendroheni tek i sëmuri, për aq sa ai mund të ndërveprojë, përsëri nuk duhen lënë pas dore mundësitë për t'u shpallur ungjillin të tjerëve, qoftë duke folur me ata që janë në dhomë, qoftë duke e përmendur ungjillin në lutjen tuaj.

Vizitat ndaj të sëmurëve nuk janë gjithnjë të rehatshme apo të volitshme. Megjithatë ato reflektojnë zemrën e Zotit tonë dhe duhet të jenë një përparësi për udhëheqësit biblikë dhe për gjithë trupin.

> **Brajnën Kroft**
> Kur i bëjmë të qëllimshme vizitat te të sëmurët dhe kur kisha ndjen pikëllim e vuajtje bashkë me ta, atëherë mund të besojmë se po kryhet një detyrë hyjnore, po ushqejmë e po tregojmë dashuri për shpirtrat e njerëzve, po ndryshohemi nga brenda, po shpaloset ungjilli dhe po lavdërohet Perëndia.[121]

## NGUSHËLLOJMË TË PIKËLLUARIT

Një mundësi tjetër unike për kujdesin ndaj personave që vuajnë është ngushëllimi i të pikëlluarve që kanë humbur një të afërm. Rrethana të ndryshme, që shoqërojnë një vdekje të tillë, mund të na çojnë drejt nevojave të veçanta të të pikëlluarve. Një e ve e re me fëmijë ka nevoja të ndryshme për kujdes e mbështetje nga një çift që kanë humbur fëmijën apo nga një e ve e moshuar. Vdekja e një të afërmi që ka besuar do të sjellë një reagim shumë të ndryshëm (1 Selanikasve 4:13) nga ajo e dikujt që nuk ka besuar. Në të njëjtën kohë, shpresa dhe ndihma gjenden vazhdimisht në Fjalën e Perëndisë dhe në kujdesin e njerëzve të Tij.

Edhe pse nuk do të dinë gjithmonë se çfarë të thonë, udhëheqësit biblikë i bekojnë dhe i inkurajojnë të pikëlluarit duke qëndruar me ta – duke vajtuar me ta (Romakëve 12:15), duke reflektuar me ta, duke u lutur me ta dhe duke i drejtuar zemrat e tyre drejt Zotit e Fjalës së Tij.

- Si mund të ngushëlloni ata që janë të pikëlluar për humbjen e dikujt, me praninë apo me fjalët tuaja?

[121] Brian Croft, *Visit the Sick* (UK: Day One, 2009), 56.

Shpesh, kujdesi për të pikëlluarit përqendrohet gjatë kohës që pason menjëherë vdekjen. Megjithatë është e rëndësishme të kujtoni që ka nevoja afatgjata për mbështetje, kujdes e miqësi.

> **Pal Totges**
> Shërbimi ndaj personave që kanë humbur një të afërm është privilegj dhe përgjegjësi unike dhe kërkon vëmendje afatgjatë.[122]

## KUJDESEMI PËR NEVOJTARËT

Udhëheqësit biblikë u shërbejnë me besnikëri të tjerëve dhe e nderojnë Zotin duke u kujdesur për nevojtarët.

> **Fjalët e Urta 14:31**
> Kush nëpërkëmb të vobektin, fyen Krijuesin e tij, por kush përkrah nevojtarin, e nderon.

Njerëzit e Perëndisë janë karakterizuar gjithmonë nga kujdesi për personat në nevojë (Ligji i Përtërirë 15:10-11, Veprat e Apostujve 2:44-45). Besimtarët do të jenë bujarë (Fjalët e Urta 22:9), duke njohur bujarinë e Perëndisë ndaj tyre në Krishtin (2 Korintasve 9:15).

Duke kërkuar të kujdesen për nevojtarët, individët dhe kishat duhet të ekuilibrojnë bujarinë dhe dhembshurinë me urtësinë biblike që nevojitet për të qenë kujdestarë të mençur. Ndërkohë që duhet të jetë bujare dhe e gatshme për të dhuruar, kisha duhet që të inkurajojë gjithashtu edhe zellin për të punuar fort tek ata që kanë mundësi (2 Selanikasve 3:6-13) dhe t'i pajisë anëtarët e familjes për të plotësuar përgjegjësitë e tyre ndaj njëri-tjetrit (1 Timoteut 5:8, 16). Po ashtu, udhëheqësit biblikë të kishës duhet të ekuilibrojnë përparësinë e mbështetjes për ata që janë brenda kishës me urdhrin për t'u kujdesur bujarisht për të varfrit mes nesh (Galatasve 6:9- 10). Shpesh, kishat kanë një politikë bujarie që i ndihmon të tregojnë kujdes ndaj nevojtarëve.

- Lexoni politikën e bujarisë që ka kisha juaj.
  - Cilat parime biblike reflektohen atje, në lidhje me kujdesin ndaj nevojtarëve?
  - Çfarë pyetjesh keni mbi këtë politikë apo mbi zbatimin e saj?

[122] Paul Tautges, *Comfort the Grieving* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 2014), 56.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si ju ka ndihmuar ky kapitull për të reaguar në mënyrë biblike ndaj vuajtjeve? Po për të ndihmuar persona të tjerë që vuajnë? Po përsa i përket lutjes për ata që vuajnë?
3. Diskutoni mbi disa mënyra të dobishme praktike kur vizitoni të sëmurët. Cilët faktorë mund të ndikojnë në lidhje me...
    - koordinimin në kohë të vizitës?
    - pyetjet që i bëni personit mbi gjendjen e tyre fizike?
    - kohëzgjatjen e vizitës suaj?
    - prekjen apo mos prekjen fizike të personit (p.sh. të shtrëngoni duart me të kur luteni, etj.)?
    - përfshirjen e fëmijëve/nipërve dhe mbesave gjatë vizitës?
4. Si mund të kujdeset në mënyrën e duhur kisha për ata që kanë humbur një të afërm? Si mund të ndikojnë rrethanat në këtë kujdes?

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik i kishës kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i përëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **2 Timoteut 4:13**
> Kur të vish, më sill gunën që i lashë Karpit në Troadë dhe librat, sidomos pergamenat.

> **Ligën Dankën**
> Pali është vetëm disa muaj larg vdekjes. Ai ka shkruar pjesën më të madhe të letrave të Dhiatës së Re. Pas tij shtrihet një jetë e tërë shërbese. Dhe tani çfarë dëshiron të bëjë? Të studiojë! Po afrohet dimri dhe Pali kërkon gunën e vet, por më e rëndësishmja është që ai kërkon librat e pergamenat. Edhe pse thuajse në fund të udhës, Pali synon të vazhdojë të mësojë e të rritet me anë të leximeve shpirtërore.[123]

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë nga secili libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

[123] Thomas Ascol, ed., *Dear Timothy: Letters on Pastoral Ministry* (Cape Coral, FL: Founders, 2004), 198.

## FILIPIANËVE

Kjo letër u shkrua për të përçuar dashurinë dhe mirënjohjen e Palit ndaj besimtarëve në Filipi, si dhe për t'i nxituar ata për një jetesë me unitet, shenjtëri dhe gëzim. Qartësisht Pali shijoi një marrëdhënie shumë të ngrohtë me kishën e Filipisë... Letra drejtuar Filipianëve nuk u shkrua për shkak të ndonjë krize, por për të shprehur lidhjen e ngushtë që Pali pati me ta, mirënjohjen e tij për dhuratën e tyre, inkurajimin e tij për rritjen e tyre si të krishterë, paralajmërimet e tij kundër mësuesve të rremë dhe mendimet e tij mbi rrethanat në të cilat ai gjendej.[124]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Pjesëmarrës me Krishtin | (1) |
| II. | Njerëz të Krishtit | (2) |
| III. | Rendja pas Krishtit | (3) |
| IV. | Fuqia e Krishtit | (4) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Jetesa Bazë e Krishterë

### KAPITUJT KYÇË:

2 Uniteti i trupit; përulësia e Krishtit; bëjeni të dukshëm shpëtimin tuaj; hyjnia e Krishtit; Timoteu dhe Epafroditi

3 Paralajmërime kundër judaizuesve; shfajësimi

- Përse "jetesa bazë e krishterë" është tema e duhur për letrën drejtuar Filipianëve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Filipianëve.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Filipianëve.

[124] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 407.

## KOLOSIANËVE

Nga librat e Biblës, letra drejtuar Kolosianëve është një nga ato që përqëndrohen më shumë te Krishti. Në të, Pali thekson supremacinë e personit të Krishtit dhe plotësimin e shpëtimit që siguron Ai, me qëllim që të luftojë herezinë në rritje në kishën e Kolosit. Krishti, Zoti i krijimit dhe Kreu i trupit, që është Kisha e Tij, është tërësisht i mjaftueshëm për çdo nevojë shpirtërore dhe praktike të besimtarit. Bashkësia e besimtarit me Krishtin në vdekjen, ringjalljen dhe lartësimin e Tij është themeli mbi të cilin duhet të ngrihet jeta e tij tokësore.[125]

### SKICIMI:

I. Mjaftueshmëria e Krishtit (1-2)
II. Nënshtrimi ndaj Krishtit (3-4)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Gjithëmjaftueshmëria e Krishtit

### KAPITUJT KYÇË:

1 Lutja e Palit; lartësimi i Krishtit
3 Pozicioni dhe praktika e besimtarit

- Përse "gjithëmjaftueshmëria e Krishtit" është tema e duhur për letrën drejtuar Kolosianëve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të letrës drejtuar Kolosianëve.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Kolosianëve.

[125] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 410.

## 1 SELANIKASVE

Kisha në Selanik ishte një kishë model në shumë mënyra. Pali kishte shumë gjëra për t'i falenderuar besimtarët: besimin e tyre shembullor, shërbesën plot zell, qëndrueshmërinë plot durim dhe gëzimin e tyre të tejskajshëm. Por në mes të lavdërimeve të tij, Pali ngre një fjalë paralajmëruese. Të jetuarit në veprën e Zotit është vetëm një hap larg nga braktisja e punës së Tij përmes vetëkënaqësisë. Kështu, Pali i nxit Selanikasit që të shkëlqejnë në besimin e tyre, të rriten në dashurinë për njëri-tjetrin dhe të jenë gjithnjë mirënjohës për gjithçka.[126]

**SKICIMI:**

I. Përvoja Personale (1-3)
II. Nxitje Praktike (4-5)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni kapitullin kyç.

**TEMA:** Rritja e një Kishe të Re; Kisha Model

**KAPITULLI KYÇ:**

4 Pastërti; jetesë e disiplinuar; rrëmbimi drejt qiellit

- Përse "rritja e një kishe të re; kisha model" është tema e duhur për letrën e Parë drejtuar Selanikasve?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Selanikasve.
- Lexoni gjithë letrën e Parë drejtuar Selanikasve.

[126] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 416.

## 2 SELANIKASVE

2 Selanikasve vazhdon të ndërtojë mbi mësimin e letrës së parë dhe thekson se ardhja e dytë e Zotit Jezu Krisht nuk ka ndodhur ende. Aty tregohen gurë kilometrikë të cilët duhen kaluar përpara se Krishti të kthehet sërish, përfshirë braktisjen e besimit nga shumë vetë dhe zbulimin e njeriut të mëkatit, i cili do të shkatërrohet nga fryma dhe shkëlqimi i Zotit të gjithëpushtetshëm që po vjen! Por ardhja e dytë e Krishtit, çka e ngushëllon besimtarin në Perëndinë e tij Sovran, do të sjellë tmerr në zemrën e të humburve që përballen me dënimin e Perëndisë. Po ashtu, 2 Selanikasve ka një temë pastorale të përqendruar në nevojën për të bërë një jetë të krishterë, që përfshin të punuarit fort pa e trajtuar ardhjen e dytë e të shumëpritur të Krishtit si një justifikim për dembelizëm.[127]

### SKICIMI:

I. Inkurajim në Përndjekje (1)
II. Shpjegim i Ditës së Zotit (2)
III. Nxitje për Gatishmëri (3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

### TEMA:

Ngushëllim e Korrigjim

### KAPITUJT KYÇË:

2 Përpara Ditës së Zotit – braktisja e besimit dhe antikrishti (i paudhi) do të vijë për të mashtruar botën.
3 Nxitje për të qenë të zellshëm nën dritën e Ditës së Zotit, që po afrohet.

- Përse “ngushëllim e korrigjim” është tema e duhur për letrën e Dytë drejtuar Selanikasve?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Selanikasve.
- Lexoni gjithë letrën e Dytë drejtuar Selanikasve.

[127] Chrispin, *The Bible Panorama*, 520–21.

## 1 TIMOTEUT

Pali, apostulli i moshuar e me përvojë, i shkruan pastorit të ri Timote, i cili po përballej me një barrë të rëndë përgjegjësie në kishën e Efesit. Detyra është sfiduese: të hiqen doktrinat e rreme, të mbrohet adhurimi publik e të zhvillohen udhëheqës të pjekur. Përveç qëndrimit të kishës, Pali vë theksin edhe te qëndrimi i shërbestarit. Timoteu duhet të bëjë kujdes duke mos lejuar që mosha e tij e re t'i bëhet pengesë, përkundrazi t'i bëhet mjet i vlefshëm për ungjillin. Ai duhet të ketë kujdes që të shmanget nga mësuesit e rremë dhe nga lakmia, duke i rënë pas drejtësisë, perëndishmërisë, besimit, dashurisë, këmbënguljes dhe zemërbutësisë si njeri i duhur i Perëndisë.[128]

### SKICIMI:

I. Për Timoteun (1-3)
II. Timoteut për kishën (4-6)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni secilin nga kapitujt kyçë.

**TEMA:** Një Manual për Jetën e Kishës

### KAPITUJT KYÇË:

2 Detyra e burrave për t'u lutur në adhurim publik; roli i grave në adhurimin publik
3 Cilësitë e pleqve; cilësitë e dhjakëve; qëllimi i letrës
5 Detyra për të rinjtë, të vejat, pleqtë

- Përse "një manual për jetën e kishës" është tema e duhur për letrën e Parë drejtuar Timoteut?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Timoteut.
- Lexoni gjithë letrën e Parë drejtuar Timoteut.

[128] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 426.

## 2 TIMOTEUT

2 Timoteut vazhdon disa nga temat e 1 Timoteut dhe merret kryesisht me nevojën për të qenë i guximshëm e besnik, dhe inkurajimin për të shërbyer e për të dhënë mësim me besnikëri, pasi mësuesit e rremë po e zgjerojnë ndikimin e tyre të pa perëndishëm. Marrëdhënia e ngushtë e Palit me Timoteun është e dukshme, ndërkohë që ai thekson nevojën për të studiuar Fjalën e Perëndisë, për të qëndruar besnik e për të qenë i ndërgjegjshëm që "ditët e fundit" do të sjellin ligësi dhe errësirë shpirtërore dhe morale. Pali sheh vdekjen e tij të afërt dhe i jep udhëzimet dhe dëshminë e tij përfundimtare djaloshit që ka marrë në ngarkim (çirakut).[129]

### SKICIMI:

I. Udhëzime për Betejë Shpirtërore (1-3)
II. Përfundim i Betejës Shpirtërore (4)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni kapitullin kyç.

**TEMA:** Shërbesa si Betejë Shpirtërore

### KAPITULLI KYÇ:

3 Rreziku dhe mbrojtja nga braktisja e besimit (apostazia)

- Përse "shërbesa si betejë shpirtërore" është tema e duhur për letrën e Dytë drejtuar Timoteut?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Timoteut.
- Lexoni gjithë letrën e Dytë drejtuar Timoteut.

[129] Chrispin, *The Bible Panorama*, 527.

## TITIT

Titi, një shërbestar i ri, është lënë nga Pali në ishullin e Kretës për të nisur detyrën sfiduese të organizimit të besimtarëve të rinj nëpër kisha lokale. Në këtë letër, Pali ndan me Titin urtësi praktike përsa i përket organizimit dhe administrimit të kishës. Udhëheqësit duhen zgjedhur bazuar mbi karakterin dhe sjelljen e sprovuar; mësuesit e rremë duhen dalluar e larguar sa më shpejt nga kisha; anëtarët e kishës, të çfarëdo moshe qofshin, duhen inkurajuar të bëjnë jetë të denjë për ungjillin në të cilin thonë se besojnë. Të rinj e të moshuar, udhëheqës e njerëz të thjeshtë, të gjithë duhet të shfaqin realitetin e besimit të tyre duke treguar kujdes e përkushtim "për vepra të mira" (3:8).[130]

### SKICIMI:

I. Si Udhëheqës (1)
II. Në Kishë (2)
III. Në Botë (3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

### TEMA: Pasion për Doktrinën e Perëndisë

- Përse "pasion për doktrinën e Perëndisë" është tema e duhur për letrën drejtuar Titit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Titit.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Titit.

[130] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible*, 437.

## FILEMONIT

Filemoni ishte shpëtuar për shkak të shërbesës së Palit... disa vite më parë. Duke qenë mjaft i pasur sa për të patur një shtëpi të madhe... Filemoni kishte nën zotërim të paktën edhe një skllav, një burrë të quajtur Onesim... Onesimi nuk ishte besimtar në kohën kur vodhi disa para (v. 18) nga Filemoni dhe ia mbathi... Përmes disa rrethanave që nuk jepen në Shkrim, Onesimi takoi Palin në Romë dhe u bë i krishterë... Me vjedhjen dhe largimin e tij prej Filemonit, Onesimi kishte thyer ligjin romak dhe kishte mashtruar edhe zotërinë e tij. Pali e dinte që këto çështje duheshin trajtuar, ndaj vendosi të dërgonte Onesimin... Me Onesimin, Pali i dërgoi Filemonit këtë letër të bukur personale, përmes së cilës e nxiste atë që ta falte Onesimin e ta mirëpriste sërish për të shërbyer si një vëlla në Krishtin.[131]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Lutje | (v. 1-7) |
| II. | Kërkesë | (v. 8-16) |
| III. | Premtim | (v. 17-25) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Manual për Faljen

- Përse “manual për faljen” është tema e duhur për letrën drejtuar Filemonit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Filemonit.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Filemonit.

[131] MacArthur, *The MacArthur Study Bible*, 1890.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Filipianëve?
    - Cila është tema e 1 Selanikasve?
    - Çfarë jepet tek 1 Timoteut 3?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri tek Efesianëve.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni me vëmendje deklaratën doktrinale të kishës suaj dhe përgjigjuni pyetjeve koresponduese.
- Përgjigjuni pyetjeve mbi "Mbrojtjen e Doktrinës së Shëndoshë".
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – ESKATOLOGJI

> **Titit 2:13**
> ...duke pritur shpresën e lume dhe ardhjen e lavdisë së Perëndisë madhështor dhe shpëtimtarit tonë Jezu krisht.

**Eskatologjia** është studimi i doktrinës së gjërave të fundit.

Disa nga çështjet dhe temat kyçe që trajtohen në eskatologji janë:

- Vdekja
- Parajsa
- Ferri
- Koha dhe Natyra e Ngjarjeve të Ardhshme
  - Rrëmbimi në Qiell
  - Gjykimi nga Froni i Ngritur
  - Mundimet
  - Ardhja e Dytë e Krishtit
  - Mbretëria Mijëvjeçare
  - Gjykimi i Fronit të Madh të Bardhë
  - Qiej të Rinj dhe Tokë e Re

- Lexoni pjesën e deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e gjërave të fundit.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen në të?

  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat që vijnë nëse keqkuptohen apo neglizhohen këto të vërteta?

  - Çfarë pyetjesh keni për të vërtetat që përmenden në të?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Lexoni kapitujt rreth eskatologjisë në teologjinë sistematike.

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

**JEPNI NJË LINJË BAZË KOHORE TË NGJARJEVE TË KOHËVE TË FUNDIT.**

- **Pasazhe kyçë për t'u marrë në konsideratë:**
  - Danieli 9:24-27
  - Mateu 24-25
  - 1 Selanikasve 4:13-17
  - Zbulesa 19-21

> **Pal Enns në *Manuali Mudi i Teologjisë***
> ***Rrëmbimi***. Termi rrëmbim vjen i përkthyer nga latinishtja, te 1 Selanikasve 4:17 dhe ka kuptimin "të kapur". Për rrëmbimin, i cili dallohet si tjetër ngjarje nga ardhja e dytë e Krishtit, mësojmë te Gjoni 14:1-3; 1 Korintasve 15:51-57; 1 Selanikasve 4:13-18. Përpara ardhjes së mundimeve, Krishti do të zbresë nga qielli, do ta marrë (kapë, rrëmbejë) kishën me vete, ndërkohë që mundimet do të lëshohen mbi botën mosbesuese dhe të pa penduar...
>
> ***Mundimet***. Mundimet janë java e shtatë e Danielit (Dan. 9:24-27), një javë që sipas terminologjisë së profetit është e barabartë me shtatë vite...
> Mundimet do të përfshijnë gjykimin e Perëndisë përmbi botën mosbesuese, sikurse përshkruhen me detaje te Zbulesa 6-19. Seria e njëpasnjëshme e vulave, trumbetave dhe kupave të gjykimit te Zbulesa japin detaje të gjykimit të Perëndisë ndaj jobesimtarëve, duke kulmuar me kthimin triumfues të Krishtit së bashku me Nusen e Tij, Kishën, në tokë (Zbu. 19:11-21)...
>
> ***Ardhja e dytë e Krishtit.*** Në përfundim të mundimeve, Krishti do të kthehet fizikisht në tokë (Zak. 14:4) për të dhënë gjykimin dhe për të inaguruar mbretërinë mijëvjeçare (Zak. 14:9-21; Mat. 25:31; Zbu. 20:4)...
>
> ***Mbretëria mijëvjeçare.*** Kur Krishti të kthehet në tokë, Ai do të vendoset Mbret në Jeruzalem, duke u ulur në fronin e Davidit (Luka 1:32-33). Besëlidhjet e pakushtëzuara kërkojnë një rikthim fizik të Krishtit për të vendosur mbretërinë...
> Në fund të mijëvjeçarit, të vdekurit e pa shpëtuar në gjithë brezat do të ringjallen e do të gjykohen në fronin e madh të bardhë. Ata do të dënohen e do të flaken në liqenin e zjarrit, vendbanimin e tyre përfundimtar (Zbu. 20:11-15). Po ashtu edhe Djalli, Bisha (Antikrishti) dhe Profeti i Rremë do të flaken në liqenin e zjarrit (Zbu. 20:10).
>
> ***Gjendja e përjetshme.*** Pas mijëvjeçarit, do të gjykohen edhe toka dhe qiejt (2 Pjetrit 3:10), për shkak se ato ishin fusha e rebelimit të Satanit kundër Perëndisë. Në skenë do të vijë gjendja e përjetshme (Zbu. 21-22), vendbanimi i gjithë të shpenguarve (Heb. 12:22-24), do të vendoset (Zbulesa 21–22).[132]

- Jepni me fjalët tuaja një linjë bazë kohore të ngjarjeve të kohëve të fundit.

[132] Enns, *The Moody Handbook of Theology*, 418–25.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi atë pjesë të deklaratës doktrinale të kishës suaj që flet për doktrinën e gjërave të fundit dhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve që lidhen me të.
2. Praktikohuni t'i përgjigjeni kërkesës së mëposhtme:
    - Jepni një linjë bazë kohore për ngjarjet e kohëve të fundit.
3. Rishikoni pyetjet e mëposhtme:
    - Si do ta përkufizonit pagabueshmërinë e Shkrimit?
    - Si do ta përkufizonit Trininë?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
    - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
    - Cilat janë qëllimet e kishës?
    - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?
    - Çfarë duhet të bëjë dikush që të shpëtohet? A është thelbësor pendimi, për kthimin në besim?
    - Shpjegoni se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.
    - Si e përkufizoni doktrinën e përzgjedhjes?
    - Si e përkufizoni doktrinën e ripërtëritjes?
    - Si e përkufizoni doktrinën e shfajësimit?
    - Si e përkufizoni doktrinën e shenjtërimit?
    - Si e përkufizoni doktrinën e ngritjes në lavdi?
    - Si e përkufizoni doktrinën e sigurisë së përjetshme?

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Martin Lloid-Xhons**
> Ju sfidoj të lexoni jetën e çdo shenjtori që ka zbukuruar jetën e Kishës pa dalluar menjëherë që karakteristika më e madhe në jetën e tyre ka qenë disiplina dhe rregulli. Përherë këto karakteristika kanë qenë universale për të dalluar gjithë burrat dhe gratë e Perëndisë... Të gjithë e kanë disiplinuar jetën e tyre dhe kanë këmbëngulur në nevojën për të vepruar kështu; duket qartë që kjo gjendet përgjatë gjithë Shkrimit dhe është absolutisht thelbësore.[133]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësinë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Mikpritës**

  **1 Timoteut 3:2** Peshkopi duhet të jetë i patëmetë... mikpritës...

  **Titit 1:7-8** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... por ai duhet të jetë mikpritës...

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni Romakëve 12:13, 1 Pjetrit 4:9 dhe Hebrenjve 13:2. Përse duhet që mikpritja të karakterizojë jetën e gjithë besimtarëve dhe jo vetëm atë të udhëheqësve?

[133] D. Martyn Lloyd-Jones, *Spiritual Depression* (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1965), 210.

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Çfarë mundësish keni për të shfaqur mikpritje ndaj:
    - të huajve?
    - personave në kishën tuaj?
3. Përse është kaq shumë e rëndësishme mikpritja si një aspekt i shërbesës ndaj të tjerëve?
4. Përse mund t'i shohësh fëmijët shumë lehtë si një pengesë ndaj mikpritjes? Si mund të mbroheni nga ky mendim? Si mund t'i përfshini fëmijët tuaj ndërsa praktikoni mikpritjen?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë disiplinën e mëposhtme shpirtërore, e cila duhet të karakterizojë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

## FRYMËZIM PREJ BIBLËS

- **LEXIM**
- **STUDIM**
- **MËSIM PËRMENDËSH**
- **MEDITIM**

> **Donëld Uitni**
> Asnjë disiplinë shpirtërore nuk është më e rëndësishme se frymëzimi nga Fjala e Perëndisë. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë dot atë. Thjesht, nuk ka jetë të shëndetshme të krishterë pa dietën ushqimore me qumështin dhe mishin e Shkrimit... Prandaj, nëse dëshirojmë ta njohim Perëndinë e të jemi të perëndishëm, atëherë duhet ta njohim sa më mirë e në mënyrë intime Fjalën e Perëndisë.[134]

- Si jeni rritur në praktikën e frymëzimit të rregullt prej Biblës gjatë muajve të fundit?

- Përse ka rëndësi frymëzimi i rregullt prej Biblës, për rritjen dhe pjekurinë tuaj shpirtërore?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Çfarë keni mësuar këto kohët e fundit nga leximi dhe studimi i Biblës?
3. Cilat vargje keni mësuar përmendësh dhe mbi cilat keni meditуar këto kohë? Si ka ndikuar kjo gjë në jetën tuaj të krishterë?

[134] Whitney, *Spiritual Disciplines for the Christian Life*, 28.

# Kapitulli 10

## TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE: TË LUTEMI PËR TË TJERËT**

## TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

- **SHQYRTIM BIBLIK**
  - **Hebrenjve:** Superioriteti i Krishtit
  - **Jakobit:** Rezultatet e Besimit të Vërtetë Shpëtues
  - **1 Pjetrit:** Të Qëndroni të Patundur Përgjatë Vuajtjeve
  - **2 Pjetrit:** Krishtërimi i Vërtetë dhe i Rremë
  - **1 Gjonit:** Sprovat e Jetës së Përjetshme
  - **2 Gjonit:** Mikpritja e Krishterë dhe Mësuesit e Rremë
  - **3 Gjonit:** Mikpritja e Krishterë dhe Shërbyesit Besnikë
  - **Juda:** Kujdes nga Pretenduesit
  - **Zbulesa:** Zbulesa e Jezu Krishtit

- **TEOLOGJI SISTEMATIKE**
  - **Të kuptojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Veçoritë Dalluese Doktrinale të Kishës Suaj
  - **Të mbrojmë doktrinën e shëndoshë:**
    - Përsëritje

## TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

- **PJEKURI SHPIRTËRORE:**
  - Të Dëshironi të Mirën
  - Të Drejtë
  - Të Devotshëm

- **DISIPLINË SHPIRTËRORE:**
  - Përsëritje

# SEKSIONI 1:
# TË KUPTOJMË UDHËHEQJEN BIBLIKE

## SHËRBIMI NDAJ TË TJERËVE: TË LUTEMI PËR TË TJERËT

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Shumë njerëz e lidhin udhëheqjen me aftësinë për të parë. Udhëheqësit ose bëjnë sehir, ose veprojnë qysh më parë. Ndërkohë që kjo është shpesh e vërtetë, disa nga shërbesat më të mëdha të udhëheqësve biblikë nuk mund të shihen apo as të njihen fare nga të tjerët. E tillë është shërbesa e lutjes për të tjerët.

> **J. Osvald Sendërs**
> Udhëheqësit e mëdhenj të Biblës ishin të mëdhenj në lutje.135

> **Donëld Uitni**
> Burrat dhe gratë e Perëndisë janë gjithnjë burra dhe gra të lutjes.136

Moisiu e kërkoi besnikërisht Zotin dhe ndërhyri në lutje për popullin (Eksodi 33:12-19, Numrat 21:7). Samueli ishte i përkushtuar ta drejtonte popullin në rrëfimin e mëkateve dhe u lut për hatrin e tyre (1 Samueli 7:3-5). Davidi kërkoi rregullisht Zotin për mbrojtje dhe për ndihmë (p.sh. Psalmi 17, 86), ia hapi Atij zemrën e vet adhuruese në lutje (p.sh. Psalmi 145) dhe shkroi psalme të panumërta për ta udhëhequr popullin që të bënte të njëjtën gjë. Danieli u lut rregullisht, edhe kur kjo gjë kishte kosto të lartë për të (Danieli 6:10) dhe reagoi me lutje ndaj fjalës së Perëndisë (Danieli 9:1-3). Ezra e drejtoi popullin në lutje për mbrojtje (Ezra 8:21) dhe për rrëfim (Ezra 9:5-15). Nehemia u lut për hatër të popullit dhe që Perëndia i hirshëm t'u siguronte sukses (Nehemia 1:4-11). Pali nuk pushonte së luturi për të tjerët (p.sh. Filipianëve 1:4; Kolosianëve 1:3). Madje edhe Vetë Zoti ynë, Perëndia i mishëruar, bëri një jetë lutjesh.

> **J. Osvald Sendërs**
> Udhëheqësi i krishterë, i cili kërkon të ndjekë një model, bën mirë të kthehet te jeta e Vetë Jezu Krishtit. Besimi ynë mbi domosdoshmërinë e lutjes vjen nga vëzhgimi i jetës së Tij. Sigurisht që nëse dikush ka një jetë të qëndrueshme pa lutje, Ai do të ishte Vetë Biri i Perëndisë. Nëse lutja do të ishte e panevojshme apo një idiotësi, Jezui nuk do ta kishte humbur kohën kot në të. Mos u ngutni! Lutja ishte veçoria mbizotëruese e jetës së Tij dhe një pjesë e ripërsëritur e mësimeve që dha Ai.[137]

Udhëheqësit biblikë luten. Ata do të luten si një akt adhurimi. Ata do të luten për të rrëfyer mëkatin. Ata do të luten për urtësi, mbrojtje dhe sigurim. Ata do të luten edhe për të tjerët. Udhëheqësit biblikë do të jenë besnikë t'u shërbejnë të tjerëve përmes lutjeve ndërmjetësuese.

---

[135] Sanders, *Spiritual Leadership,* 92.
[136] Whitney, *Spiritual Disciplines for the Christian Life,* 82.
[137] Sanders, *Spiritual Leadership*, 86–87.

## SHËRBESA JETËSORE E LUTJES

Sa herë jeni shprehur apo keni dëgjuar dikë të thotë: “Do të lutem, por a mund të bëj ndonjë gjë tjetër për të të ndihmuar?”, apo “Do të doja të bëja më shumë sesa thjesht të lutem”?

Patjetër që është gjëja e duhur që besimtarët të jenë të etur ta duan njëri-tjetrin në mënyra shumë praktike, prandaj edhe kërkojnë mundësi që të kujdesen konkretisht për njëri-tjetrin. Megjithatë, shpesh thënie të tilla, apo të ngjashme me to, nxjerrin në pah mendimet që zvogëlojnë rëndësinë e lutjes për njëri-tjetrin, kur në fakt lutja është një aspekt jetësor i shërbesës ndaj të tjerëve.

Shkrimet e mëposhtme nxisin gjithë besimtarët për t’u lutur për njëri-tjetrin.

> **Romakëve 12:10-12**
> Duajeni njëri-tjetrin si vëllezër... këmbëngulni në lutje...

> **Efesianëve 6:18-19**
> Lutuni në çdo kohë dhe drejtojani kërkesat tuaja Perëndisë, të udhëhequr nga Shpirti. Prandaj rrini zgjuar e këmbëngulni në lutjet tuaja për të gjithë të shenjtët. Lutuni edhe për mua, që Perëndia të më japë fjalët e duhura kur të hap gojën për të predikuar me guxim të fshehtën e ungjillit.

> **Kolosianëve 4:2-3**
> Këmbëngulni e rrini zgjuar në lutje, duke falënderuar Perëndinë. Lutuni edhe për ne, që Perëndia të na japë mundësi të tjera për të predikuar të fshehtën për Krishtin, për të cilin jam në burg.

> **2 Selanikasve 3:1**
> Së fundi, o vëllezër, lutuni për ne, që fjala e Zotit të përhapet e të përlëvdohet ashtu siç ndodhi edhe mes jush.

> **Jakobi 5:16**
> Rrëfejani mëkatet njëri-tjetrit dhe lutuni për njëri-tjetrin, që të shëroheni. Lutja e të drejtit ka fuqi të madhe!

Duke kuptuar pamjaftueshmërinë e tyre për të ndryshuar zemrat, udhëheqësit e perëndishëm i japin përparësi këtij elementi kyç të shërbesës ndaj të tjerëve. Te Veprat e Apostujve 6, apostujt dalluan nevojën për një shërbesë më të gjerë e më të mirë ndaj vejushave. Ndërkohë që punuan me zell për të parë plotësimin e kësaj nevoje, ata nuk lejuan që kjo nevojë t’i pengonte ata për shërbesën e fjalës dhe të lutjes (Veprat e Apostujve 6:4).

Pali ishte i përkushtuar pas udhëtimeve, predikimeve dhe shkrimit të letrave për të ndikuar perandorinë romake me ungjillin e për të forcuar kishat e reja. Sidoqoftë, ai e kuptoi se, pavarësisht se ku gjendej, mund t’u shërbente gjithnjë me besnikëri kishave duke u lutur për to.

> **Filipianëve 1:4**
> Në çdo lutje që bëj, gjithmonë, lutem me gëzim për ju të gjithë...

> **Kolosianëve 1:3**
> E falenderojmë Perëndinë, Atin e Zotit tonë Jezu Krisht, sa herë lutemi për ju...

> **1 Selanikasve 1:2**
> E falenderojmë gjithmonë Perëndinë për ju të gjithë dhe ju përmendim pa pushim në lutjet tona.

Udhëheqësit biblikë duhet të jenë si Epafrai, "që është shërbëtor i Krishtit Jezu. Ai lutet gjithnjë për ju..." (Kolosianëve 4:12).

## PENGESAT E ZAKONSHME NDAJ LUTJES

Ndërkohë që çdo besimtar që e ka lexuar Biblën e kupton disi rëndësinë e lutjes, J. Osvald Çembërs pranon realitetin që "Disa herë ne japim premtime boshe ndaj kënaqësisë dhe fuqisë së lutjes. E quajmë të domosdoshme, e dimë që Shkrimi bën thirrje për lutje, megjithatë, shpesh dështojmë të lutemi."[138]

Çfarë i pengon besimtarët, por sidomos ata që janë në udhëheqje, që të luten siç duhet? Shpesh, besimtarët kanë synime të mira për t'u lutur, por **shqetësimet e jetës e të mendjes** i pengojnë ata që të kenë kohë të rregullta lutjesh. Disiplina për të patur kohë dhe vende të rregullta për t'u lutur, sikurse ishte edhe modeli i Krishtit (Marku 1:35; Luka 5:16), është jetësore për të qëndruar të vendosur në lutje, duke ditur që gjithçka bërtet fort për të marrë vëmendjen dhe kohën e udhëheqësve. Ata që shpërqendrohen gjatë lutjes mund të luten me zë të lartë, të citojnë Shkrimin, t'i shkruajnë lutjet në ditar, apo të ecin e shëtisin duke u lutur.

Po ashtu, udhëheqësit mund ta kenë të vështirë të luten për shkak të gjërave që kemi në zemër. Shpesh mungesa e lutjes rrjedh nga një *zemër krenare*, pasi nuk e kuptojmë si duhet varësinë dhe nevojën që kemi për Zotin dhe hirin e Tij. *Mungesa e dashurisë për të tjerët,* shpesh për shkak të hidhërimit, i pengon lutjet tona për ta dhe për të tjerët. Lutja për të tjerët është një nga mënyrat më të mira për të zbutur zemrën tonë ndaj tyre. Po ashtu, përqendrimi te vetvetja dhe te çështjet e jetës personale na pengojnë të lutemi për të tjerët. Ndonjëherë dështojmë të lutemi pasi na *mungon besimi*. Mendimet që Perëndia është i largët apo nuk kujdeset për ne na pengojnë t'i paraqesim Atij kërkesat tona. Mund të dyshojmë në mirësinë apo urtësinë e Perëndisë ndaj edhe hezitojmë t'i dorëzohemi vullnetit të Tij. Në të njëjtën mënyrë edhe *mëkati i pa rrëfyer* i pengon besimtarët të luten dhe e shkatërron miqësinë tonë me Perëndinë.

Gjithashtu, **pështjellimi e paqartësia teologjike** mund t'i pengojë besimtarët të luten. Besimtarët e orientuar gabim mund të lejojnë që besimi i tyre në sovranitetin e Perëndisë t'i çojë ata në neglizhim të përgjegjësive tona biblike, përfshirë edhe lutjen. Në të vërtetë, Perëndia është si Sovran ashtu edhe reagues ndaj lutjeve. Edhe pse si njerëz ne nuk mund ta konceptojmë dot plotësisht këtë gjë, udhëheqësi biblik e beson dhe jeton nën dritën e saj.

> D. A. Karson
> Bibla këmbëngul që ne të lutemi, na shtyn të lutemi, na jep edhe shembuj lutjesh. Atëherë, nëse arsyetimi ynë na çon larg lutjeve, diçka nuk shkon si duhet me të; pra, nëse teologjia jonë na dekurajon të lutemi, atëherë në të ka diçka të gabuar.[139]

- Cilat janë pengesat më të mëdha ndaj lutjes në jetën dhe në zemrën tuaj?

[138] Sanders, *Spiritual Leadership*, 85.
[139] D. A. Carson, *A Call to Spiritual Reformation* (Grand Rapids, MI: Baker, 1992), 147.

## FOKUSI SHPIRTËROR I LUTJES

- Çfarë lloj kërkesash për lutje ndajnë zakonisht njerëzit me njëri-tjetrin në kishën tuaj?

Sigurisht që është gjë e mirë të lutemi për çështje fizike, si p.sh. për mbrojtje dhe siguri gjatë udhëtimit (Ezra 8:21), apo shërim nga ndonjë sëmundje apo dëmtim (Numrat 12:13; Jakobi 5:16). Por kur lutemi me një lente biblike, fokusi i lutjeve tona për të tjerët duhet të shkojë përtej gjërave fizike dhe të përkohshme. Do ta falenderojmë Perëndinë për gjërat që po bën në ta dhe nëpërmjet tyre dhe do të lutemi për shërbesën dhe për rritjen e tyre shpirtërore. Nuk ka shembull më të mirë për këtë sesa lutjet e Palit të regjistruara për ne në Shkrim.

Lexoni me kujdes shembujt e mëposhtëm nga lutjet e Palit. Qarkoni arsyet që Pali falenderoi për të tjerët. Nënvizoni kërkesat që bëri ai për hatrin e të tjerëve.

> **Romakëve 1:8-10**
> Së pari, e falënderoj Perëndinë tim përmes Jezu Krishtit për ju të gjithë, sepse besimi juaj po bëhet i njohur në tërë botën. Perëndia, të cilit i shërbej me gjithë shpirt në predikimin e ungjillit të Birit të Tij, është dëshmitari im se ju kujtoj pa pushim në lutjet e mia, gjithmonë. I kërkoj Perëndisë, që, nëse është vullneti i Tij, të mund të vij te ju më në fund.

> **Romakëve 15:5-6**
> Perëndia i durimit e i ngushëllimit dhëntë që ju të jeni në një mendje me njëri-tjetrin sipas Krishtit Jezu, në mënyrë që, një mendjeje e njëzëri, të përlëvdoni Perëndinë dhe Atin e Zotit tonë Jezu Krisht.

> **1 Korintasve 1:4-8**
> E falënderoj Perëndinë tim gjithnjë për ju, që ju dha hirin e Tij me anë të Jezu Krishtit. Ai ju pasuroi në gjithçka, në çdo fjalë e në çdo dije. Kështu, dëshmia për Krishtin u përforcua aq shumë ndër ju, saqë nuk ju mungon asnjë dhunti, ndërkohë që prisni ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht. Ai do t'ju mbajë të fortë deri në fund, që të jeni të paqortueshëm në Ditën e Zotit tonë Jezu Krisht.

> **Efesianëve 1:15-19**
> Prandaj edhe unë, që kur dëgjova për besimin tuaj në Zotin Jezu dhe për dashurinë që keni për të gjithë të shenjtët, nuk resht së falënderuari Perëndinë për ju, duke ju përmendur në lutjet e mia. Perëndia i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i lavdisë, ju dhëntë Shpirtin e urtisë, që do t'ju zbulojë si ta njihni plotësisht Atë. Ai ju ndriçoftë sytë e zemrave tuaja, që të njihni se cila është shpresa për të cilën ju thirri, sesa e pasur dhe e lavdishme është trashëgimia e Tij për të shenjtët dhe sesa madhështore dhe e pashoqe është fuqia e Tij ndaj nesh që besojmë në Të...

**Efesianëve 3:14-19**
Prandaj unë bie në gjunjë para Atit, prej të cilit merr jetë çdo krijesë në qiej e në tokë. Perëndia ju dhëntë, sipas pasurive të lavdisë së Tij e përmes Shpirtit të Tij, ju bëftë më të fortë shpirtërisht. Krishti banoftë në zemrat tuaja përmes besimit, në mënyrë që të rrënjosur e të themeluar në dashuri, të mund të kuptoni bashkë me të gjithë të shenjtët se cila është gjerësia, gjatësia, lartësia e thellësia e dashurisë së Krishtit. Lutem që të njihni dashurinë e Krishtit, e cila tejkalon çdo dije, që të mbusheni me gjithë plotësinë e Perëndisë.

**Filipianëve 1:3-5, 9-11**
E falënderoj Perëndinë tim sa herë ju kujtoj. Në çdo lutje që bëj, gjithmonë, lutem me gëzim për ju të gjithë, për pjesëmarrjen tuaj në dobi të ungjillit nga dita e parë deri tani. ...Unë lutem që dashuria juaj të rritet gjithnjë e më shumë e të pasurohet me dije e me aftësi për të kuptuar, që të jeni në gjendje të dalloni më të mirën dhe të jeni të dëlirë e të pafajshëm në ditën e ardhjes së Krishtit, të mbushur plot me frytet e drejtësisë që vijnë prej Jezu Krishtit, për lavdinë e lavdërimin e Perëndisë.

**Kolosianëve 1:3-5**
E falënderojmë Perëndinë, Atin e Zotit tonë Jezu Krisht, sa herë lutemi për ju, sepse kemi dëgjuar për besimin tuaj në Krishtin Jezu dhe për dashurinë që keni për të gjithë të shenjtët. Këtë besim e këtë dashuri e keni për shkak të shpresës që ju pret në qiej, për të cilën keni dëgjuar më parë në predikimin e të vërtetës së ungjillit.

**Kolosianëve 1:9-12**
Prandaj edhe ne, që nga dita kur e morëm vesh këtë gjë, nuk reshtim së luturi për ju dhe i kërkojmë Perëndisë t'ju japë urtinë e mençurinë shpirtërore që ta njihni plotësisht vullnetin e Tij. Kështu do të mund të bëni një jetë të denjë për Zotin dhe, ashtu si i pëlqen Atij, duke dhënë fryt në çdo vepër të mirë e duke shtuar njohuritë për Perëndinë. Ju do të forcoheni me fuqinë që vjen nga pushteti i lavdishëm i Perëndisë, që të përballoni gjithçka me durim e që me gëzim të falënderoni Atin që ju bëri të denjë të keni pjesën tuaj në trashëgiminë e të shenjtëve në dritë.

**1 Selanikasve 3:9-13**
Me çfarë fjalësh mund ta falënderojmë Perëndinë pas gjithë atij gëzimi që na dhatë para Tij? Ne i lutemi me gjithë zemër Perëndisë, natë e ditë, që t'ju shohim nga afër dhe të plotësojmë ato që ende i mungojnë besimit tuaj. Vetë Perëndia, Ati ynë dhe Zoti ynë Jezu na drejtofshin udhën për te ju! Zoti e shtoftë dhe bëftë që të teprojë dashuria juaj për njëri-tjetrin dhe për të gjithë, ashtu siç është edhe dashuria jonë për ju! Ai i forcoftë zemrat tuaja, që ju të jeni të shenjtë dhe të paqortueshëm para Perëndisë dhe Atit tonë kur Zoti ynë Jezu të vijë bashkë me të gjithë të shenjtët e Tij! Amen!

**1 Selanikasve 5:23-24**
Vetë Perëndia i paqes ju shenjtëroftë plotësisht dhe gjithë qenia juaj, shpirt, mendje e trup qoftë e paqortueshme kur të vijë Zoti ynë Jezu Krisht. Perëndia që ju thirri është besnik dhe do ta bëjë atë që ka thënë.

> **2 Selanikasve 1:3, 11-12**
> Ne duhet ta falënderojmë gjithnjë Perëndinë për ju, o vëllezër, dhe kjo është e drejtë, sepse besimi juaj po rritet shumë dhe dashuria e secilit prej jush për njëri-tjetrin po shtohet. ...Ne lutemi gjithnjë për ju, që Perëndia t'ju bëjë të denjë për të përmbushur thirrjen e Tij dhe që me fuqinë e Tij të arrini çdo qëllim të mirë e të përsosni çdo vepër të besimit tuaj. Kështu, emri i Zotit tonë Jezu do të përlëvdohet prej jush dhe ju do të përlëvdoheni prej Tij, sipas hirit të Perëndisë tonë dhe të Zotit Jezu Krisht.

> **Filemonit 4-6**
> E falënderoj Perëndinë tim gjithmonë kur të kujtoj në lutjet e mia, sepse po dëgjoj për dashurinë tënde për të gjithë të shenjtët dhe për besimin që ke në Zotin Jezu Krisht. I lutem Perëndisë që besimi që na bashkon të jetë i gjallë në ty, për të njohur çdo gjë të mirë që kemi e që na çon drejt Krishtit.

- Si ju ndihmojnë lutjet e Palit për t'ju dhënë në arsyetim më të gjerë mbi mënyrën se si duhet të luteni për të tjerët?

- Cilat janë disa përparësi specifike biblike që mund të luteni për...
  - ata që po përballen me rrethana të vështira?

  - ata që kanë mundësi të ndërveprojnë me jobesimtarë (familjarë në kohë pushimesh, bashkëpunëtorë, fqinjë, etj.)?

  - çdo besimtar?

## PRAKTIKA E RREGULLT E LUTJES

Udhëheqësit biblikë duhet t'i japin përparësi lutjes së rregullt për personat që ata udhëheqin. Edhe pse detajet specifike mbi mënyrën se si realizohet kjo gjë padyshim që do të jenë të ndryshme mes udhëheqësve të perëndishëm, realiteti i saj nuk ndryshon. Një praktikë e tillë lutjesh të rregullta duhet planifikuar. Ndërkohë që udhëheqësit mund të ndalojnë përkohësisht lutjet që bëjnë vetë apo me të tjerët, në bazë të nevojave që lindin, sërish ata duhet të planifikojnë kohë të rregullta për lutje të qëllimshme.

> **D. A. Karson**
> Nuk para jepemi pas jetës shpirtërore; nuk jepemi lehtë as pas lutjeve të disiplinuara. Nuk kemi për t'u rritur drejt lutjeve nëse nuk planifikojmë të lutemi. Kjo do të thotë që duhet të guxojmë e të ndërmarrim hapin për të lënë mënjanë një kohë për të mos bërë asgjë tjetër veçse të lutemi.[140]

- Çfarë kohe keni aktualisht, apo planifikoni të keni, të veçantë për lutje?

- Çfarë plani keni bërë, apo do të filloni të vini në përdorim, për të mbajtur shënime mbi nevojat e të tjerëve në mënyrë që të mund të luteni rregullisht për ta?

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni mbi secilën nga pyetjet e studimit të mësipërm.
2. Si ju ka ndihmuar praktikisht ky kapitull në lutjet tuaja për të tjerët?
3. Si shpërndahen kërkesat për lutje në kishën apo në shërbesat në të cilat jeni të përfshirë?
4. Kaloni kohë duke u lutur së bashku.

[140] Carson, *A Call to Spiritual Reformation,* 19.

# SEKSIONI 2:
# TË THELLOJMË NJOHURITË RRETH UDHËHEQJES BIBLIKE

Për t'u bërë udhëheqës biblik i kishës kërkohet më shumë se vetëm marrje njohurish, edhe pse kjo nevojitet patjetër. Një udhëheqës besnik e i perëndishëm në një kishë lokale duhet të ketë njohuri të thella mbi Biblën dhe mbi doktrinat kyçe të saj, për të ndihmuar në rritjen e të tjerëve në besim si edhe në mbrojtjen e së vërtetës.

> **Fjalët e Urta 9:9**
> Jepi këshilla të urtit e do të jetë edhe më i urtë. Mësoje të drejtin e do t'i shtohet mençuria.

> **Donald Uitni**
> Njerëzit e urtë e të drejtë nuk mund të përftojnë kurrë mjaftueshëm njohuri apo urtësi. Ata që janë kokëfortë e krenarë për ato që dinë tregojnë se sa të cekët janë në të vërtetë. Ata që janë vërtetë të urtë janë të përulur, sepse e dinë se kanë ende shumë gjëra për të nxënë.[141]

## SHQYRTIM BIBLIK

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Lexoni dhe merrni në konsideratë përmbledhjen dhe skicimin e çdo libri.
- Mësoni përmendësh temën dhe kapitujt kyçë të secilit libër.
- Lexoni kapitujt kyçë nga secili libër.
- Përgjigjuni pyetjeve për temën e secilit libër.
- Sipas dëshirës, plotësoni detyrat shtesë për "thellim të mëtejshëm".

[141] Whitney, *Spiritual Disciplines for the Christian Life*, 224–25.

## HEBRENJVE

Letra drejtuar Hebrenjve paralajmëron dhe nxit gjithë ata që qëndrojnë në kufijtë e shpëtimit që të hyjnë në të me anë të besimit në Krishtin, përndryshe do të përballen me gjykimin e Perëndisë. Ata që kanë hyrë tashmë në falje sigurohen për shpëtimin e tyre dhe inkurajohen të ngulmojnë. Hebrenjve na jep një analizë mahnitëse dhe frymëzuese të shpëtimit me anë të Krishtit, si edhe ilustron gjallërisht nevojën dhe ngushëllimin e besimit në Të dhe në premtimet e Perëndisë. Kjo letër përqendrohet vërtet te Krishti dhe te gjithë mësimet e Tij. Mendimi kyç është "më mirë". Vetë kjo shprehje përdoret dymbëdhjetë herë dhe nënkuptohet edhe shumë herë të tjera. Shpëtimi në Krishtin është shumë herë më i mirë se gjithçka në judaizëm, çka synonte të përgatiste e të drejtonte për te Krishti.[142]

## SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Superioriteti i Personit të Krishtit | (1-7) |
| II. | Superioriteti i Veprës së Krishtit | (8-10:18) |
| III. | Reagimi i Besimit është Këmbëngulja dhe Bindja | (10:19-13) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni kapitullin kyç.

**TEMA:** Superioriteti i Krishtit

## KAPITUJT KYÇË:

1 Krishti Biri është zbulesa e plotë e Perëndisë; lartësuar përmbi engjëjt, ulur në fron si Perëndi, në pritje të nënshtrimit të botës
3 Krishti është më i madh se Moisiu; kujdes nga zemra mosbesuese
5 Krishti, Kryeprifti dashamirës sipas urdhrit të Melkizedekut
6 Paralajmërim ndaj braktisjes së besimit; betimi i Perëndisë ndaj Abrahamit; shpresa jonë e sigurt përmes Krishtit
7 Priftëria e Melkizedekut më e lartë se ajo e pamjaftueshme e Aaronit; priftëria e Krishtit është e përjetshme
10 Flijimet e kafshëve janë të paefektshme; flijimi i Krishtit ka vlerë të përjetshme; hyrja te Perëndia garantohet në Krishtin, por ata që jepen në mëkat dënohen; lexuesit nevojitet që të ngulmojnë
11 Besimi: përkufizohet dhe ilustrohet
12 Disiplina atërore e Perëndisë; nevoja për shenjtërim; kontrasti mes malit Sinai dhe atij Sion
13 Jetesa e krishterë: dashuria, mikpritja, martesa, doktrina, bindja ndaj udhëheqësve; urime dhe bekime

- Përse "superioriteti i Krishtit" është tema e duhur për letrën drejtuar Hebrenjve?

## THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Hebrenjve.
- Lexoni gjithë letrën drejtuar Hebrenjve.

[142] Chrispin, *The Bible Panorama,* 533.

## JAKOBIT

Besimi pa vepra nuk mund të quhet besim. Ai është i vdekur dhe një besim i vdekur është më keq se mosbesimi. Besimi duhet të veprojë, duhet të prodhojë, duhet të jetë i dukshëm. Besimi verbal (vetëm me fjalë) nuk mjafton, besimi vetëm në mendje është i pamjaftueshëm. Besimi duhet të përparojë në veprim. Përmes letrës që u drejton besimtarëve judenj, Jakobi ndërthur besimin e vërtetë me përvojën e punëve të përditshme duke theksuar që besimi i vërtetë "vepron". Ai duron mundimet, i bindet Fjalës së Perëndisë, prodhon zbatues, nuk strehon paragjykim, kontrollon gjuhën, vepron me urtësi, siguron forcën për të kundërshtuar të ligun, pret me durim për ardhjen e Zotit.[143]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Mundimet dhe Tundimet | (1) |
| II. | Favorizim dhe Besim | (2) |
| III. | Gjuha dhe e Vërteta | (3) |
| IV. | Konflikti dhe mirëbesimi | (4) |
| V. | Pasuritë dhe Drejtësia | (5) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Efektet e Besimit të Vërtetë Shpëtues

- Përse "efektet e besimit të vërtetë shpëtues" është tema e duhur për letrën e Jakobit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të letrës së Jakobit.
- Lexoni gjithë letrën e Jakobit.

[143] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible,* 462.

## 1 PJETRIT

Meqenëse besimtarët që po merrnin këtë letër po vuanin përndjekje gjithnjë e në rritje, qëllimi i kësaj letre ishte që t'u mësonte atyre se si të jetonin fitimtarë në mes të gjithë kësaj armiqësie... Edhe pse më së shumti mund të jenë të privilegjuar, të krishterët duhet ta dinë gjithashtu se bota do t'i trajtojë ata në mënyrë të padrejtë. Qytetaria e tyre është në qiejt dhe ata janë të huaj në një botë armiqësore e nën fuqitë djallëzore. Kështu, jeta e krishterë mund të përmblidhet si një thirrje për fitore dhe lavdi përmes shtegut të vuajtjeve. Për këtë arsye, pyetja bazë që merr përgjigje prej Pjetrit në këtë letër është: Si duhet të veprojnë të krishterët me armiqësinë? Përgjigjja përmban të vërteta praktike dhe përqendrohet te Jezu Krishti si modeli i Atij që mbajti një qëndrim triumfues në mes të armiqësisë.[144]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Shpëtimi i Besimtarit | (1:1-2:12) |
| II. | Nënshtrimi i Besimtarit | (2:13-3:12) |
| III. | Vuajtja e Besimtarit | (3:13-5:14) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Qëndroni të Patundur në mes të Vuajtjeve

- Përse "qëndroni të patundur në mes të vuajtjeve" është tema e duhur për letrën e Parë të Pjetrit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Pjetrit.
- Lexoni gjithë letrën e Parë të Pjetrit.

[144] MacArthur, *The MacArthur Study Bible*, 1937.

## 2 PJETRIT

Letra e Dytë e Pjetrit merret me kundërshtitë që sulmojnë brendësinë e kishës përmes mësimeve të rreme. Ajo synon të dallojë, të kundërshtojë dhe t'i prapësojë ata mësues të rremë që e mohojnë Krishtin dhe që kërkojnë të shpërbëjnë kishën për shkak të lakmisë. 2 Pjetrit nënvizon faktet që mbështesin të vërtetën e ungjillit të krishterë dhe se si kjo e vërtetë duhet të shfaqet në një stil jetese gjithnjë e në rritje, në pastërti, integritet dhe besnikëri. E gjitha kjo ndryshon tërësisht nga shembulli i korruptuar dhe imoral i mësuesve të rremë, jeta e të cilëve pasqyron mësimin e tyre të gabuar.[145]

**SKICIMI:**

I. Shenjtëri (1)
II. Herezi (2)
III. Shpresë (3)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Krishtërimi i Vërtetë dhe ai Fals

- Përse "krishtërimi i vërtetë dhe ai fals" është tema e duhur për letrën e Dytë të Pjetrit?

**THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):**

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Pjetrit.
- Lexoni gjithë letrën e Dytë të Pjetrit.

[145] Chrispin, *The Bible Panorama*, 546-47.

## 1 GJONIT

Duke u kthyer sërish te bazat, letra e Parë e Gjonit kundërshton (mësimet e rreme)... Përgjigja ndaj sulmit është si objektive ashtu edhe subjektive. Ajo bazohet në të vërtetat objektive të Jezu Krishtit dhe mesazhit të ungjillit. Po ashtu, ajo shfaqet në përvojën e vërtetë personale të Krishtit, e cila bën të mundur që të kthyerit në besimin e krishterë ta dinë që Ai është ringritur nga vdekja në jetë... Nga ta dijë dikush që ai e njeh Krishtin? Duke iu bindur Perëndisë, duke dashur vëllezërit e krishterë, duke kundërshtuar gjërat e botës, duke praktikuar drejtësinë, duke bërë një jetë të pastër e duke mos jetuar për mëkatin. Këto janë sprova që jepen në këtë letër. Nëse dikush është i shpëtuar, e vërteta që ai apo ajo do të jenë përherë të tillë vendoset në kontekstin e sprovave për të parë nëse ekziston prova e shpëtimit apo jo. Kjo jep siguri të thellë, e jo supozime të cekëta, ndaj personit që i beson vërtet Krishtit.[146]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Shpëtimi; Fjala e Jetës | (1) |
| II. | Mëkati; Dashuria e Botës | (2) |
| III. | Shenjtërimi; Rendja pas së Vërtetës | (3) |
| IV. | Fryma; Nënshtrimi ndaj Frymës | (4) |
| V. | Siguria; Siguria e Shpëtimit | (5) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Sprovat e Jetës së Përjetshme

- Përse “sprovat e jetës së përjetshme” është tema e duhur për letrën e Parë të Gjonit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 1 Gjonit.
- Lexoni gjithë letrën e Parë të Gjonit.

[146] Chrispin, *The Bible Panorama,* 549.

## 2 GJONIT

Me një trajtim më të përmbledhur e të drejtuar një familjeje, letra e Dytë e Gjonit vë përballë pyetjen e mësimeve të rreme nga 1 Gjonit, Gnosticizmin, dhe si të merremi me të dhe me mësuesit e saj të shumtë... Kjo përfshin edhe pyetjen e mikpritjes së krishterë. A duhet të tregojë mikpritje një i krishterë ndaj dikujt që vjen të mbjellë gabime e sidomos që mohon personin e Zotit Jezu Krisht si Perëndia që ka ardhur në mish? Përgjigjja është "Jo", dhe aty jepen edhe arsyet. Mësimi i pastër i krishterë dhe shenjtëria janë bazat për një miqësi të vërtetë të besimtarëve në Krishtin. Kjo e vërtetë është kufi matës. Dashuria e vërtetë bën dallimin dhe kundërshton pajtimin me gabimin që dënon përjetësisht të humburit.[147]

### SKICIMI:

I. Jetoni në Urdhërimet e Perëndisë (v. 1-6)
II. Mos Jetoni me Mësuesit e Rremë (v. 7-13)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Mikpritja e Krishterë dhe Mësuesit e Rremë

- Përse "mikpritja e krishterë dhe mësuesit e rremë" është tema e duhur për letrën e Dytë të Gjonit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 2 Gjonit.
- Lexoni gjithë letrën e Dytë të Gjonit.

[147] Chrispin, *The Bible Panorama*, 553.

## 3 GJONIT

Te 1 Gjonit, apostulli shpjegon miqësinë me Perëndinë; te letra e Dytë, ai ndalon miqësinë me mësuesit e rremë; te letra e Tretë, ai nxit miqësinë me vëllezërit e krishterë. Pasi shpreh dashurinë e vet për Gajin, Gjoni tregon gëzimin e tij që Gaji po ecën me këmbëngulje në të vërtetën dhe që po shfaq mikpritje ndaj shpallësve të ungjillit. Megjithatë Gjoni nuk mund t'i lavdërojë disa të tjerë në asamble. Për shembull, Diotrefi ka bërë që krenaria në jetën e vet t'i zërë vendin dashurisë, duke kundërshtuar madje edhe fjalët disiplinuese të Gjonit. Diotrefi është tërësisht i kundërt nga Gaji. Gjoni e përdor këtë shembull negativ si një mundësi për të inkurajuar Gajin. Karakteri i perëndishëm dhe besnikëria ndaj së vërtetës nuk janë asnjëherë të lehta, por ato sjellin lavdërimet më të thella të Perëndisë – sikurse edhe të Gjonit.[148]

### SKICIMI:

I. Shërbimi - Gaji (v. 1-8)
II. Egoizmi - Diotrefi (v. 9-14)

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Mikpritja e Krishterë dhe Shërbëtorët Besnikë

- Përse "mikpritja e krishterë dhe shërbëtorët besnikë" është tema e duhur për letrën e Tretë të Gjonit?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të 3 Gjonit.
- Lexoni gjithë letrën e Tretë të Gjonit.

[148] Wilkinson and Boa, *Talk Thru the Bible,* 495.

## JUDA

Letra e Judës është e vetmja në Dhiatën e Re që i përkushtohet në mënyrë ekskluzive përballjes me "apostazinë", që është shmangia dhe largimi nga e vërteta (mohimi i besimit)... Juda shkroi për t'i dënuar mohuesit e besimit dhe për t'i nxitur besimtarët që të qëndrojnë fort për besimin. Ai bën thirrje për të bërë dallimin përsa i përket pjesës së kishës dhe mbrojtjes rigoroze të së vërtetës biblike... Edhe pse Juda nuk komentoi kurrë mbi ndonjë çështje specifike të mësimit të tyre të rremë, sërish u mjaftua të shpaloste që jeta e tyre personale e degjeneruar dhe shërbesat e pafrytshme nxirrnin hapur synimet e tyre të mbrapshta që mësonin të gabuarën sikur të ishte e vërtetë. Theksi mbi karakterin përsërit temën e vazhdueshme mbi mësuesit e rremë – korruptimin e tyre personal. Megjithëse mësimdhënia e tyre është plot me zgjuarsi, delikatesë, mashtrim e joshje dhe jepet në një larmi të gjerë formash, mënyra më e thjeshtë për t'i njohur ata është t'i shihni përtej maskës së tyre të rremë shpirtërore si edhe jetën e tyre plot poshtërsi.[149]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Qëllimi i letrës | (v. 1-3) |
| II. | Shtegu i mohuesve të besimit | (v. 4-16) |
| III. | Praktika e besimtarëve | (v. 17-25) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme.

**TEMA:** Kini Kujdes nga Pretenduesit

- Përse "kini kujdes nga pretenduesit" është tema e duhur për letrën e Judës?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Judës.
- Lexoni gjithë letrën e Judës.

[149] MacArthur, *The MacArthur Study Bible,* 1983–84.

## ZBULESA

Ndryshe nga shumica e librave në Bibël, Zbulesa tregohet në titullin e vet: "Zbulesa e Jezu Krishtit" (1:1)... Ky libër zbulon apo shpalos Jezu Krishtin në lavdi... Zbulesa nis me Gjonin, apostullin e fundit të mbetur gjallë, një burrë i moshuar e i dëbuar në ishullin e shkretë e të vogël të Patmosit. Kur gjendej atje, Gjoni mori një sërë vizionesh, të cilat shtruan historinë e ardhshme të botës. Kur u arrestua, Gjoni ishte në Efes duke u shërbyer kishave atje dhe në qytetet përreth... Për ato kisha, Zbulesa jep një mesazh shprese: Perëndia ka nën kontrollin e Tij sovran gjithë ngjarjet e historisë njerëzore dhe megjithëse e keqja duket sikur është përhapur kudo dhe njerëzit e këqij duken plot pushtet, shkatërrimi i tyre përfundimtar është i sigurt. Krishti do të vijë në lavdi për të gjykuar e për të sunduar.[150]

### SKICIMI:

| | | |
|---|---|---|
| I. | Lavdia e Krishtit | (1) |
| II. | Kisha e Krishtit | (2-3) |
| III. | Planet e Ardhshme të Krishtit | (4-22) |

- Mësoni përmendësh pjesën e mëposhtme dhe lexoni kapitujt kyçë.

**TEMA:** Zbulesa e Jezu Krishtit

### KAPITUJT KYÇË:

| | |
|---|---|
| 1 | Lavdia e Krishtit |
| 2-3 | Mesazhe për 7 kishat |
| 4-5 | Froni i Perëndisë |
| 8-9, 11 | Trumbetat |
| 12 | Përshkrim i 3½ viteve të fundit të mundimeve; përndjekja e judenjve |
| 16 | Kupat |
| 17-18 | Babilonia |
| 19 | Rikthimi i Krishtit dhe Armagedoni |
| 20 | Mijëvjeçari dhe Froni i Madh i Bardhë |
| 21-22 | Gjendja e përjetshme |

- Përse "zbulesa e Jezu Krishtit" është tema e duhur për librin e Zbulesës?

### THELLIM I MËTEJSHËM (SIPAS DËSHIRËS):

- Nga Bibla e studimit, apo nga shqyrtimi bazë i Dhiatës së Vjetër, lexoni hyrjen prezantuese të Zbulesës.
- Lexoni gjithë librin e Zbulesës.

[150] MacArthur, *The MacArthur Study Bible*, 1989–90.

## DISKUTIM MENTORAL (10-15 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi ndonjë pyetje që mund të keni rreth librave të përfshirë në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik.
2. Rikthejuni detyrës së mësimit përmendësh në këtë seksion të Shqyrtimit Biblik, duke bërë pyetje të tilla si:
    - Cila është tema e Hebrenjve?
    - Cila është tema e 1 Pjetrit?
    - Çfarë jepet te Zbulesa 2-3?
3. Rishikoni secilën nga temat dhe kapitujt kyçë, nga Zanafilla deri te letra drejtuar Filemonit.

# TEOLOGJI SISTEMATIKE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

- Plotësoni pjesët e mëposhtme.

## PJESA 1: KUPTOJMË DOKTRINËN E SHËNDOSHË – DALLIMET E DOKTRINËS SË KISHËS SUAJ

- Lexoni me kujdes dallimet e doktrinës së kishës suaj apo deklaratat shtesë mbi besimin dhe praktikat tuaja. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.
  - Cilat janë disa nga të vërtetat kyçe që shprehen aty?
  - Përse kanë rëndësi këto të vërteta? Cilat janë pasojat që vijnë nëse keqkuptohen apo neglizhohen këto të vërteta?
  - Çfarë pyetjesh keni për të vërtetat që përmenden aty?

## PJESA 2: MBROJTJA E DOKTRINËS SË SHËNDOSHË

- Rishikoni shkurtimisht të gjitha pyetjet e listuara më poshtë, të marra nga pjesët "Mbrojtja e doktrinës së shëndoshë" që ju jeni përgjigjur në kapitujt e mëparshëm. Kthehuni dhe rishikoni secilën pyetje për të cilën jeni ende të paqartë, apo që mendoni se nuk mund t'i përgjigjeni. Çdo rikujtim të dobishëm mbajeni shënim më poshtë.
  - Si do ta përkufizonit pagabueshmërinë e Shkrimit?
  - Si do ta përkufizonit Trininë?
  - Si do ta mbronit hyjninë e Krishtit?
  - Si do ta mbronit hyjninë e Frymës së Shenjtë?
  - Cilat janë qëllimet e kishës?
  - Si mund ta përkufizoni shthurjen totale?
  - Çfarë duhet të bëjë dikush që të shpëtohet? A është thelbësor pendimi, për kthimin në besim?
  - Shpjegoni se si e kuptoni vdekjen zëvendësuese të Krishtit.
  - Si e përkufizoni doktrinën e përzgjedhjes?
  - Si e përkufizoni doktrinën e ripërtëritjes?
  - Si e përkufizoni doktrinën e shfajësimit?
  - Si e përkufizoni doktrinën e shenjtërimit?
  - Si e përkufizoni doktrinën e ngritjes në lavdi?
  - Si e përkufizoni doktrinën e sigurisë së përjetshme?
  - Jepni një linjë të përgjithshme kohore mbi ngjarjet e kohëve të fundit.

## DISKUTIM MENTORAL (15-20 MINUTA):

1. Diskutoni shkurtimisht mbi dallimet doktrinale të kishës suaj, apo deklaratat shtesë të besimit dhe praktikave tuaja, si edhe mbi përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve rreth tyre.
2. Rishikoni pyetjet e listuara më sipër.

# SEKSIONI 3:
# TË KULTIVOJMË KARAKTERIN PËR UDHËHEQJEN BIBLIKE

Shkrimi i përcakton qartë cilësitë e karakterit për ata që shërbejnë në udhëheqjen e kishës, pasi ata duhet të jenë shembull për të tjerët (1 Korintasve 11:1; 2 Timoteut 3:10-11). Edhe pse jo të përsosur, udhëheqësit në kishë duhet të jenë të pjekur nga ana shpirtërore, saqë të tjerët të mund t'i imitojnë ata në çdo aspekt të jetës. Të gjithë besimtarët duhet të bëjnë përpjekje për t'i parë këto karakteristika të pjekurisë shpirtërore në ngjasim me Krishtin të shfaqen vazhdimisht në jetën e tyre. Një pjekuri e tillë nuk vjen rastësisht, por del nga një jetë plot disiplinë dhe besnikëri.

> **Xherri Rag**
> Besueshmëria shpirtërore buron nga një jetë e pastër dhe e shenjtë. Drejtësia mund të mos fitojë votën e shumicës, por ajo duhet të kryesojë në përgatitjen e një udhëheqësi të efektshëm. Nga podiumi deri te karrigia e fundit, asnjë gjë tjetër nga cilësitë e udhëheqjes nuk është më e qëndrueshme, më e admirueshme dhe më bindëse sesa shenjtëria personale.[151]

## PJEKURI SHPIRTËRORE

### PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Merrni në konsideratë cilësitë e mëposhtme biblike për një plak, duke kuptuar që ato nuk kërkohen vetëm për pleqtë, por duhet të jenë synim për gjithë besimtarët që rriten drejt pjekurisë shpirtërore.

- **Të dojë të mirën**

  **Titit 1:7-8** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... por ai duhet të jetë... dashamirës...

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni Romakëve 12:9. Si duket në jetën e besimtarit urrejtja e së keqes dhe rendja (ngjitja) pas së mirës?

[151] Wragg, *Exemplary Spiritual Leadership*, 23.

- **I drejtë**

  **Titit 1:7-8** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... por ai duhet të jetë... i drejtë...

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Lexoni 1 Gjonit 2:29 dhe 3:7. Në çfarë mënyrash konkrete duhet të imitojmë Krishtin duke bërë një jetë të drejtë e me ndershmëri?

- **Të Devotshëm / Besnik ndaj Fjalës**

  **Titit 1:7-8** Peshkopi, si kujdestar i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm... por ai duhet të jetë... i shenjtë... t'i qëndrojë besnik Fjalës...

  - Përkufizojeni me fjalët tuaja këtë cilësi.

  - Përse është e nevojshme kjo cilësi për udhëheqjen?

  - Përse duhet që besimtarët të dëshirojnë fort të bëjnë një jetë të shenjtë, të përkushtuar plotësisht ndaj Perëndisë?

  - Titit 2:3 u bën thirrje në mënyrë të veçantë grave që "të kenë një sjellje prej besimtareje". Si mund të jetojnë gratë duke e patur në mendje këtë gjë dhe duke e nderuar Perëndinë në çdo aspekt të jetës?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Nga se ndryshon ndjekja e një jete të shenjtë nga ajo e një jete legaliste? Përse ngatërrohen shpesh këto dy lloje jetësh nëpër kishat, sot?
3. Si e ka formuar karakterin tuaj ky studim mbi cilësitë biblike të nevojshme për pleqtë? Nëse ka, cilat janë fushat kryesore në jetën tuaj që kanë nevojë për rritje të mëtejshme deri në plotësimin e këtyre cilësive?

# DISIPLINË SHPIRTËRORE

## PËRGATITJE INDIVIDUALE:

Rishqyrtoni disiplinat e mëposhtme shpirtërore, të cilat duhet të karakterizojnë jetën e çdo besimtari si një ecje përpara dhe shfaqje e rritjes shpirtërore dhe e karakterit të perëndishëm.

- **MIQËSI**
- **UNGJILLIZIM**
- **LUTJE**
- **SHËRBIM**

> **1 Timoteut 4:7-8**
> ...ushtroje veten në përkushtimin ndaj Perëndisë, sepse ushtrimi i trupit është pak i dobishëm, por përkushtimi ndaj Perëndisë është i dobishëm për gjithçka.

> **Donëld Uitni**
> ...disiplinat shpirtërore kanë qenë gjithnjë ato që e kthejnë dikë nga një njeri të ngarkuar me punë në njeri të perëndishëm. Disiplinat shpirtërore nuk synohen vetëm për të krishterët që e kanë kohën e tepërt (a ka të tillë?). Ato janë mjetet e dhëna nga Perëndia me anë të të cilave besimtarët e ngarkuar me plot gjëra në jetë bëhen si Krishti.[152]


- Si jeni rritur në zbatimin e këtyre disiplinave gjatë muajve të fundit?

- Si do të vazhdoni t'i jepni përparësi praktikës së rregullt të këtyre disiplinave shpirtërore në të ardhmen?

## DISKUTIM MENTORAL (15 MINUTA):

1. Diskutoni përgjigjet tuaja ndaj pyetjeve të këtij seksioni.
2. Çfarë përfitimesh shpirtërore keni parë nga zbatimi i këtyre disiplinave shpirtërore si në jetën tuaj ashtu edhe në atë të personave që u keni shërbyer?
3. Cilat këshilla apo ndihma praktike kanë qenë të dobishme në themelimin e një praktike të rregullt të zbatimit të këtyre disiplinave shpirtërore?

[152] Whitney, *Spiritual Disciplines for the Christian Life*, 236.




# XL MINISTRIES

EXCELLENCE IN LEADERSHIP